

SHOQATA
KULTURORE
SHQIPTARE
MIGJENI
KULTURNO
DRUSTVO
ALBANCEV

ALTERNATIVA

403668

6

LJUBLJANA,
NENTOR 1989
NOVEMBER 1989

SALIH KABASHI

FOLE S'FOLE NJESOJ... T'I FLASIM DY TRI FJALE, SA JEMI GJALLE...

1. Nuk i dëgjoj mirë demokratët, prandaj i lus: hipni mbi tanket që i kini rreth e rrotull! Ju gjithmonë me tanket na sillni lirinë. Edhe muhabetin me ne e bëni kur ato i kini pranë... Kur rrënohet Muri i Berlinit, ju bëni mure tankesh... Në Kosovë tanket po i prishin rrugët...

2. Nuk di se cilës parti i takoj. Jam zogist, ballist, fashist, marksist-leninist, separatist, nacionalist, irredentist, anarkist... Shtypi »demokratik« dhe gazetarët »demokratë« kur s'kanë argumente ngjesin etiketa. Më mbushët plotë etiketa! Mos i harxhoni kot... Tashmë, kur ndërpretë marrëdhëniet me Slloveninë, silluni me nikoçirllëk... Çausheku ju pret!

3. Nuk pati miting në Lubjanë. Të gjithë atyre që kanë lindur më 1 dhjetor, u uroj ditëlindjen... Evropa edhe kësaj radhe nuk u bë Azi. Edhepse, si ujku i përrallës, kish marrë një flamur evropian. E po, s'shitet bozë me 1 dhjetor. Mjaft bozaxhinj!

4. ...»kushtet historike dhe shoqërore në të cilat është aq e nevojshme trimëria, në të vërtetë, janë kushte tragjike jetësore«. (Rexhep Qosja)

5. ... Machiavelli ka shkruar se për krijimin e shtetit të fuqishëm, janë të pranueshme të gjitha mjetet: helmi, denuncimi, vrasjet pas qoshes; udhëheqësin e porosiste që të ngërthente në vete guximin e luanit dhe dinakërinë e dhelpërës, le të ketë urtësi njeriu e gjakëpirësi bishe... Kështu Machiavelli... Këta të kohës sonë kanë shkuar edhe më larg...

6. ... danezët (kundërrevolucionarë) thonë se »kush do vezë të freskëta duhet të durojë edhe kokorisje pulash«, ndërsa zvicëranët (separatistë) thonë: »Fjalët janë si bletët, të pickojnë po edhe mjaltë bëjnë«...

7. ... urrej njerëzit pa kurriz, atlasin gjeografik, ofertat martesore, filmat kauboj, flokët e pa lara, dyert e hapura, juve, qëndrimin tuaj ndaj nesh, idhujt tuaj, standardin tuaj, moralin tuaj, edukatën tuaj, problemet tuaja, rrospitë tuaja... (Chubby).

8. Gëzuar festat e nëntorit, kërshëndellat dhe Vitin e Ri!

9. Po të mos ishte Kosova, Jugosllavia pa të drejtë do të mbetej në hartën demokratike të Evropës.

10. Ftoj Luanin III të shpall ediktin kundër adhurimit të ikonave..

11. Koha është e maskarenjve, po atdheu është i shqiptarëve (A. Asllani)

LETRA E AKADEMIKEVE TE KOSOVES JANEZ DERNOVSHKUT

nderuar shoku Kryetar,

Në realitetin politik të Kosovës, këto ditë jemi dëshmitarë të përdhosjes dhe gjymtimit të palejueshëm, fyes dhe irtues të trashëgimisë kulturore kombëtare dhe të së kaluarës kombëtare të shqiptarëve, që po zbatohet në emër të të ashquajturit »dealbanizim« në Kosovë, term ky shumë i shëmtuar, fyes dhe problematik, si edhe mendim në shkallë qëndrimi me asociacione të rënda, duke pasur parasysh përbërjen kombëtare të popullsisë së Kosovës.

Pos rasteve të tjera në këtë drejtim, rasti më i ri dhe më drastik ndodhi në mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës së Pejës,, më 17.XI.1989, ku në mënyrë të palejueshme u ndërpre debati dhe votimi i delegatëve (për ç'arsye disa delegatë braktisën mbledhjen solemne, - raporti i »Rilindjes« më 18. XI.1989), kështu që në mënyrë antistatutare u mor vendimi deri në fund problematik dhe në pikëpamje kombëtare fyes mbi ndryshimin e emrave të disa rrugëve, duke hequr në mënyrë skandaloze emrat dhe ngjarjet historike më të njohura të kulturës kombëtare dhe të së kaluarës shqiptare siç janë: Lidhja e Parë e Prizrenit, Vëllezërit Frashëri, Bajram Curri, Haxhi Zeka, Luigj Gurakuqi dhe Hasan Prishtina.

Akti i këtillë i papritur dhe i pakuptimtë, pos tjerash padyshim i kontribuon edhe keqësimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërnacionale në Kosovë si edhe destabilizimit të gjendjes në Krahinë, gjë që gjithsesi tërheq përgjegjësinë e frymëzuesve dhe të iniciatorëve të vendimit të këtillë para shoqërisë jugosllave.

Duke pasur të gjitha këto parasysh, po edhe ndikimin pozitiv të personaliteteve politike më përgjegjëse të vendit, mund të pritet me të drejtë që delegatët dhe Kuvendi i Komunës së Pejës në njërin ndër mbledhjet e ardhshme ta shpallin vendimin e këtillë si të paqenë, duke pasur parasysh si dëmin e tij, po kështu edhe faktin se dhoma kompetente e Kuvendit as që debatoi as që votoi për këtë vendim.

Shoku Kryetar,

Gjithashtu jemi dëshmitarë të rasteve të palejueshme të shkeljes arbitrare dhe antikushtetuese të të drejtave në fushën e marrëdhënieve të punës së punëtorëve publikë në lëmenjtë e arsimit, ekonomisë, informimit dhe kulturës. Akti i këtillë, pos që është antikushtetues dhe antiligjor, e acaron edhe më tej situatën në Kosovë dhe e rëndon pozitën e kombësisë shqiptare në ekzistencën e përbashkët.

Vetëkuptohet se diferencimi në radhët e LK, nëse bazohet në fakte dhe në vlerësimin parimor të fakteve nga pikëpamja e programit të LKJ dhe jo në ekskluzivitetet dhe pikënisje theksuara politiko-ditore dhe njënacionale, si edhe nëse është zbatuar me përfilljen e përpiktë të procedurës së paraparë statutare, atëherë kjo është një dukuri normale në jetën e brendshme partiake, siç është rasti me të gjitha partitë në botë. Mirëpo, gjithsesi nuk është normale dhe është shumë indikative që Komiteti Komunal i Prishtinës të përjashtojë vetëm brenda

një dite mbi njëzet doktorë shkencash dhe magjistra të kombësisë shqiptare, duke mos llogaritur këtu numrin e madh të profileve të tjera universitare. Ky rast është i paparë në historinë e lëvizjes punëtore dhe në historinë e partive në përgjithësi, jo vetëm nga aspekti kombëtar, por edhe nga aspekti i raportit të partisë dhe inteligjencisë.

Veç asaj që u theksua më lart, nga pikëpamja e demokracisë së shtetit juridik, sigurisë juridike dhe kombëtare të qytetarëve pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, është e palejueshme që në emër të diferencimit dhe përmes monopolit partiak të ndërmerren veprime antikushtetuese, të cilat i rrënojnë të drejtat kushtetuese të punonjësve në lëmin e marrëdhënies së punës dhe përpos kësaj fusin debalanse të renda në jetën ndërnacionale në Kosovë.

Grupi i akademikëve të nënshkruar të Akademisë së shkencave dhe Arteve të Kosovës Ju lutet t'i pranoni për një bisedë lidhur me çështjet e cekura më lart, po edhe lidhur me çështjet më pak të rëndësishme, për të cilat Ju, shoku Kryetar, do të tregoni interes.

Nga ana jonë do ta çmonim si avantazh demokratik në qoftë se pritja dhe biseda me Ju do të ishte publike dhe që brenda mundësive të zhvillohet sa më parë.

Duke shprehur edhe në këtë rast interesimin tonë të madh për një jetë të mirëqenies dhe të drejtësisë në Kosovë - për ndërtimin e përbashkësisë në bazë të barazisë së plotë të qytetarëve dhe nacionaliteteve në Kosovë dhe në Jugosllavi në përgjithësi, si edhe duke qenë me shpresë se lutjes sonë për pritje do t'i përgjigjeni pozitivisht, sikundër që deri më tani edhe është praktikuar në angazhimin. Tuaj të çmuar të punës dhe në angazhimin e paraardhësve Tuaj, shoku Kryetar i Kryesisë së RSFJ, pranoni shprehjen e nderimit tonë të posaçëm.

Prishtinë, 24. XI. 1989

Akademikët: Esad Mekuli, Idriz Ajeti, Mark Krasniqi, Dervish Rozhaja, Gazmend Zajmi, Rexhep Qosja, Muslim Mulliqi, Osman Imami

PROTESTA E INTELEKTUALËVE SHQIPTARË

Punëtorë të shkencës, kulturës dhe të arsimit të Kosovës i dërguan organeve shtetërore dhe partiake të Kosovës dhe të Pejës këtë letër proteste:

Kryesia e Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve të Pejës, në mbledhjen e mbajtur më 15. XI. 1989, aprovoi propozimin për ndryshimin e emrave të atyre rrugëve të qytetit të Pejës që quhen Vëllezërit Frashëri, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Haxhi Zeka, Bajram Curri dhe Lidhja e Prizrenit. Protestojmë kundër këtij propozimi kundërshqiptar, i cili cenon historinë, kulturën dhe dinjetetin e popullit shqiptar. Protestojmë kundër këtij propozimi kundërqytetëruës, i cili atakon lirinë dhe tolerancën si vlera mbi të cilat qëndrojnë qytetërimi dhe kultura. Ky propozim është në kundërshtim si me parimet themelore të Kushtetutës së RSFJ ashtu edhe me parimet themelore të

Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, sipas të cilave vlerat historike dhe kulturore të popujve të botës trajtohen njëkohësisht si vlera gjithënjëzore.

Megjithëse vitin e fundit u janë ndërruar emrat shqiptarë disa institucioneve shkollore në Kosovë dhe në Preshevë, nuk kemi pritur se edhe më tutje do të vazhdojë kjo ofensivë partiakofetare kundër historisë dhe kulturës shqiptare, në të vërtetë kundër identitetit dhe të integritetit të popullit shqiptar. Përkundrazi, kemi shpresuar se do të ndalet, në mos para pakuptimësisë së vet kompromentuese, bile para të dhënës që dëshmon se në Kosovë është më i madh numri i shkollave, i rrugëve dhe i shesheve që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë dhe të kulturës së serbëve, malaziasve e të popujve të tjerë të Jugosllavisë sesa i shkollave, i rrugëve dhe i shesheve, që mbajnë emrat e figurave të shquara të historisë dhe të kulturës së shqiptarëve.

Kemi shpresuar se njëherë e përgjithmonë ka kaluar ajo kohë kur në disa mjedise në Kosovë dhe në Mal të Zi mbylleshin shkollat shqipe, kur ditaret në shkollat shqipe duhej të plotësoheshin në gjuhën serbokroate a maqedone, kur asnjë shkollë, rrugë a shesh në Kosovë nuk mund të mbante emrin e ndonjë figure historike a kulturore shqiptare, kur historia dhe kultura shqiptare trajtoheshin si përmbajtje e rrezikshme indoktrinuese prandaj reduktoheshin deri në mosekzistim, kur prej figurave të historisë dhe të kulturës shqiptare të shekujve të shkuar kërkoheshin t'i përgjigjeshin masës ideologjike dhe politike që caktohej prej policisë partiake politike. Kemi shpresuar se një kohë e tillë nuk do të kthehet më kurrë sepse kemi shpresuar se liria, demokracia dhe barazia nuk do të varen më prej atyre forcave që historikisht janë dënuar në Plenumin e Brioneve. Mjerisht, propozimi që ka aprovuar Kryesia e Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve të Pejës tregon se shpresa jonë nuk ishte e pailuzione. Ky propozim barbar dëshmon se më çfarë mospërfilljeje Kryesia e KK të LK të Pejës është e gatshme të sillet ndaj ndjenjave kombëtare të popullit shqiptar, se çfarë qëndrimi përbuzës ka ndaj opinionit demokratik kosovar dhe, më në fund, çfarë përmasash po merr neostalinizmi sot në Kosovë.

Prishtinë, 17. XI. 1989

PROTESTA E QYTETAREVE TE PEJES

Ne qytetarët e Pejës, intelektualët, punëtorët dhe zejtarët e këtij qyteti, Kryesisë së KQ të LKJ, Kuvendit Komunal dhe Kryesisë së LSPP të Pejës i dërgojmë këtë

protestë

1. Rruga deri te marrja e vendimit për ndërrimin e emrave të rrugëve, të cilat do t'i përmendim më poshtë, nuk është e drejtë as për nga qëllimi, as për nga koha, as për nga faktet e as për nga mënyra e aprovimit.

Vetëm dy ditë para se qyteti i Pejës të festonte 17 Nëntorin Ditën e çlirimit, kur qyteti kishte marrë pamje festive, Kryesia e KK të LK të Pejës, ndër të tjera shqyrtoi edhe raportin e Komisionit të kësaj kryesie për ndërrimin dhe emërtimin e një numri të rrugëve të qytetit dhe miratoi propozimin e këtij komisioni që »rruga e cila deri me tash mbante emrin »Lidhja e Prizrenit« të

mbajë emrin »Kosovski Junaci«, pastaj rruga Haxhi Zeka të mbajë emrin »Dushan Llaboviq«, ajo »Bajram Curri« emrohet me »Musa Muhaxheri« rruga Vëllëzerit Frashëri të mbajë emrin »Braça Jugoviq«, ajo »Luigj Gurakuqi« - »Liman Kaba« dhe rruga »Hasan Prishtina« - »Jug Bogdani« (shih »Rilindja« e datës 16.11.1989). Pra Komisioni propozoi t'u ndërrohen emrat pikërisht atyre rrugëve, që janë emërtuar me emrat e ajkës së letërsisë, të gjuhës të historisë - të kulturës kombëtare shqiptare në përgjithësi. E, sa absurde, Kryesia e KK të LK pa e konsultuar fare bazën, pa e arsyetuar këtë propozim e pa e kërkuar fare pëlqimin e anëtarësisë, e aprovoi propozimin për këto ndërrime emrash, dhe i propozoi Kuvendit Komunal që këtë ta aprovojë në mbledhjen solemne, e cila duhet të mbahej në ditën e çlirimit të Pejës - me 17 Nëntor në orën dhjetë. Dhe kështu, kjo iniciativë e që na qenka nisur kushedi kur nga KK të LSHL të LNÇ dhe Kryesisë së KK (»Rilindja e dt. 17.11.1989) u miratua përfundimisht në mbledhjen e përbashkët solemne të KK dhe të organeve ekzekutive të organizatave politiko-shoqërore pikërisht me 17 Nëntor. Përse m'u në këtë ditë le të thonë ata, që e planifikuan kështu (!). Nëse është menduar se ky ndërrim emrash është caktuar të aprovohet në Ditën e çlirimit të Pejës shi pse është konsideruar fitore mbi irredentën, e cila e paska pasur si »njërën ndër mënyrat e shqiptarizimit të Kosovës dhe të indoktrinimit të të rinjve me idetë për Shqipërinë e Madhe dhe qëllim antijugosllav, emërtimin e rrugëve me emrat e armiqve të përbetuar të Jugosllavisë«, siç arsyeton Komisioni - është gabuar sepse vepra e këtyre figurave nuk i jep askujt të drejtë e as mundësi keqpërdorimi, aq më pak në planin nacionalist, sepse ata në radhë të parë ishin internacionalistë. Për të argumentuar këtë le të shërbejnë këto vargje të Naim Frashërit, ku ai kërkon që populli ynë të jetojë në paqë e dashuri me popujt fqinjë duke mos luftuar njëri-tjetrin, por duke ndihmuar:

*»Duam me fqinj të gjithnjë të rrojmë, të jetojmë,
me sllavë, me grekë e këdo, me dashuri të shkojmë,
po me një fjalë, një vështrim thellësisht të kuptohet,
q'ë e drejt'ë tjetrit gjithnjë lipset të respektohet«*

(N.F.: Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve)

Vallë, ç' do të kërkonte cilido shtet demokratik, që respekton në mënyrë rigoroze barazinë dhe vëllazërimin ndërmjet njerëzve më tepër se Naimi në këto vargje? ...

Nuk do të shqetësonte propozimi i ndonjë individi apo i disa individëve politikisht të verbër a ideologjikisht të papastër, të cilët nuk e njohin, apo nuk duan ta njohin veprën e këtyre figurave tona kombëtare, por shqetëson, madje revoltton fakti se propozimet e tilla aprovohen nga Kryesia e KK të LKJ dhe nga Kuvendi Komunal, pa u »dhënë të drejtë disa delegatëve, që deshën të kundërshtojnë këto vendime« me arsyetimin se »nuk ka diskutime në mbledhjen solemne dhe se disa duartrokitje mjaftojnë të aprovohet ky vendim pa votime (Rilindja e dt. 18.11.1989).

2. Lidhja e Prizrenit, Vëllëzerit Frashëri (Samiu, Abdyli dhe Naimi), Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Haxhi Zeka, dhe Bajram Curri janë ngjarje dhe figura të rëndësishme të gjuhës, të letërsisë dhe të historisë sonë, prandaj duke cenuar personalitetin e tyre cenohet historia, kultura, identiteti dhe integriteti i kombësisë shqiptare në Jugosllavi. Lidhja e Prizrenit është ngjarja më e rëndësishme e Rilindjes sonë Kombëtare. Termit Rilindje shkenca jonë i jep këtë kuptim: lëvizja e organizuar për çlirim nga Turqia dhe lëvizja kulturore e letrare që atë e shoqëroi. Tjetër kuptim kësaj nuk mund t'i mvishet. E ideol-

ogët kryesorë të kësaj lëvizjeje ishin pikërisht këta, emrat e të cilëve po sulmohen. Lidhja e Prizrenit nuk mund të jetë për askë halë në sy sepse ajo u përpoq për çlirimin kombëtar të shqiptarëve dhe pse ajo për herë të parë, në mënyrë të organizuar, si përfaqësuese e gjithë kombit, ngriti çështjen e shqiptarëve në arenën ndërkombëtare dhe i detyroi fuqitë evropiane ta marrin parasysh ekzistencën e këtij populli në një kohë kur atë e kishin mohuar plotësisht. Mohimi i kësaj ngjarjeje për ne nuk tingëllon ndryshe veçse si mohim i identitetit dhe i historisë sonë.

3. Këto figura janë të rëndësishme, sepse me ta lidhet çlirimi ynë kombëtar nga pushtuesi pesëshekullor turk, kapërcimi nga peruidha parakombëtare në atë kombëtare, nga letërsia e vjetër (parakombëtare) në atë kombëtare, nga gjuha e copëzuar (dialektore e nëndialektore) në atë letrare kombëtare (të njësuar), me emrin e tyre lidhet hapja e shkollave të para shqipe e deri te revolucioni i parë demokratik borgjez (tek shqiptarët) dhe te formimi i të parit shtet demokratik (Noli, Gurakuqi e Curri), i cili qysh atëherë (1925) pati përkrahjen e rrethëve komuniste demokratike evropiane. Pra, të mohosh këta emra do të thotë të mohosh një pjesë të rëndësishme të letërsisë shqiptare, do të thotë të mohosh gjuhën kombëtare shqiptare, të mohosh shkollën shqipe, të mohosh ekzistimin tonë deri në vitin 1945.

Historia jonë nuk ka filluar me këtë vit, ajo është më e vjetër, prandaj askush nuk ka të drejtë ta mohojë atë.

4. Ne nënshkruajtë e kësaj proteste jemi të gatshëm të marrim pjesë në një tryezë të rrumbullakët, që do ta organizonte LS ku me një debat shkencor demokratik e rreptësisht shkencor do ta bindim jo vetëm atë komision, i cili pa kompetenca shkencore propozoi largimin e këtyre emrave, por edhe opinionin në përgjithësi se këto figura nuk janë antijugosllave e armiq, por janë figura të rëndësishme të historisë dhe të kulturës sonë, prandaj duhet të respektohen nga të gjitha kombet dhe kombësitë e Jugosllavisë, nga se ne duhet ta respektojmë historinë dhe kulturën e njëri-tjetrit.


5. Ne adhurojmë dhe respektojmë emrat, që janë propozuar për t'i ndërruar emrat e përmendur dhe i konsiderojmë edhe ata si pjesë e historisë sonë, prandaj propozojmë që ata t'u vihen disa rrugëve të reja.

6. Kërkojmë nga të dy kryesitë e Komunës së Pejës dhe të Kuvendit Komunal që të anulohet vendimi në fjalë si edhe vendimi, që u muar në të njëjtën mënyrë e në të njëjtën ditë në vitin e kaluar për ndërrimin e emrave të disa rrugëve, po ashtu, me emra të rëndësishëm të letërsisë, të historisë dhe të shkencës sonë.

7. Tek e fundit, hiç për tjetër, po edhe për hir të situatës politike ne konsiderojmë se vendimi i tillë është i ngutshëm dhe nuk i kontribuon situatës politike dhe stabilizimit të saj, për të cilën sinqerisht jemi të interesuar.

Pejë, nëntor 1989

Protesta iu dërgua organeve shtetërore - partiake të Pejës, të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të Jugosllavisë. Aktin e protestës e nënshkruan 772 punëtorë të EPA »Ramiz Sadiku«, punëtorët e Kombinatit të Lëkurë - Këpucëve, të OTHPB të Kombinatit bujqësoro - industrial - industria e birrës, maltit dhe pijeve joalkoolike, fabrika e alkoolit, fabrika e sheqerit, bashkësia punuese e shërbimeve të përbashkëta, pastaj nëpuntiesit e Kuvendit Komunal, arsimtarët e Shkollës së Arteve Aplikative »Vëllazërim - Bashkim« dhe (3480) qytetarë të bashkësive lokale.




ve po sul-
qpe ajo u
ë parë, në
ëshijen e
ta marin
n mohar
si mohim
komitetar
në
nga gjura
(njësuar),
volucioni i
demok-
njen e me-
do të thotë
të mohosh
ekzistimin
aj askush
në një
cajshë de-
n, i cili pa
opinionin
ë figura të
toren nga
spjektojmë
i ndëruar
onë, pran-
Komunal
ën mënyrë
ngëve, po
ës sonë
ne konsid-
atës poli-
ës Social-
ëshkuan
-Lëkurë-
a e birës,
dashkësia
Komunal,
the (3480)

JURE DETELA

DANE ZAJC

Velikokrat kaže govorjenje o celotnem opusu nekega pesnika nehoten prezir do njegovih posameznih pesmi. Nemalokrat me navdaja otožna nostalgija za dobami, ki niso bile tako obsedene od kulta umetnikove individualnosti kot današnja in so zato znale bolj kultivirati koncentracijo, dolgotrajen premislek in slo po popolnosti pri izdelavi posameznih umetniških izdelkov. Še posebej mi je žal za časi, ko je bila popolna anonimnost običajna umetnikova drža. Ali nam ni dana sreča, da v vsaki dobi živijo pesniki, ki pišejo z ambicijo, da bi njihove pesmi postale del univerzalne, svetovne pesniške tradicije? In ali ni vse tisto, kar nam omogoča medsebojno izenačevanje v razumevanju jezikovnih struktur neke pesmi, naša skupna duhovna dediščina? Bi bila komunikacija s poezijo sploh mogoča brez tega izenačevanja?

Zaradi teh misli sem se razveselil predloga urednikov Alternative, da pripravim izbor pesmi Daneta Zajca za prevod v albanščino. Pri branju vsake pesmi sem skušal čimbolj odmisli, da je pesnik napisal še veliko drugačnih pesmi. Iz knjige z naslovom Požgana trava sem izbral pesmi Kavke, Mrtve stvari, Dva vrana, Jalova setev, Krizanteme, Sama boš, Zemlja me bo ljubila, Veliki črni bik, Reka in Upor. Iz knjige Jezik iz zemlje sem izbral pesem December, iz knjige Ubijalci kač sem izbral pesmi Glas, Korec vode in Vrt, iz knjige Zarotitve pa pesmi Ni bil klic, Ogradi, Zadnja stran gore, Druga luč, Čreda in Ni darilo. Priznati moram, da sem Zajčeve pesmi izbiral z vidika tistih načel, po katerih oblikujem svoje pesmi. Kriterijev ne bom ekspliciral, saj jih lahko bralec, ki



meni, da je njihovo poznavanje vredno določenega truda, razbere iz moje poezije. Pripomnim naj le, da se izogibljem uporabi vseh retoričnih sredstev, ki jih ne bi uporabljali že Empedokles, Ovid in Homer, zato je razumljivo, da v mojem izboru nastopa poezija Daneta Zajca z arhaičnostjo, ki je za poznavalce Zajčevega pesniškega opusa morda presenetljiva. V tej arhaičnosti pa se na posebno jasen način odkriva razgled na tista sporočila, ki so mi bila v Zajčevi poeziji zmerja še posebno pri srcu.

Skoraj četrto stoletje je minilo, odkar sem prvokrat prebral *December*, *Jalovo setev*, *Mrtve stvari* in *Reko*, in že takrat sem začutil, da je modrost v teh pesmih starejša, trajnejša in prvobitnejša od vseh tistih kulturno-civilizacijskih olepšavanj in osmišljevanj v imenu zgodovine, s katerimi so takrat slovenski pesniki povečini pisali o smrti, umrljivosti, ubijanju in uničenju. Presenetil me je pogum, s katerim se Zajčeve pesmi soočajo z absurdno goloto smrti: nobene iluzije o človeški prihodnosti, glede na katero bi bila katerakoli smrt rodovitna. Ker smrt brezobzirno jemlje vse, prav vse, kar nam je o prihodnosti znano in kar o njej slutimo.

Kmalu zatem je bila objavljena pesem *Korec vode*. Kako dragocen je sredi slovenske samomorilske poblaznelosti pesnikov temni, svareči glas, da je umrljivost univerzalna usoda vseh ljudi in da nobeno osmišljanje, nobeno človeško dejanje in nobena človeška moč ne morejo premagati smrti. In da samomor nikakor ne omogoča zmage nad umrljivostjo:

*In rana na njegovem hrbtu in velika črna skala,
pod katero se vdaja telo in se vgreza v mrak,
ker ne more nositi bremena.
Nobeden ga ni zdržal.*

Izginile so iluzije o pričah, ki bi lahko posvečevale naše smrti in jih delale rodovitne. Le ena priča je ostala: brezkončna zemeljska ravnina. Ta priča je večna, toda kruta in požira nas s temnimi žreli. Ne posvečuje nobene želje, nobenega namena, nobene ljubezni: oči in zobje mrličev, ki so vanjo zasejani, so jalova setev. Celu spomini na življenje se v njej izgubijo:

*In če se bova srečala
(dve koščeni zgubljeni roki
na dnu zemlje),
se ne bova nič več spoznala.*

Toda razen zemlje ni nikogar, ki bi nam pričal o mrlištvu tistih, ki so odšli pred nami. Zato verzi, ki jih bom zdaj navedel, niso personifikacija, temveč religiozno izkustvo:

*Le zemlja bo ljubila moje telo.
Z neštetimi rokami me bo gnetla,
z neštetimi usti požirala.*

V pradavnih religijah ni bil božanski tisti, ki si je priboril oblast nad dogajanjem tega sveta, temveč tisti, ki je zmožni sprejeti umrlega v svoje naročje. Sledove te prvobitne religioznosti bi morda lahko še danes ponekod našli v kmetskem oboževanju zemlje. Zemlja v poeziji Daneta Zajca je presunljivo živa z vsemi svojimi gorami, gozdovi in rekami — kruta, toda sveta priča našega mrlišтва. Tako zvesta priča našega dokončnega poraza pred smrtjo, da postanemo eno z njo, ko umremo. Človeku, ki doume razmerje med krvniki in žrtvami, je ljubše, da se spremeni v zemljo, v to neskončno grobnico, polno

zdrobljenih kosti in trohnobe, kakor da bi se uklonil poziciji krvnika in sprejel njegovo oblast:

*Zlobni prežeči lovec,
od kod oprezuješ name.*

*Padi vame
kot ognjena krogla.*

Sežgi me.

*Naj bom zemlja
pod nogami divjih živali,
glas iz višav.*

Kdor je spoznal človeško nemoč pred univerzalno umrljivostjo, kdor je spoznal neizogibno človeško izročenoost smrtnemu porazu, tistemu se gnusi, da bi sklepal kakršnekoli krvniške pogodbe s smrtjo. Tisti človek bo za pričo svoje telesne prihodnosti raje izbral zemljo z njenimi temnimi žreli kakor krvnika.

Je ta upor ljubezen do zemlje? V pesmi Druga luč se zdi, da vetrovi, ki vejejo izza daljnih gora, prinašajo neko sporočilo o tistih, ki jih je zemlja sprejela pred nami. Zdaj nas ni v deželah, odkoder prihajajo ti vetrovi; in če kdaj zaslu-timo, da smo nekoč v njih že bili, se razblini občutek za našo navzočnost v krajih, kjer zdaj prebivamo. In dostop v tiste dežele nam branijo daljne gore z grozeče nasršenimi obrazi, razcvetelimi v cvetne liste iz rezil.

JURE DETELA

DANE ZAJC

Shpesh duket se kur flasim mbi opusin e tërë të një poeti, tregojmë njëfarë injorimi ndaj poezish të caktuara. Jo rrallë më kaplon nostalgji e pikëllim për kohët, të cilat nuk ishin aq të ngarkuara nga kulti i individualitetit të artistit sa e sotmja dhe për këtë arsye kanë ditur më mirë të kultivojnë koncentrimin, kanë shestuar gjatë deri tek përpunimi i plotë i produkteve artistike. Veçanërisht më dhimbsen kohët, ku anonimiteti i plotë i poetit ishte kreni e natyrshme e artistit. Mos nuk na u ka dhënë fati që në çdo kohë të jetojnë poetë, që shkruajnë me ambiciet që poezitë e tij të bëhen pjesë e traditës universale poetike? A mos nuk janë gjithë ato që na mundësojnë njëjtësinë reciproke në të kuptuarit e strukturave gjuhësore të një poezie, një trashëgimi jona e përbashkët? Do të ishte komunikimi me poezinë fare i mundshëm pa këtë farë njëjtësimi.

Për shkak të këtyre mendimeve i jam gëzuar propozimit të redaktorëve të Alternativës, për të bërë zgjedhjen e poezive të Dane Zajcit që do t'i përkthenin në shqipe. Gjatë leximit jam përpjekur ta flak nga mendja atë se poeti ka shkruar edhe shumë poezi *tjerafare*. Nga libri me titull Bar i djegur zgjodha poezitë Sorrat, Gjëra të vdekura, Dy skifterë, Mbjellje shterpe, Krizantemat, Do të jesh vetëm, Toka do të më puth, Karaxha i madh, Lumi dhe Rebelimi. Nga libri "Gjuhë nga dheu" u zgjodha poezinë Dhjetori, nga libri "Vrasësit e gjarpërinjve" zgjodha poezitë Zëri, Tas uji dhe Kopshti, nga libri "Komplotet" mora poezitë Nuk ishte thirrje, Ana matanë malit, Tjetra ditë, Tufa dhe S'është dhuratë. Më duhet të pranoj se poezitë e Zajcit i zgjodha sipas parimeve që i përdor kur formësoj poezitë e mia. Nuk do t'i eksplikoj kriteret, sepse lexuesi po kujtoi se janë të rëndësishme do ta ketë të qartë nga poezia ime. Ta them se i ik përdorimit të mjeteve retorike, që s'do t'i përdorte Empedokles, Ovides e Homeri, prandaj është e qartë se hapëron në seleksionimin tim poezia e Dane

Zajcit me arkaikësinë që për njohësit e poezisë së Zajcit është mbase befasuese. Në atë arkaikësi zbulohet në mënyrë veçanërisht të qartë pamja e atyre porosive që tek poezia e Zajcit gjithnjë i kisha në zemër.

Gati një çerek shekulli ka nga koha kur për herë të parë lexova Dhjetorin, Mbjelljen shterpe, Gjërat e vdekura dhe Lumit, dhe qysh atëherë kam ndjerë se urtia e atyre poezive është më e lashtë, më e qëndrueshme dhe më e parë se të gjitha ato farë zbukurimet e botëkuptimet kulturore—civilizuese në emër të historisë, me të cilat atëherë poetët sllovenë të shumtën shkruanin për vdekjen, vdekshmërinë, mbytjet e zhdukjet. Më ka befasuar guximi me të cilin poezitë e Zajcit sajohen me absurditetin e lakuriqësisë së vdekjes: asnjë iluzion mbi ardhmërinë e njeriut kur cilado vdekje do t'ishte e plleshme. Sepse vdekja pamëshirshëm i merr të gjitha, të gjithat, çfarë na është e njohur mbi ardhmërinë dhe çfarë parandjejmë për të.

Pak më vonë u botua poezia Gërçamë uji. Sa i çmueshëm ai zë këshillues midis marrëzisë vetëvrasëse sllovene, se vdekja është fatkob i të gjithë njerëzve dhe asnjë fuqi njerëzore nuk mund ta mposht atë. Si dhe ajo se vetëvrasja assesi nuk mundëson fitore mbi vdekjen:

*Dhe plaga në shpinën e tij dhe shkalla e madhe e zezë,
nën të cilën dorëzohet trupi dhe humbet në errësi,
ngaqë s'i qëndroi barrës.
Askush s'i qëndroi*

U zhdukën iluzionet mbi dëshmitarët që do të bekonin vdekjet tona duke i bërë të frytshme. Vetëm një dëshmitar mbeti: rrafshina e pafund e tokës. Ajo dëshmitare është e amshueshme, por e ashpër dhe na përbin me gllënjka të errëta. Nuk bekon asnjë dëshirë, asnjë synim, asnjë dashuri: sytë e dhëmbët e të vdekurve, që janë mbjellë në të, janë mbjellje shterpe. Bile edhe kujtimet ne jetën humbin në të:

*Edhe po u takuam
dy duar ashtore të humbura
në fund të dheut
nuk do të njihemi më.*

Porse pos tokës s'është askush, që do të na fliste mbi vdekësinë e atyre që ikën para nesh. Kësodore vargjet që do t'i citoj s'janë personifikim po përvojë religjioze:

*Vetëm toka do të puth trupin tim.
Me duar të panumërta do të gllabërojë,
me gojë të panumërta do të përbijë.*

Në religjionet e stërlashta nuk ishte hyjnor ai që vinte pushtetin mbi ngjarjet e kësaj bote, po ai që arrinte përgjithmonë të pranonte të vdekurin në parzmat e tij. Gjurmët e atij religjioziteti nismëtar ndoshta do të mund t'i gjenim në himnizimin e tokës nga ana e bujqve. Toka në poezinë e Dane Zajcit është tmerrësisht e gjallë me gjithë brigjet e saja, pyjet e lumenjtë—e ashpër, por dëshmi e shenjtë e vdekësisë sonë. Kështu dëshmitarja besnike e humbjes sonë përfundimtare, të bëhemi një me të, kur do të vdesim. Njeriut që kupton raportert midis gjakatarëve e viktimave, i pëlqen më shumë të shëndërrohet në dhe, në atë varr të pa fund përplot kocka e kafka të dërmuara, që t'i shmanget pozitës së gjakatarit e të pranojë pushtetin e tij:

Gjahtar i qëllimit ogur
nga ku veneron në mua.
Bjer në mua
si gjyle zjarri.
Digjmc.
Të bëhem dhe
nën këmbët e egërsirave,
zë nga majat.

Ai që ka njohur brishtësinë njerëzore para vdekësisë universale, kush ka kuptuar dorëzimin e domosdoshëm njerëzor para humbjes nga vdekja, atij i pështiroset të bëjë çfarëdo ujdje me vdekjen. Ai njeri si dëshmitar të ardhmërisë së grupit të tij më me qejf do të zgjedh dheun me damarët e errët se sa gjakatarin.

Eshtë ky rebelim dashuri ndaj dheut? Në poezinë Mbase dritë tjetër, se erërat që fryjnë nga maja të largëta sjellin porositë e atyre që dheu i mori para nesh. Tash nuk jemi në vendet nga vijnë ato erëra; nëse ndonjëherë kujtojmë se kemi qenë dikur në to, atëherë hallakatet përshtypja e pranisë sonë në vendet, ku gjallërojmë tash. Qasjen atyre vendeve na e pengojnë majat e largëta me pamjet e mrrolshme e kërcënuese, të lulëzuara në fletë lulesh nga luskat.

DANE ZAJC DHJETORI

Si do të dënesësh
lotë të mëdhenj të njelmët,
kur do të shkosh rresë së borës vetëm.
Lart mbi ty do të fluturojnë zogj.
Zogj të zez dhjetori.
Do të vdesin nga vaji yt.
(Ai do të jetë larg para teje.
Do të jetë vetëm gjurmë e thellë e shputave të lëna.
I hapave të qetë në borë.)

Ti do të dënesësh gjithë rrugën e gjatë,
derisa të mos përloësh
sytë e mëdhenj e të butë në borë.
Tevona do të perëndosh në borën e thellë.
Era do të fishkëllojë me gjuhë luspore
lulevjollcat në gjoksin tënd të zbuluar.

Pastaj do të ndalet rruga jote.
Ai do të jetë larg tej malesh,
Në skajin tjetër të botës
kur do të lëmojë flokun tënd kadife të kuqrremtë
vdekja qelqore e dhjetorit.

Kufomë në borë.
E ngrirë dhe e shkelur kufomë.
Brinjët i dalin nga gjoksi.
Brinjë të kuqrremtë.
Bora i bie në sy.
E ashpër dhe e bardhë.

LUMI

Vrap, lum i turbullt.
Lumë i ngrirë i heshtjes.
Yjet notojnë nëpër ty
si lule kuqrrime të ftohta.
Të mbyturin mbulon
me lym
e pas një viti i del
nga goja e sytë
bari.

O të fundosesh, të mbytesh.
Dhe kur bie në vorbull të heshtjes
njeriu,
nuk trandesh.
Nuk valavitesh.
Hesht me heshtjen,
të akullt si t'ishte shtrati yt
plot nepërka.

Vrap me yjet,
që i zhyt në baltë,
me klithma që u zë frymën me rërë,
vrap, lum i pandjenjë.

O të fundosesh,
kur çasti ndryshk
fjalën: Pakuptim.
E të jesh lule kuqrrime e ngrirë
në moçalin e harruar.

DHEU DO TË MË PUTH

Enuk do jesh e zonja të ndihmosh
duart e mia,
që do të thërmohen.
E s'do jesh e zonja të fshish dheun
që do të flejë në buzë të mia.

Sytë e mi do të jenë plot rërë
e ujë.
Sytë e mi s'do të shohin hiç kurrë.

E gishtat tu të puthur
s'do të shkojnë flokëve të mi,
të ftohtë e të lagur.
Dhe s'do vish
dhe me trupin tënd
s'do të ngrohësh trupin tim.

Trupi im do të jetë aq i ftohtë,
aq i akullt,
aq i braktisur.

Vëttëm dheu do të puth trupin tim.
Me duar të panumërta do të më marrë ngrykë
me gojë të panumërta do të më përbijë.

E pastaj
s'ke si i flet
plisit të dheut:
Kjo është zemra e tij
që më deshti.

KËNGA MBI RININË

Vdekja është
e njohura ime e vjetër.
Unë jam druri,
që s'do t'i dalin gjethe kurrë.

Kaherë fle vjeshta
në degët e mia.

Në shpirt bart lëmshin
e fijeve të gjakosura
në hurin e lisit
Në shpirt bart
varre të shpëluara
edhe rashtën,
shtruar në dheun e rimtë.

Shtrirë: Shih, isha.

(Tragjedi e nënqeshje,
ngaqë veshët e saj
dhe sytë

janë zënë me mellë.)

Mbi të sillet
e dhembshmja, e zgjatura këngë.

Dhe psherëtima.

Dhe i errti qiell vjeshtak.

Dhe lulja le të kundërmojë

atje, ku s'ka aromë.

Ku asgjë s'ka.

Kafka me shprehje të paqarta.

Vdekja është e njohura ime e vjetër.

Unë jam dru,

xhvoshur në varre.

Në shpirt bart lakun e ëndrrave të mia.

In ree Gospodar

Ce arecaš

Albanca in Voika

Ubi Albania

Ko je Albanca in Voika

linhman of se

linhman of se

linhman of se

linhman of se

linhman of se

GËRÇAMË UJI

(Kur të vdesësh nëntëmbëdhjetëvjeçar, për vdekjen e ke faj nënës)

Thuase pas hatasë e kish ezmihë në kopshtin e më të shenjtes,
apo të kish vënë në zjarr shaminë e saj të së dielës,
ase të kish rrëzuar dërrasën me vazo me lulekurorën.
Si të kish qenë vjedhës i arit të saj martesor,
sikur në endrrat e papërgjegjësi,
kur ai s'ishte ai,
apo kur dremiti roja e sjelljeve të tij,
hodh gurin në vatrën e shtëpisë,
dhe vatra u rrënuar
dhe tash rri para të çarës,
që gjithnjë më shumë largohet, gjithnjë më shumë hapet,
nga ajo botë syjon në të si faji, i bërë në pelena,
e ai e pret
e përshpërit : O zot, ç' do të thot nënokja.

Edhe plaga në shpinën e tij
edhe lulet e të gjitha ngjyrave të kuqe
ndizen e fluturojnë lart si raketë,
lart në krye që është qielli,
të cilit i shqyhet mesi i kupolës.
Edhe plaga në shpinën e tij edhe shkallë e madhe e zezë,
nën të cilën jipet trupi dhe humbet territ,
se nuk e bart peshën.
Askush nuk i qëndroi.

Deri kur të zgjas luftë e errshme e trupit me plagën?
Erdhi dorë e botës së papranishme.
Ndërpreu luftën e të panjohurit me të panjohurën.
Nuk qe me kumtin e faljes.
Veç në ëndrrat e plumbëta, si e thërret,
se si fajtori me qafën bërë shoshë
lut për një gërçamë uji,
se vdekja e eçton,
ajo që është strukur në fytin e tij.

Pëktheu S. Kabashi

KOHA ËSHTË E MASKARENJVE,
PO ATDHEU ËSHTË I SHQIPTARËVE

A. ASLLANI

ALI PODRIMJA KDO BO UBIL VOLKA

PRIŠTINSKO PREDMESTJE

Saj bo bolje saj bo bolje

*In leti dan noč se spušča
Mesec leto mine*

po hišah iz pločevine

Saj bo bolje saj bo bolje


*Otroci se z mačkami igrajo
z mišmi spijo*

Ženske nosijo raka v dojki

*Pod streho si možje trebijo uši
in se režijo črnemu nebu*

Saj bo bolje saj bo bolje

*Tudi pankrtov bo manj
Priština pa so bo spustila v Lab*



RAZPAD

V izgubljenem prostoru

Vem kje je moj dom

Kje izvir kje njiva

V mojem domu lazi kača

Na mojem izviru pije on

Na moji njivi njegova roka

Ko se spusti noč

In izgine volčja sled

Pride iz daljave angel

Prosi me naj mu povem

Kje je njegov dom kje izvir

Kje njiva

V izgubljenem prostoru

So mi znamenja moj dom

Moj izvir in moja njiva

KDO BO UBIL VOLKA

In reče Gospodar

Če srečaš

Albanca in Volka

Ubij Albanca

Ko je Albanec to slišal

se je nasmehnil

in zvil cigareto

Če me umoriš bedak
kdo bo potem ubil
Volka

Naj se Bog usmili črede

VOZEL

Razlika med
Belo in
Črno Ovco
je v tem da je mogoče

Črno Ovco
videti od daleč
in da prva stopi v
Klavnico

Bela Ovca
moli k Bogu da bi imela
zdrav porod

in da bi se Lovec vrnil
iz Strašnega Gozda
z Volčjo Kožo

KDAJ BOŠ SPREGOVORIL O ALI PODRIMJA

Na dlani ugaša zvezda
naravnost v oči nas gledaš in požiraš
tvojega hrbta nikoli nismo videli o Ali Podrimja

Stojiš pod mrzlim nébesom in molčiš že leta
še verjameš
v človeka

Ime ti ponarejajo
priimek in podpis in rojstni list
ime očeta matere prednikov rodni kraj

otroške pravljice igrače
heroje žalostinke praznike

Tvojemu jeziku staremu in rodu
se rogajo
s hudourniki črnih laži

Ti pa molčiš o Ali Podrimja
še verjameš
v človeka

V mračnih izbah v kletih srednjeveštva
snujejo elaborate pošastne etikete prekletstva
hajke pregone selitve
divji lov

Sveče gorijo in se utrnejo diši kadilo kapljajo besede telesa skrivnosti
z glavo v torbi na tuje hodijo otroci
Žena tke sukno in ga para
v Stolpu iz papirja

Ti pa molčiš o Ali Podrimja
še verjameš
v človeka

Daljša se senca nad glavo vrane na nebu krokarji
svetle kodre si razčesavaš
z grudo prsti v nedrih
na dolgo dolgo pot se podajaš

V mondeni Evropi si Albanais
Arbreš v Italiji Arvanitas v Grčiji
v Turčiji hvala bogu Arnavt
v Ameriki konzervirano meso
in nič več in nič več

Kdo ve koliko jezikov govori tvoj bog

Ti pa molčiš o Ali Podrimja
še verjameš v človeka

Ampak ampak
kdaj boš končno spregovoril človek
ali pa se moraš najprej roditi

NAVZDOL

Samo eno stran je slišati
samo eno okno se odpira
in Sonce ne kaplja nikjer drugod

Ko pa druga stran spregovori
bo potem prva padla v gluhost
na stežaj odprto Okno bo zaprto?

Bo Sonce kanilo na streho vegasto?

Slišati je samo eno stran
samo eno stran
in žvižganje z dlanmi zatisnjena ušesa

Ko pa druga stran spregovori
bodo Ljudje nehali lajati?
Bomo dohiteli Sonce navzdol po bregu?

ŠČENE

Pri Votlem Hrastu se je prikazal
Goro prekril s svojim stopalom
Meč mu pot varuje

Menjaval sem gospodarje
s časom menjaval golgote
dokler nisem našel Doma

*In sem odprl desno oko
na levo uho oglušel
Zanj so bile moje pesmi uspavanke*

*Ko je iz Kroga izginila Lisica
se je Dom napolnil z mišmi
Gora je izdahnila na panjih*

*Pasji sin je zastrigel z ušesi
pri Votlem Hrastu
v moje Telo zasadil kremplje*

Ščene je postalo Pes

PISMO PRIJATELJU j. z.

*Ko se ne bi bil premaknil
bi me našel v Gulagu
ali na Dolgih Gomilah*

*Po poljih so se podgane razgomazele
Pasti so nam potrebne mišolovke
Dohitevajo nas črne vode*

*Glej vsak dan se vzpenjaš
vrh Alp
da bi me videl v metežu*

*Prijatelj jaz pa ti
ves čas pišem
svoje poslednje pismo*

Prevedel Jaša Zlobec


O AVTORJU

Ali Podrimja (1942, Gjakova / Djakovica) je brez dvoma eden največjih sodobnih albanskih pesnikov — tako na Kosovu kot v Albaniji, kjer so mu, mimogrede, izdali dve knjigi pesmi.

Svojo prvo zbirko Thirrje (Klici) je izdal še kot gimnazijec davnega leta 1961. S svojo poetiko, pri kateri se modernistični izraz veže na tradicijo, predvsem pa na izjemno vero v moč besede, je hitro stopil na odmevno pesniško pot v Jugoslaviji in Evropi. Dvanajst knjig poezije je napisal doslej, zadnjo prejšnje leto, Fund i gëzuar (Srečen konec). Podrimjo smo precej prevajali tudi na Slovenskem, saj sta pri nas izšli dve njegovi zbirki, leta 1976 pri Lipi Suženj pesmi, štiri leta pozneje pa pri Mladinski knjigi Pesmi. Uvrstili so ga v vrsto evropskih pesniških antologij, samostojne knjige pa so mu tiskali tudi v srbohrvaščini, makedonščini, madžarščini, nemščini, italijanščini, turščini in arabščini.

Ali Podrimja kot urednik za tujo književnost dela v prištinski založbi Rilindja.

J. Z.



DR. ALI ALIU

FRONTI I PËRBASHKËT ANTISHQIPTAR

Njëra nga frazat më të shpeshta të burokracisë jugosllavo kosovare është »të krijojmë frontin e përbashkët«. Për njohësit e diskursit politik të këtushëm fraza lexohet drejt: Front i përbashkët i Sërbëve, Malaziasve dhe Shqiptarve në luftë kundër separatizmit shqiptar dhe drejt »stabilizimit të gjendjes ende të ndërlikuar«. Kursi i tillë i frontit të përbashkët dhe stabilizimit të gjendjes së ndërlikuar në fakt synon ta mbajë gjendjen e ndehur dhe, sipas nevojës ta acarojë herë pas here përmes masave që nuk dallojnë fort nga ato të gjendjes së administrimit ushtarak. Megjithatë, fronti i përbashkët i dëshëruar (sic) edhe pas inaugurimit të garniturës së re politike në Kosovë nga Beogradi, s' po krijohet dot, pra as stabilizimi i gjendjes. Arsyeja kryesore për moskrijimin e këtij fronti, sipas diskursit politik zyrtar të Sërbisë, që është një me atë të shtypit të mjedisit të vet, është »procesi i ngadalshëm i diferencimit të Shqiptarve«. Ky ngadalësim, sipas kësaj logjike, nxitka moskënaqësi, nervozizëm dhe pasiguri në mesin e Sërbëve... Nga kjo del qartë: sa më brutal dhe gjithëpërfshirës do të jetë procesi i diferencimit, aq më lehtë do të arrihej fronti i përbashkët dhe, aq më të qetë, më të kënaqur dhe më fatlumë do të ishin Sërbët në Kosovë!

Ja si duket nga brenda ky kurs i politikës sërbë. Dihet se deri në verën e vitit 1988 (pra pa llogaritur ngjarjet e vjeshtës së atij viti dhe ato të pranverës së këtij) 580 mijë Shqiptarë, formash të ndryshme janë diferencuar nga ana e poliicë dhe partisë policore në Kosovë. Numri i të diferencuarve gjatë 12 muajve të fundit nuk është shpallur zyrtarisht, por lirisht mund të inkasohen disa dhjetra mijë. Është poashtu e sigurt se diferencimi i fundit, që po rrjedh, për nga vrazhdësia e kapërcen atë të fillimit të viteve tetëdhjetë. Kam parasysh në radhë të parë spastrimet dhe represaliet ndaj kuadrove profesionale në ekonominë kosovare. Edhe pse mungojnë të dhënat zyrtare, flitet se mbi 80 përqind të bërthamës udhëheqëse profesionale ekonomike nga radhët e Shqiptarëve janë larguar a pezulluar nga vendet e punës. Ata që nuk i preku fshesa e hekurt e izolimit u diferencuan formash tjera, kryesisht pas përjashtimit nga LK-ja. (Do të ishte shok i vërtetë për opinionin sikur të publikoheshin me mija vendim urdhëresa partiake nga komitetet komunale me anën e të cilave hiqen drejtorë fabrikash, repartesh, udhëheqës të organeve vetëqeverisëse, redaktorë, shefa, etj.) Ja çfarë thotë egzekutori kryesor i diferencimit të Shqiptarve në Kosovë, Tomisllav Sekulići, sipas Borbës së 25 Tetorit: »Glavni izvršioc i nosioci niza kontrarevolucionarnih aktivnosti bili su ljudi iz privrede. Sada nam je stanje takvo da smo velik broj njih smenili a zamene nema, što ima vrlo teške posledice na privredu Kosova.«

Sipas ligjit mbi obligimin e punës mijra punëtorë kaluan dhe kalojnë dyerve të diferencimit. Prej 1200 xehetarëve të Stari Tërgut, 800 e përjetuan këtë proces. Disa qindra u dënuan dhe vuajtën me muaj nëpër burgje, e qinda tjerë ende po e vuajnë atë. Qinda arsimtarë, pas dënimeve partiake, janë pezulluar apo në procesin e pezullimit nga puna. Në mbledhjet e komiteteve komunale, debatohet vetëm duke bilancuar numrat e Shqiptarve të diferencuar si të ishin servise të cilëve nga qendra u është ngarkuar vetëm kjo detyrë. Nga mbledhja e fundit e komitetit komunal të Gjilanit bie fjala, u tha se dënimesh të ndryshme partiake deri më tash janë diferencuar mbi 500 Shqiptarë, që natyrisht është

fare pak, ende në fillim, prandaj nuk po krijohet dot fronti i përbashkët dhe nuk po stabilizohet gjendja. Me diskursin e këtij kursi politik janë plot faqet e Rilindjes që këtu me të drejtë e quajnë »vëlla i vogël i Politikës«, njësoi si RTV të Prishtinës, filialë të simotrës beogradase.

Fushatës së tillë më cinike antishqiptare sikur nuk i shihet fundi. Ka edhe supozime të tilla: ajo do ashpërsohet edhe më, deri sa nuk arrihet fronti i përbashkët i Sërbëve, Malaziasve dhe Shqiptarve të ndershëm. Meqë kësi shqiptarësh, ashtu siç është thënë moti edhe për popujt e tjerë, nuk ka më shumë se 2 përqind, pushteti i frontit të përbashkët kosovar me këtë rast, për kah përqindja e pakicës, do ta linte pas edhe pushtetin e pakicës në Afrikën e Jugut.

Është e qartë se procesi i tillë i diferencimit të Shqiptarëve i ka shkaktuar gati në pakthim mundësitë e bashkëjetesës. Me çdo hap të ri, kursi i kësaj politike sharzon edhe për një shkallë në humnerë. Por që tërë kjo fushatë me premisa patologjike ushtrohet nën obmrellën e Federatës, përmes gjendjes së jashtëzakonshme dhe masave tjera, është anë më shqetësuese dhe më bren-gosëse. Pikërisht mbulesa e tillë e Federatës përjetohet si horizont i mbyllur nga ana e popullit Shqiptar por edhe nga opinioni dhe diplomacia ndërkombëtare.

Shikimi më i zakonshëm e ka të qartë se në Kosovë është pezulluar sistemi juridik dhe se rrjedhat e jetës ecin si proces diferencimi policor i Shqiptarëve, se edhe ajo ekonomi e brishtë është pezulluar plotësisht dhe është vënë në shërbim të politikës serbe, se shumica dërmuese e popullit shqiptar po abstenon nga të gjitha aktivitetet e jetës publike; edhe logjika më elementare e vëren se abstenimi i xehetarëve të cilët në pranverën e këtij viti, u desht të hynë thellë nën dhe për ta çfaqur lirisht mendimin, me çfarë vërtet tentuan ta mbrojnë Jugosllavinë e AVNOJ-it, abstenimi i tyre pra, filloi atëhere kur filloi edhe diferencimi policor në mesin e tyre dhe, sa më brutal që bëhet ky diferencim, aq më i vendosur abstenimi. Nga ana tjetër jehon zhurma e guzhinës së Beogradit për çdo ditë: në Stari Tërg gjendja nuk po përmirësohet, po përkundrazi po keqësohet, me që diferencimi ka mbetur në gjysmë të rrugës! Dhe pikërisht në mbështetje të këtij kursi, organet shtetërore dhe partiake të Federatës krijojnë mbulesë që makineria për diferencim të veprojë pa pengesa. a thua vallë, kreatorët e fushatës së tillë antishqiptare e kanë të qartë përfundimin kosovar?

DR. ALI ALIU

SKUPNA PROTIALBANSKA FRONTA

Ena od najpogostejših fraz jugoslovanske in kosovske birokracije je »naredimo skupno fronto«. Poznavalci tukajšnjega diskurza frazo berejo pravilno: skupna fronta Srbov, Črnogorcev in Albancev v borbi proti albanskemu separatizmu s ciljem »stabilizacije še vedno zapletenega stanja«. Takšna smer skupne fronte in stabilizacije zapletenega stanja v resnici poskuša obdržati napetost. Če je treba tudi tako, da ga z ukrepi, ki se ne razlikujejo mnogo od tistih iz vojne uprave, poslabšuje. Toda skupna fronta in stabilizacija se nikakor ne ustvarita, kljub nastavljanju novih političnih garnitur na Kosovu iz Beograda. Glavni vzrok, da se ta fronta ne izvede, je po uradnem političnem diskurzu iz Beograda, ki je enak tisku iz tega okolja, »počasen proces diferenciacije Albancev«.

Tak počasen proces diferenciacije po njihovem mnenju izziva nezadovoljstvo, nervozo in negotovost med Srbi... Iz tega jasno sledi: čimbolj brutalen in vsesplošen bo proces diferenciacije, tem laže bomo dosegli skupno fronto, s tem pa bodo Srbi na Kosovu bolj mirni, bolj zadovoljni in srečnejši!

Poglejmo, kako izgleda odznotraj ta smer srbske politike. Znano je, da je do leta 1988, če ne računamo dogodke jeseni tega in spomladi letošnjega leta, na razne načine policija in policijska partija na Kosovu izdiferencirala 580 000 Albancev. Število izdiferenciranih v zadnjih 12 mesecih ni uradno znano, a jih lahko ocenimo na desetine tisočev. Nesporno je, da zadnja diferenciacija, ki še teče, po grobosti presega tisto iz začetka osemdesetih let. Mislim predvsem na čistke in represalije profesionalnih kadrov v kosovskem gospodarstvu. Čeprav nimamo uradnih podatkov, se govori, da je bilo okoli 80 % jedra profesionalnega gospodarskega vodstva iz vrst Albancev odstranjenega ali suspendiranega z delovnega mesta. Tisti, ki jih ni zajela železna metla, so bili izdiferencirani na druge načine, v glavnem z izključitvijo iz ZK. (Za javnost bi bil pravi šok, če bi objavili tisoče odločb in partijskih ukazov iz občinskih komitejev, s katerimi odstranjujejo direktorje tovarn, oddelkov, vodje samoupravnih organov, urednike, šefe itd.). Glavni eksekutor diferenciacije Albancev na Kosovu Tomislav Sekulić pravi (Borba, 25. 10.): »Glavni izvrševalci in nosilci kontrarevolucionarnih aktivnosti so bili ljudje iz gospodarstva. Odstavili smo veliko število ljudi, a zamenjave ni, kar ima hude posledice v kosovskem gospodarstvu.«

Po zakonu o delovnih obveznostih je na tisoče delavcev šlo ali še hodi skozi vrata diferenciacije. Nekaj sto jih je mesece preživelo v zaporih, medtem ko jih na stotine prestaja kazen. Na stotine učiteljev je bilo suspendiranih z delovnega mesta po partijski kazni ali pa so sedaj v postopku diferenciacije. Na sejah občinskih komitejev samo seštevajo izdiferencirane Albance, kot da so le servisi, ki jim je iz centra dana samo ta naloga. Na zadnji seji OK ZK v Gnjilanu je bilo na primer rečeno, da so na razne načine izdiferencirali 500 Albancev, kar je seveda premalo, še vedno le začetek in zato se ne uresničuje skupna fronta in stanje ne stabilizira. Z diskurzom takega političnega kurza so polne tudi strani Rilindije, zato jo tu po pravici tudi imenujejo »Politikin mali brat«, podobno kot imajo RTV Priština za filialo RTV Beograd.

Taki cinični antialbanski kampanji ne vidimo konca. Obstajajo pa tudi naslednja mišljenja: ta kampanja se bo zaostrovala tako dolgo, dokler se ne bo uresničila skupna fronta Srbov, Črnogorcev in »poštenih Albancev«. Glede na to, da je takih Albancev, kot je bilo nekoč rečeno za druge narode, le 2 odstotka, bo kosovska oblast skupne fronte glede na odstotek manjšine prednjačila pred Južno Afriko.

Jasno je, da je tak proces diferenciacije Albancev skoraj popolnoma onemogočil skupno življenje. Z vsakim novim korakom pelje politika še globlje v prepad. Pri tem pa najbolj moti dejstvo, da poteka ta kampanja pod dežnikom federacije z izrednimi in drugimi ukrepi. Ravno to pokritje federacije Albanci in mednarodna diplomacija doživljajo kot zaprto obzorje.

Že najpovršnejše opazovanje odkrije, da je na Kosovu razveljavljena pravna država in da življenje teče v znamenju policijske diferenciacije Albancev, da je tudi to krhko gospodarstvo suspendirano in postavljeno v službo srbski politiki, da se večina albanskega prebivalstva ne udeležuje aktivnosti javnega življenja. Tudi najbolj elementarna logika pokaže, da se je abstinenca rudarjev, ki so morali spomladi pod zemljo izražati svoje mišljenje, s čimer so v

resnici branili avnojsko Jugoslavijo, začela s policijsko diferenciacijo med njimi. Bolj odločna je diferenciacija, odločnejša postaja abstinenca. Po drugi strani pa beograjska kuhinja vsak dan trobi: v Starem trgu se stanje ne izboljšuje, diferenciacija je ostala na pol poti. Ravno temu pa dajejo partijski in državni organi federacije pokritje, da lahko stroj za diferenciacijo neovirano deluje. Ali je kreatorjem takšne antialbanske politike jasen konec?

ANATOMIA E PAPËRSHTATSHMËRISE

Ne jemi një grup profesorësh të Qendrës Arsimore 25 Maji të Preshevës (më parë Skënderbeu), të përjashtuar nga LKJ me vendimin e KK të LKS (1. 07. 1989), masë kjo vendimtare që të na shpallin moralo-politikisht të papërshtatshëm (28.07.1989), dhe për këtë shkak me vendimin për zbatimin e masave të përkohshme na është ndërprerë marrëdhënia e punës më 11. 09. 1989.

Do të përpiqemi ta sqarojmë shkurtimisht procesin e fshehtë nëpërmjet të cilit nga arsimtarë shembullorë (punë kjo që mund të vërtetohet me një varg mirënjohjesh dhe shpërblimesh, që nga niveli i shkollës dhe i komunës, deri tek ai federativ), jemi shndërruar, se çel e mbyll sytë, në »nacionalistë dhe separatistë të dëshmuar«. Për t'i marrë mirënjohjet më të larta ka qenë e nevojshme një punë e mundimshme shumëvjeçare. Ndërkaq, për të na renditur në listën e fajtorëve kujdestarë, mjaftuan dy mbledhje të KK të LK dhe një mbledhje e Tubimit të punëtorëve. Në këto mbledhje komunistët dhe punëtorët e Qendrës nuk e pranuan propozimin për ndryshimin e emrit të Qendrës, filli i të cilit gjendet në bojkotimin e mësimin nga nxënësit e kombësisë serbe, sikundër as materialin e KK të LKS të Preshevës në të cilin Qendra në mënyrë të përgjithësuar dhe pa argumente fajësohej për lëshime mjaft të mëdha. Njëherësh në ato mbledhje është diskutuar për mosvajtjen e nxënësve dhe të arsimtarëve shqiptarë në mitingun e mbajtur më 8.10.1989 në Preshevë. Në të vërtetë, në këtë miting morën pjesë vetëm dy drejtorë dhe tre punonjës të kombësisë shqiptare nga më shumë se 100 sish të cilët punojnë në këtë Qendër.

Politokracia e fuqishme lokale, për t'i fshehur gabimet e veta të mëdha që i bëri me rastin e organizimit shkel e shko të mitingut në fjalë (në të cilin ndër të tjera iu këndua edhe »Tokës së Dushanit«), si edhe me rastin e orvatjes së ngathët që gjatë një mbledhjeje me dhunë t'i ndryshohej emri Qendrës, shpejt e shpejt, duke s' hfrytëzuar të gjitha mjetet që i kishte në dorë, e akuzon Qendrën për veprimtari nacionaliste dhe separatiste. Paralelisht përgatitet vënia e masave të përkohshme, si edhe shpërndarja e OTH të LK të Qendrës. Njëherësh jepet në diskutim publik materiali në fjalë i KK të LKS të Preshevës përplot me diskualifikime të përgjithësuar, të cilat assesi nuk mund të argumentohen. Po përmendim vetëm pohimin se në Qendër punojnë »profesorë me dijeni të mangëta, planet, programet dhe leksionet e të cilëve janë të ngjyrosur me nacionalizëm e separatizëm.«

Në të njëjtën kohë për Qendrën caktohet kontrolli i plotë i punës, të cilin e bën Enti për përparimin e mësimin i Vranjës, i cili angazhon edhe këshilltarë nga Leskovci dhe Beogradi. Ndonëse kontrolli u bë në psikozën e pritjes së lëshimeve më të rënda të cilat duhet ta vërtetonin diagnozën e dhënë që më parë, raporti i Entit, bashkë me lëshimet e vërejtura, vë në pah edhe mjaft mendime pozitive për punën e arsimtarëve. Mirëpo, në një atmosferë të këtille

nuk ishte interesante ana pozitive e punës së Qendrës, prandaj për këtë arsye për nevojat e Kuvendit të Komunës së »Preshevës shkurohet raporti themelor i cili kapte më shumë se 100 faqe, në gjithsej 18 faqe, në të cilin nëpërmjet seleksionit të zi shënohen vetëm të metat e punës. Mirëpo edhe në atë version aq të zi nuk ka kurrfarë dëshmish se arsimtarët paskan punuar sipas disa programeve të tyre nacionaliste dhe separatiste. Një fragment i këtillë i raportit të Entit pastaj iu dërgua delegatëve të KK, të cilët në orvatjen e dytë vendosën për vënien e masave të përkohshme në Qendër.

Të ballafaquar me mashtrime të këtive të rënda, pjesa dërmuese e punonjësve në diskutimet e veta u përpoqën që me argumente të tregojnë se këto diskualifikime janë të paqëndrueshme. Mirëpo, këto diskutime shërbyen që të mënjanohej mungesa themelore e materialit për Qendrën, prandaj në mbledhjen e datës 17.03.1989, KK i LKS të Preshevës, duke përdorur deri tani kritere të panjohura, shpalli listën e të papërshtatshëmve. Në këtë listë jemi futur ne, sigurisht për shkak se bashkë me më shumë se gjysmën e punonjësve të Qendrës folëm haptas për problemet e përmendura.

Këto mjaftuan që në dis mjete të informimit publik të nisë një fushatë e njëmendtë në të cilën jemi fajësuar se kemi vepruar nga pozitat e nacionalizmit dha të separatizmit shqiptar. Me këtë rast gazetarët ose i pranojnë në mënyrë jokritike akuzat pa mbështetje të KK të LKS të Preshevës, ose, më së shpeshti, shkojnë edhe më larg dhe montojnë diskualifikimet më monstruze.

Për të dëshmuar se ç'kemi pësuar gjatë kësaj kohe, po zëmë ngoje vetëm një shembull. Pas apostrofimit nga ana e KK të LKS të Preshevës dhe një vargu artikujsh në gazeta, paralelet me mësim në gjuhën serbokroate bojkotuan, orët e lëndëve të cilat i mbanim ne. Shkaku i këtij bojkotimi mund të mësohet po qe se lexohet procesverbali i këshillit të paraleles II-1 në të cilin thuhet: »... nxënësit nuk kishin vërjetje lidhur me zhvillimin e mësimin, as nuk u ankuan për sjelljet e tij ndaj tyre, por vetëm pse emri i tij kishte dalë në gazetë...«.

Ajo që ndodhi më pastaj ishte formalitet i thjeshtë. Ngase, pas heqjes së vetëqeverisjes në Qendër në skenë doli Këshilli katëranëtarësh, në të cilin që të dy përfaqësuesit e Qendrës nuk e kanë kryer fakultetin, ndërsa njëri syresh nuk është as në marrëdhënie të përhershme pune. Duke zëvendësuar jo vetëm Pleqësinë, por edhe Tubimin e punonjësve, Këshilli së pari ia ndryshoi emrin Qendrës, e pastaj largoi nga puna 12 profesorë.

Duhet të përmendet edhe fakti se Organizata themelore e sindikatës së Qendrës dha mendim pozitiv për të gjithë profesorët e larguar të Qendrës, mirëpo për Këshillin ky mendim nuk kishte rëndësi, ngase duket qartë se kjo punë ishte detyra e tyre kryesore për të cilën janë zgjedhur, ose më mirë për të cilin shkak edhe janë vënë masat e përkohshme në shkollë.

Nxjerrë nga revista Danas, 17.10.1989

P. s.

Nga Qendra Shkollore e Preshevës u larguan këta arsimtarë: Naser Nuhiu, Nazmi Jashari, Avon Shaqiri, Riza Halimi, Sami Hasani, Ali Ahmeti, Rexhep Rushiti, Halit Jusufi, Selajdin Avdiu, Vasfi Beqiri dhe Behlul Nasufi.

KRONIKANI DITARI

1. Gjykatësi i Gjykatës së Qarkut në Prizren (Sulejman Limani) e mori në pyetje Fadil Hoxhën sipas kërkesës së prokurorit të Qarkut të quajtur Skënder Morina. Ky ish ushëheqës i lartë partiak e shtetëror, i cili gjithë jetën nuk e ka lëshuar nga goja fjalën bashkim-vëllazërim, i cili më 1981 iu vërsul rinisë shqiptare, duke e fyer më fjalët më banale që nuk i duron letra, tashti akuzohet për nxitje të urrejtjes nacionale, racore dhe fetare. Për këtë vepër penale parashihet dënimi i prej 1-10 vjet burg. Mos e dhashtë zoti që Fadil Hoxha ta kalojë pleqërinë në burgun e shtetit të Titos që e deshi dhe e admiroi aq shumë.

2. Poeti Rrahman Dedaj u hoq nga kolltuku i drejtorit të »Rilindjes« dhe zbriti në karrigen e redaktorit të Redaksisë së Botimeve. Tani i ra ndër mend t'u afrohet shokëve të vjetër për t'ua dëshmuar burrërinë. Një poeti të njohur i qahet përse nuk ia sollën për nënshkrim Apelin e intelektualëve shqiptarë, por sikur harron që tekstin e po këtij apeli nuk lejoi të botohej në »Rilindje«. Flitet se në kohën kur po përpiloheshin listat e izolimit, ishin Rr. Dedaj dhe Beqir Hoti ata që propozuan të burgoseshin 15 gazetarë.

3. Shkrimtari për fëmijë, Rifat Kukaj, hoqi dorë nga kandidatura për kryetar të KK të LK të Prishtinës, për t'ia lëshuar vendin Gani Jasharit, alias Jashareviqit. Vallë e bëri këtë me dëshirë apo pse e donte kështu loja zgjedhore? Bashkëvendësi i Kukajt, Halit Tërnavci, i njohur si »shqiptar i ndershëm«, në mbledhjen zgjedhore të Komitetit të LK të Beogradit e »tundi« foltoren duke fshikulluar »nacionalizmin dhe separatizmin shqiptar«. Sipas rradakes së doktorit të shkencave, rezultati i punës shkencore të të cilit kufizohet vetëm në doktoratën e mbrojtur para rreth 20 vjetësh, si çerdhe e »irredentizmit« na paska qenë edhe Shoqata PËRPJEKJA e Beogradit që u mbyll me urdhërin e prerë telefonik.

4. Ibrahim Rugova dhe Engjëll Sedaj qëndruan në Nju Jork për të marrë pjesë në sesionin shkencor kushtuar Pjetër Bogdanit. Edhe Rexhep Qosja u ftua në Tiranë që të ishte i pranishëm në diskutimin rreth veprës së tij *Porosia e madhe* - kushtuar Naim Frashërit. Akademikut tonë të mirënjohur nuk iu lejua të shkilte këmba e tij në shtetin amë. Kështu ndodhi edhe me etnomuzikologun Rexhep Munishi, i cili duhej të merrte pjesë në sesionin shkencor rreth polifonisë së popujve ballkanikë. Në Tiranë shkuan dy studiues, njëri nga Beogradi, tjetri nga Zagrebi, dhe asnjë shkencëtar shqiptar. Nga kjo del se Konventa mbi bashkëpunimin kulturor midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë nuk vlen për punonjësit shkencorë dhe kulturorë të kombësisë shqiptare.

5. Edhe këtë vit në Zym të Hasit u mbajtën Takimet e Gjeçovit. Si e do rendi, manifestimin do ta hapte Ibrahim Rugova, kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve të Kosovës. Faktorët kompetentë nuk e lejuan të shkonte aty ku e kishte vendin. Shkrimtarët nuk mund ta gëlltisin këtë paturpësi, ndaj e bojkotuan këtë lloj »manifestimi«. Të dëgjueshëm u treguan vetëm Rifat Kukaj, Hajro Ulqinaku, Daut Demaku dhe Mehmet Kajtazi.

6. Kohë më parë gazeta »Borba« botoi stenogramin e bisedës midis udhëheqjes partiake të Serbisë dhe të Maqedonisë që u zhvillua në Shkup, në korrik të këtij viti. Jakov L Lazarovski i foli Sllobodan Millosheviqit gjerë e gjatë për »nacionalizmin dhe separatizmin« shqiptar në Maqedoni që na e paska burimin në Kosovë! A thua u arrit marrëveshja e dy palëve që ta çrrënjosin së bashku

këtë »epidemi të rrezikshme«; A thua L Lazarovski dhe udhëheqja maqedonase do ta justifikojnë në këtë mënyrë shkakun e mbylljes së shkollave shqipe në Maqedoni?

7. Këshilli Ekzekutiv Federativ ia dërgoi Kuvendit të Jugosllavisë raportin mbi revidimin e reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë, por jo edhe në Maqedoni. Kësaj pune nuk i thonë ndryshe veçse një kolonizim i ri i Kosovës, kundër të cilit PKJ dikur ngriti zërin e protestës. Edhe parulla e LNÇ ishte: shqiptarët do të jenë zot në tokën e tyre. Ndodhi që edhe pas çlirimit të vendit shqiptarët ta blejnë tokën e vet për të satën herë.

Në Plenumin 28 të KQ të LKJ, Enver Gjerçeku më në fund doli në foltore për të diskutuar edhe rreth propozimit të KEF-it për anulimin e Ligjit për kolonistët. Baza e tij delegeuse ka pritur nga ai që ta shtrojë shkoqur pyetjen: cili është qëllimi i propozimit në fjalë?

8. Në Mitrovicën e Titos filloi procesi gjyqësor (politik) kundër Azem Vllasit dhe 14 të akuzuarve tjerë. Për t'i dënuar ata nuk u gjet person më i përshtatshëm se Ismet Emra, i specializuar për t'u prerë dënimet qindrave shqiptarëve dhe për të hyrë në analet e historisë si ekspert për procese të montuara. Për ata që nuk e dinë po shtojmë se I. Emra ka qenë shok shkolle i Azis Abrashit kur kanë studiuar bashkë në Universitetin e Beogradit dhe kanë banuar në një dhomë në konviktin e studentëve, por nuk qe kjo kurrfarë pengese që nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë të Kosovës në Prishtinë, I. Emra të shkojë në gjykatën e Mitrovicës së Titos për ta denuar shokun e tij të ngushtë të dikurshëm.

DNEVNIK

1 Sodnik okrožnega sodišča v Prizrenu Sulejman Limani je na zahtevo okrožnega javnega tožilca Skenderja Morine zaslišal Fadila Hoxho. Hoxha je bil visok državni in partijski funkcionar, ki v vsem svojem življenju ni pozabil izgovoriti besed bratstvo in enotnost, ki je leta 1982 jurišal na albansko mladino, sramoteč jih z najbolj poniževalnimi izrazi, ki jih niti papir ne prenese, sedaj pa je obtožen za izzivanje nacionalne, rasne in verske nestrpnosti. Za to kaznivo dejanje je predvidena kazen od 1 do 10 let zavora. Bog ne daj, da bi Fadil Hoxha preživel svojo starost v zaporih Titove države, ki jo je tako ljubil in občudoval.

2. Pesnik Rahman Dedaj je bil odstranjen iz fotelja Rilindije in se je spustil na stol urednika uredništva Izdaj. Sedaj se je spomnil, da bi se približal starim prijateljem, da bi jim dokazal svojo poštenost. Znanemu pesniku se je pritožil, ker mu niso dali podpisati apela albanskih intelektualcev. Kot da pozablja, da ni dovolil objave tega apela v Rilindiji. Šušlja se, da sta bila v času, ko so sestavljali spiske za izolacijo, na njih tudi Rr. Dedaj in Beqir Hoti. To sta ista človeka, ki sta predlagala, da se zapre 15 novinarjev.

3. Otroški pesnik Rifat Kukaj je umaknil kandidaturo za predsednika OK ZK Priština, da bi tako odstopil prostor Ganiju Jashariju alias Jašareviću. Je to naredil po svoji volji ali je to od njega zahtevala volilna igra? Njegov sonarodnjak Halit Trnavci, znan kot »pošten Albanec«, je na volilni seji MK ZK Beograda »pretresel« govorniški oder z bičanjem »albanskega nacionalizma in separatizma«. Po lobanji doktorja znanosti, katerega znanstveno delo se omejuje samo na doktorsko disertacijo, ki jo je zagovarjal pred dvajsetimi leti,

je bilo gnezdo »iredentizma« tudi društvo Përþjekja v Beogradu, ki je bilo prepovedano s telefonskim ukazom.

4. Ibrahim Rugova in Engjël Sedaj sta v New Yorku sodelovala na znanstvenem srečanju, posvečenem Pjetëru Bogdaniju. Rexhepa Qosja so povabili v Tirano, da bi sodeloval v diskusiji o njegovem delu Porosia e madhe (Veliko sporočilo), posvečenem Naimu Frashëriju. Našemu znanemu akademiku niso dovolili, da bi njegova noga stopila v matično državo. Isto se je zgodilo tudi etnomuzikologu Rexhepu Munishuju, ki bi moral sodelovati v znanstveni diskusiji o polifoniji balkanskih narodov. V Tirano sta odpotovala dva raziskovalca — eden iz Beograda in eden iz Zagreba — in noben albanski. Iz tega sledi, da konvencija o kulturnem sodelovanju med Jugoslavijo in Albanijo ne velja za znanstvene in kulturne delavce albanske narodnosti.

5. Tudi letos so bila v Zymu Gjeqova srečanja. In kot zahtevajo pravila, bi moral srečanje odpreti Ibrahim Rugova, predsednik Društva pisateljev Kosova. Pristojni organi mu niso dovolili iti tja, kjer je njegovo mesto. Pisatelji take nesramnosti niso mogli požreti, zato so tako »manifestacijo« bojkotirali. Ubogljivi so bili samo Rifat Kukaj, Daut Demaku, Hajro Ulqinaku in Mehmet Kajtazi.

6. Pred kratkim je časopis Borba objavil stenogram razgovora med partijskima vodstvoma Srbije in Makedonije, ki je bil v Skopju julija letos. Jakov Lazaroski je na dolgo in široko razlagal Slobodanu Miloševiću o albanskem »nacionalizmu in separatizmu« v Makedoniji, ki ima korenine na Kosovu. Ali sta se sporazumela za skupno izkoreninjenje te »nevarne epidemije«? Ali bosta Lazaroski in makedonsko vodstvo na ta način opravičila zapiranje albanskih šol v Makedoniji?

7. Zvezni izvršni svet je poslal jugoslovanski skupščini poročilo o revidiranju agrarne reforme in kolonizacije na Kosovu, ne pa tudi v Makedoniji. Temu ne moremo reči drugače kot ponovna kolonizacija Kosova, proti čemur je nekoč KPJ povzdignila svoj glas. Tudi v NOB je obstajala parola: Albanci bodo gospodarji na svoji zemlji. A zgodilo se je, da so morali Albanci svojo zemljo kupiti nekajkrat.

Na 28. plenumu CK ZKJ je končno stopil na govorniški oder Enver Gjergjeku, da bi razpravljajal o predlogu ZIS-a o ukinitvi zakona o kolonistih. Njegova baza je pričakovala, da bo vprašal: kakšen je cilj tega predloga?

8. V Titovi Mitrovici se je začel sodni (politični) proces proti Azemu Vllasiju in 14 soobtoženim. Za sodnika ni bilo mogoče najti primernejše osebe od Ismeta Emre, specialista za izrekanje obsodb stotinam Albancev, s čimer je prišel v zgodovino kot ekspert za montirane procese. Za tiste, ki tega še ne vedo, naj dodamo še to, da je bil I. Emra sošolec Aziza Abrashija, da sta skupaj študirala na beograjski univerzi in spala v isti sobi v študentskem domu. Toda to ni bila nikakršna ovira, da bi Emra z mesta sodnika Vrhovnega sodišča Kosova v Prištini ne prišel na sodišče v Titovo Mitrovico obsoditi svojega nekdanjega dobrega prijatelja.

KOHA ËSHTË E MASKARENJVE
PO ATDHEU ËSHTË I SHQIPTARËVE

A. ASLLANI

NUK JEMI TE BARABARTE

Ngjarjet e përditshme po e errësojnë realitetin kosovar dhe, të gjitha të vërtetat për shqiptarët i ndrydhin i shndërrojnë në të padukshme dhe në të paqena. Kështu vepron, në radhë të parë, shtypi i Prishtinës dhe i Beogradit nëpërmjet të bisedave dhe deklaratave të ndryshme të udhëheqësve të Kosovës dhe të Serbisë, nëpërmjet konkluzave të tubimeve dhe të forumeve të tjera si mënyra të komunikimit në vend dhe jashtë tij. Këto deklarata dhe pikëpamje flasin për shqiptarët si për ndonjë *armik-monstrum*, i cili nga mjedisi kosovar vepron për shkatërrimin e vendit. Fuqi e tillë u përshkruhet shqiptarëve! Mirëpo, mendimi i shqiptarëve si popull, nuk është dëgjuar që nga koha kur u bënë diskutimet për ndërrimet e Kushtetutës së RS të Serbisë dhe të KSA të Kosovës. Pas atyre diskutimeve të gjitha dritat e demokracisë u shuan me masa të veçanta. Shqiptari më nuk flet, sepse e di çka mund t'i ndodhë dhe se çfarë kualifikimesh i mvishen. Për këtë arsye, çkado që vendoset për Kosovën dhe në Kosovë, çkado që planifikohet e projektohet, çfarëdo ligji që të miratohet, më nuk mund të pranohet se është shprehje e vullnetit të shqiptarëve. Për konstatime të tilla kemi shumë arsye, por kryesore janë presionet zyrtare, gjysmë zyrtare, shtetërore-police, me të cilat shqiptarëve u ndalohet gati çdo gjë:

1. Shqiptarët jetojnë nëntë vjet nën tehun e masave të veçanta që zbatohen në Kosovë dhe vetëm ndaj tyre. Presionin e RS të Serbisë (ashtu siç ndodhi në Plenumin e nëntë të LKJ) e pranuan edhe organet partiake e juridike të Federatës.

2. Shqiptarët jetojnë nën presionin e mitingjeve, tubimeve, kuvendimeve, peticioneve, shkuarjes në Beograd të sërbeve e të malaziasve që atje me fjalime të zjarra, duke qarë e vajtuar me gërvishje, me gra e murgesha të armatosura, t'i dëshmojnë para kamerave (kinse) vuajtjet e mundimet e shkaktuara nga shqiptarët. Tekefundit, ky është materiali filmik që shfaqet para popujve të vendit tonë në mënyrë që të dokumentohen poshtërsitë e shqiptarëve! Ky material dokumentues, madje duhet t'i arsyetohet masat e ashpra që zbatohen ndaj shqiptarëve, me ç'rast nuk kursehen as filloristët, kjo do të thotë të arsyetohen masat ndëshkuese, politike dhe police ndaj tyre.

3. Shqiptarët me vjet paraqiten në jetën publike në vend dhe jashtë, vetëm sipas fjalëve dhe deklaratave të udhëheqësve të të gjitha niveleve, pra edhe të Kosovës, të cilëve udhëheqja e Serbisë ua ka caktuar rolin e megafonit, që t'i bien daullës dhe të trumbetojnë në emër të popullit. Vërtet, metodat me të cilat bëhen presionet mbi shqiptarët shprehen në forma drastike (të marrim shembull: në Komunën e Lipjanit është dënuar njeriu, sipas Rilindjes, që ecën me kukëza, pra i çalë, për shkak të pjesëmarrjes në demonstratat shkatërruese! Ja, u gjet e vërteta: i çali e rrënon shtetin!

Në kuadër të veprimit të stabilizimit të gjendjes në Kosovë çdo masë ndëshkuese arsyetohet me sintagmen »ka rënë në konflikt me LKJ«. Njëmend, a ka kund ligj që gjykon në emër të dikuj tjetër? Për këtë arsye do të dëshiroja të di se çka mendojnë organet partiake dhe juridike të Federatës për A p e l i n 215 të intelektualëve shqiptarë në të cilin nuk ka asnjë fije armiqësie ndaj këtij shteti dhe popujve të tij, mirëpo shumica e nënshkruesve janë dënuar me masa, së paku, partiake. Vallë, a është e lejueshme që çdo gjë të bëhet në emër të organeve që e përfaqësojnë Jugosllavinë? Për përmbajtjen armiqësore të A p e l

i t 215 konstatoi (haptas) vetëm Kryesia e Komitetit të LK të Prishtinës, megjithëse Apeli 215 ishte dërguar në adresa krejt tjera. Mirëpo, në vend se të përgjigjen organet, të cilave u është dërguar, arriti masa djallëzore, e cila propozon dënime të ashpra kundër mendimit të shprehur publikisht në mënyrë demokratike të lejuar me kushtetutë. Me këtë veprim me të cilin drejtësia zëvendësohet me masa ndëshkimore, nisi t'i zihet fryma demokracisë. Me demokraci të tillë dhe me diskutime të argumentuara nuk qenë në gjendje të ballafoqohen organet juridike të Kosovës dhe të Serbisë, sepse nuk patën kundërargumente, prandaj e gjetën ekzekutuesin që i zbaton dënimet partiake.

Shqiptarët nuk janë të informuar për vlerësimin e diskutimeve kushtetutare qoftë në përgjithësi, qoftë veç e veç për çdo popull. Janë bërë (nga ana e shqiptarëve) diskutime të gjithanshme dhe të argumentuara, janë bërë (nga ana e serbëve dhe e malaziasve) diskutime me të cilat është kërcnuar ekzistenca e Kosovës si krahinë autonome, mirëpo kualifikimet negative u dëgjuan nga disa delegatë dhe forume të RS të Serbisë. Atëherë u bën të ditura relacionet: nuk ishte më fjala për b a r a z i , por për të nënshtruar dhe për epror, sepse u tha nga udhëheqja e Serbisë se kurrëgjë nuk mirret parasysht kur është fjala për ta bërë Serbinë unike, as kushtetutë, as demokraci, as e drejtë juridike as e drejtë natyrore, as e drejtë historike. Kështu u paraqit forca si mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ashtu u bë derisa u aprovua Kushtetuta e RS të Serbisë, ashtu veprohet me rastin e aprovimeve të ligjeve të ndryshme, të marrëveshjeve etj. Për këtë arsye mendoj se organet federative, politike dhe shtetërore, jo vetëm para shqiptarëve, por edhe para botës, nuk do të duhej të lejonin turpin publik që bëhet në emër të tyre.

Shqiptarët, sikur të kishin mundësi, e këtë nuk e kanë, që lirisht t'i shprehnin mendimet e veta, nuk do të lejonin që t'i përfaqësojë udhëheqja, e cila është vetëm zë i magafonit të RS të Serbisë. Shqiptarët e dijnë se cilat të drejta u takojnë, sepse ata nuk janë as të padijshëm, as të manipuluar, nuk janë më as pakicë, sikurse po i paraqesin funksionarët e RS të Serbisë dhe disa sish të Federatës, madje për fat të keq, këtë e bëjnë edhe në botën e jashtme me shtetarë të huaj, nëpërmjet të shtypit të huaj e të tjera; Shqiptarët, pra, nuk janë pakicë as në krashasim me popullsinë në vendin amë. Mu për këtë, nuk e kanë autorizuar askë, madje as delegatët e b y k u t , të cilët nuk janë në gjendje t'i mbajnë drejt gishtat përderisa nuk u kërcnohet forca.!

Nuk dua të profetizoj, por një padrejtësi e tillë mund të na ndodhë edhe me rastin e Kushtetutës së RSFJ. Para pak kohe lexova dy herë në Rilindje (një deklaratë edhe nga një udhëheqës i Vojvodinës) se Këshilli për përgatitjen e Kongresit të XIV të LKJ, informon se, ndër të tjera, duhet të konstatohet dhe të përcaktohet se qysh do të përfaqësohen krahinat në Federatë për shkak se ato nuk kanë veçori të republikës, do të thotë s'kanë shtetësi. Sipas kësaj linje partiake kjo do të thotë, atyre që nuk kanë këto veçori (republikane) nuk u takojnë të drejtat, prandaj ata që jetojnë në krahina do të thotë nuk mund të jenë të barabartë me të tjerët, madje as në atë shkallë siç kanë qenë deri më tash.

Si tkurren të drejtat e shqiptarëve, si shuhet juridikisht veçoria e autonomitetit të KSA të Kosovës?

Puna shtyhet kah caku fshehtazi nën rrogos, në mënyrë të kamufluar dhe të pavërtetë (ndërkaq në shtyp e publikisht i bihet daullës se shqiptarët s'kanë humbur kurrëgjë me ndryshimet kushtetutare). Tekefundit le të bëhet shtu siç mund të bëjnë (m o m e n t a l i s h t) të fortit, por duhet të dihet dhe të shihet

përgjithmonë se në Nëntor të vitit 1988 populli i Kosovës, më saktësisht mbarë popullsia shqiptare, nga Kaçaniku deri në Mitrovicën e Titos dhe nga Gjakova deri në Podujevë, nuk e dha pëlqimin për ndërrimet, zëvendësimet dhe shtimin e një numri amandamentesh në kushtetutën e RS të Serbisë. Ajo s' u pajtua për ato amandamente që ia cenonin të drejtat Kosovës Atëherë populli nuk e sulmoi Jugosllavinë duke bartur flamurin e vet kombëtar dhe atë të Jugosllavisë, por nuk e sulmoi Jugosllavinë as duke bartur fotografinë e Josip Brozit, por i mbrojti të drejtat e veta dhe kërkoi që Jugosllavia t' i mbrojë shqiptarët, identitetin dhe sovranitetin e tyre. Edhe po të bartë nëpër rrugë të gjitha simbolet e Serbisë, popullata shqiptare do të shpallej armik, sepse vetëm si të tillë mund ta shtypnin e ta përbuznin edhe një herë si shumë herëve, rëndë e më rëndë!

Shqiptarëve nuk u jepet mundësia që të mbrohen. Në çdo miting, tubim, kuvendim, peticion (gati gjithmonë edhe në forume të kësaj republike) serbët dhe malaziasit shprehin pangopësinë e tyre: kërkojnë dënime, largime, suspendime, shkarkime të shqiptarëve, herë të atyre që heshtin, herë të atyre që flasin, herë të shkrimtarëve dhe të shkencëtarëve, herë të arsimtarëve dhe të drejtorëve, herë të politikanëve e të pensionistëve. Ata kërkojnë ndërrimin e emrave të rrugëve, të institucioneve të shkencës e të kulturës, të cilat bartin emrat e luftëtarëve shqiptarë (edhe të atyre të LNÇ), të figurave dhe të datave historike, të kulturës shqiptare dhe të trashëgimisë përgjithësisht, me qëllim që çdo gjë shqiptare të jetë sa më pak e dukshme, sa më pak e lexueshme, sa më pak e pranishme. Ata kërkojnë që vetë t' i marrin vendet udhëheqëse, kërkojnë të mbyllen institucionet që studiojnë kulturën dhe trashëgiminë e shqiptarëve. Kërkojnë që shqiptarët të punësohen jashtë Kosovës (e kjo është futur edhe në masat e organeve të Federatës për stabilizimin e gjendjes në Kosovë (!) më së shumti në Slloveni dhe jashtë vendit, sa më larg vatrave të tyre. Ata kërkojnë, me çdo kusht, vetëm për vete që të punësohen në Kosovë (e ndërtohen fabrika për këtë qëllim). Kërkesa të tilla, edhe më të rënda, do të ketë edhe më shumë, madje do të ketë edhe përkrahje të pamasë edhe nga organet e pushtetit. Kjo u vërtetua sivjet para Kuvendit të Jugosllavisë, madje tashmë nuk ka rëndësi se çfarë janë kërkesat: a kërkohet burgosja apo pushkati (shumë qytete e fshatra e paguan me viktime)! Për disa udhëheqës të RS të Serbisë, gjithçka është e pranueshme, çdo gjë është e realizueshme dhe shumë e arsyeshme, vetëm në qoftë se atë e kërkojnë serbët dhe malaziasit në Kosovë, madje edhe gjetiu.

Pas aprovimit të Kushtetutës së RS të Serbisë dhe KSA të Kosovës, siç shkruan Rilindja, sepse masat shqiptare as nuk i diskutojnë fare, ashtu sikur nuk i ka pyetur kush kur ua ka ndërruar flamurin, janë aprovuar një varg ligjesh që vlejné për tërë territorin e RS të Serbisë pa kurrfarë vëretjesh nga organet krahinore. Për këto askujt s' i jepet rasti ta thotë një fjalë, sepse qëllimi realizohet nëpërmjet të delegatëve-figura, të cilët veprimtarinë e tyre e kryejné në bazë të potezave të parashikuar më parë, me ndihmën e misionarëve- suflerë. Dihet fati i delegatëve që i kanë shtruar kërkesat e popullit. Kështu, të pakten deri tash, punoi Kuvendi i Jokanoviqit (jo i Kosovës) dhe Komiteti i Morinës. Nuk ka asnjë dokument, së pakut publikuar deri më tash, që kur ata kanë adhur në vendet kryesore, i cili do të dëshmonte se ata punuan diçka për realizimin e të drejtave të shqiptarëve. Ata, reagojnë në qoftë se fëmija i shqiptarit gjuan ndonjë zog mbi pullazin e serbit apo të malaziasit, por nuk e thanë as një fjalë, as nuk bënë një grimë përpjekje, kur 11,000 nxënës shqiptarë mbeten rrugëve. Të tillë, vërtetë, janë këta!

Punët bëhen sipas skenarëve të përgatitur me parë, sipas kërkesave të koncep-

tuara dhe të organizuara mirë, sepse gati në të gjitha bashkësitë lokale ku jetojnë serbët e malaziasit, në tubimet e tyre, në mbledhjet e tyre, në kuvendimet e tyre, në mitingjet e tyre, në petitionet e tyre që kanë vulë proteste e shprehin pakënaqësi (!) marrin pjesë diskutojnë po me stilin e të tubuarëve, anëtarët e KQ të LK të Serbisë për t'u dhënë përkrahje »disa kërkesave të arsyeshme«, ndërkaq për të mos i gjykuar kërkesat e paarsyeshme, madje as ato antinjerëzore e antijugosllave. Kështu janë legalizuar shumë veprime të euforisë nacionaliste, para të cilave Jugosllavia bëhet e verbër dhe e shurdhër (si të thuhet ndryshe kur fyhen anëtarëte KQ të LKJ ose të organeve të tjera shtetërore) e tërë Jugosllavia hesht? Sjellja e këtillë kontribuoi që disa shkrimtarë serb... e malazias të mbajnë fjalime në oborret e kishave e të manastireve dhe të mos marrin pjesë në forume legale të përbashëta për zgjedhjen e problemeve të përbashkëta. Ata sillen në mënyrë skandaloze, së bashku me serbët e malaziasit e tjerë, i formojnë dhe i lëshojnë forumet, natyrisht ato legale ashtu si të ju konvenojë. Kjo dëshmon se afrimi në mes të popujve, në këto skenare nuk është paraparë, ndërsa fronti i përbashkët mund të gjallërojë edhe ndonjë ditë vetëm si parullë e oratorëve të ndryshëm në forume. Me një anë janë serbët e malaziasit e privilegjuar, të përkdhelur nga pushteti, popull pa gabime, qytetarë të rendit të parë, kurse në anë tjetër janë shqiptarët e perbuzur, popull plotë mëkate, qytetarë të rendit të dytë, të pambrojtur me ligj. Dhe, kështu kurrë, vërtet kurrë, nuk mund të formohet front i përbashkët. Fronti i tillë, dogmë manovruese, përdoret në sytë e botës, sepse ai nuk u konvenon atyre që gjenden në pozitë të paprekshme. Serbët e malaziasit të mësuar në tubimet e lira e të pabrenga njënacionale, përpiqen që t'i lënë përgjithmonë tubimet e përbashkëta me shqiptarët në insitucionet e rregullta legale. Këtë rrugë e morën qysh moti shkrimtarët e Bulles; kësaj rruge shkuan arsimtarë serbë e malazias kur së bashku me nxënësit i bojkotuan mësimet, kështu vepruan serbët e malaziasit (intelektualët, u tha, kinse) te Renovica, e tani edhe mjekët në Mitrovicën e Titos, të cilët, mund të pritet, t'i afrojnë ndihmë »të gjorit« Gjorgje Martinoviq, për rastin e turpshëm të të cilit përtrihen përrallimet prej pranvere në vjeshtë, prej dimri në verë. Qe, pra, i tillë është fronti i përbashkët. E tillë është edhe pajtueshmëria e arritur në Kosovë pas aprovimit të Kushtetutës së RS të Serbisë dhe të KSA të Kosovës.

Frymëzuesit e tubimeve të serbëve e të malaziasve janë aktivistët nga RS e Serbisë. Ata gjatë aktivitetit nëpër Kosovë u priten ngrohtë, aktivistët e Federatës u priten me urrejtje (Shetinci, Dragosavci, Orllandiçi); prandaj kumarët i dirigjojnë tutje aksionet për destabilizimin e gjendjes (ku do që mbahen tubime proteste është e pamundur të mos gjenden edhe nga dy aktivistë nga RSS). Në Kosovë u ndërruan udhëheqësit që nuk arritën ta stabilizojnë gjendjen, ndërsa në Serbi udhëheqësit e njëjtë u bënë edhe më të popullarizuar. Mendoj se edhe kjo dëshmon mjaft se çfarë harmonizimi u kërkua të bëhet në çdo nivel në Krahinë e në Republikë.

Tani, me rastin e zgjedhjeve u njollosën shumë shqiptarë, të cilët u përpoqën të qëndrojnë të pavarur dhe dinjitoz, kështu u ngushtua rrethi i atyre që duhet të zgjidheshin. U propuzuan (në forume) ata shqiptarë të cilët populli edhe më parë nuk i deshi.

Kosova ka njerëz të mençur dhe të aftë, por nuk dëshirohet të zgjedhen ata. Ku mund të zgjedhet njeri më i mirë se (dr) Gani Jashari që ta shajë, dënojë, inteligjencinë duke e përrulur me epitetet si pseudointeligjencë. Njeriu duhet të jetë »i fortë« që t'i quaj autorët me më se njëzet vepra, pseudointelektualë. Rrallë kush ka fytyrë e karakter të tillë që të përbaltë vlerat e kulturës së po-

pullit shqiptar. Ndërsa ai ka, prandaj është propozuar, është zgjedhur të mandatojë edhe më tutje.

Shtypi në Kosovë është nën çdo nivel. Ai është, thjesht, në shërbim të politikës së ditës. Shqiptarët s'kanë ku t'i shfaqin mendimet, qëndrimet dhe pakënaqësitë e tyre. Rilindja, TVP dhe Radio Prishtina përsërisin meshën e tyre të përditshme të mëngjezit: për luftën kundër nacionalizmit dhe separativizmit (shqiptar, natyrisht), për shpërnguljen e serbëve dhe malaziasve, duke mos përmendur një mijë shkaqe të tjera, pos presionit nga shqiptarët (mendoni logjikisht kush do të mund të bënte presion përballë forcave të armatosura numerikisht mjaft të mëdha, të cilat janë koncentruar që nëntë vjet këtu me detyrë të veçantë, me kompetenca të pacënueshme (!), për kthimin e të shpërngulurve, duke u siguruar banesa e punësim pa konkurs, kuptohet: në dëm të varfanjakëve shqiptarë, turq, romë, myslimanë e të tjerëve.

Këtë e kemi meny të përditshme të lajmeve. Këtë e kemi meny të veprimtarisë së organeve. Por, padyshim, më i rëndësishëm mbetet diferencimi. Për të kënohen udhëheqësit, sepse përsërisin pa ndërprerë numrat astronomikë të të denuarve. Këtë e kanë të vetmin kapital, i cili u jep të drejtë t'i mbajnë fronet. Përndryshe, ata nuk e kanë zgjedhur problemin e punësimit, sepse numri i të papunëve është shtuar; nuk i kanë zvogëluar humbjet, por i kanë rritur; nuk kanë pasur suks ta përparojnë zhvillimin e Kosovës, vetëm sa i kanë kontribuar stagnimit (likuiduan Ndërmarrje e kombine si atë të ndërtimtarëve të »Ramiz Sadikut«); ndërsa për standardin e njerëzve në Kosovë, gjatë mandatimit të tyre, mos të flasim. Por, për çudi, prej Krahinë e në Republikë, dëgjohen fjalët: i kemi zgjedhur udhëheqësit e vyeshëm e të aftë. Një gjë dihet: ata do të flasin në emër të popullit dhe do të agazhohen në organet e Krahinës, të Republikës dhe të Federatës, natyrisht sipas kërkesave të atyre që i kanë zgjedhur.

Udhëheqësit i frikohen demokracisë, prandaj mu për këtë i mbajnë nën kontroll të rreptë ato institucione që mund ta shfaqin mendimin e lirë e më të artikulluar. Për këtë arsye është më mirë të përparohet me dhunë Skënder Karahoda (dr) në funksion të rektorit të Universitetit megjithëse dy herë rradhazi nuk fitoi përkrahjen për vende udhëheqëse, më mirë është të shtyhet me dhunë Hysamedin Azemi në Odën Ekonomike të Kosovës, edhe pse dy herë me vota të lira nuk pat fituar për vende udhëheqëse. Kështu u veprua me njerëz që të sillen në ato pozita ku sot i konvenojnë kryeparisë, atyre u jepet mundësi të ecin përpara për ta kryer deri në fund rrogatllëkun e vet.

Kur është puna për Kosovën dhe popullatën e saj, është një çudi që i kalon mundësitë e logjikës, sepse, sipas nevojës ndërrohet qëndrimi politik, ndërrohet qëndrimi policor, madje ndërrojnë edhe vetë ligjet: atëherë kur serbët e malaziasit mbajnë tubime, shkruajnë peticione, u jepet e drejtë, pakënaqësia është e arsyeshme e ata, lavdohen, por atëherë kur shqiptarët tubohen, shkruajnë peticione, madje edhe apele, këtë e kualifikon ligji vepër armiqësore, hiç më të vogël se kundërrevolucion. Dhe, për këtë shqiptarët burgosen dhe dënohen me afate të shpejta por edhe të gjata burgimi. Në këtë mënyrë, kur është fjala për shqiptarët, zhvleftësohen edhe kuptimet e nocioneve leksikore-enciklopedike të pranuar me norma ndërkombëtare. Në kohë të fundit për kërkesa paqësore, të qeta, shqiptarët filluan të quhen terroristë. Pra, terrorist, sipas vlerësimit zyrtar të udhëheqjes së Serbisë quhen të vrarët (viktimat), e jo vrasësit!

Singerisht duam të dimë ku dhe te kush vijnë një milion dollarë në ditë që i jepen Kosovës, populli i së cilës jeton në mjerim. A është e vërtetë se këto

mjete derdhen në fondin për zhvillimin e Kosovës, kush i keqpërdorë këto? Pyesim: çka i jep Kosova dhe populli shqiptar Jugosllavisë? Nuk besoj se ne jetojmë si qorra në shpinën e të tjerëve! Tani po zhvillohet Kosova në mënyrë tjetër, po krijohen dallime midis viseve të saj, sepse viseve ku jetojnë serbët e malaziasit po u jepet aq sa kërkojnë e sa dëshirojnë.

Sa i përket çështjes së kuadrove, dihet se është rrudhur rrethi i shqiptarëve: ata janë të dënuar, të suspenduar, të shkarkuar, të mbikqyrur nga organet e ndjekjes, të rënë në konflikt me LKJ, si të këtillë, të gjithë këta janë të papërshtatshëm. Ka ngelë vetëm një burim kuadrosh: të zgjidhen udhëheqësit nga radhët e policisë dhe të bashkëpunëtorëve të saj të jashtëm. Ata, është e ditur, do t'i zbatojnë me sukses masat e veçanta të ndërmarra vetëm për gjendjen në Kosovë.

E dimë, ne shqiptarëve kurkush nuk na pyet për fatin tonë, për projektimin e tij në aktet juridike, për zhvillimin e demokracisë, për realizimin e sovranitetit. Organet e Federatës janë të obligueshme që ta trajtojnë seriozisht çështjen e shqiptarëve, jo vetëm në Kosovë, sepse në viset e tjera të vendit për disa çështje puna është edhe më keq, sepse po shihet se më tepër vlen një permendore serbe në Algjir apo Tunis se takimet dhe bashkëpunimi i shqiptarëve me shtetin amë. Sipas logjikës së tashme udhëheqëse, është më mirë të punësohet pa konkurs një serb a malazias i kthyer i cili mban gruan dhe ndojë anëtar, sesa shqiptari që mban familje dhjetëantareshe. Është më mirë të hapet klasa për një nxënës serb apo malazias, sesa të regjistrohen në shkollë të mesme 11.000 shqiptarë. Kjo nuk paraqet gjë tjetër pos pozitën nënshtruese të shqiptarëve. Organet e RS të Serbisë, në bashkëpunim me kishën, po bëjnë përpjekje t'i bashkojnë, afrojnë e joshin serbët që jetojnë në botë, ndërkaq, shqiptarëve u ndalohet çdo kontakt me vendin amë. Po trumbetohet në të gjithë Jugosllavinë dhe jashtë saj, në emër të shqiptarëve, se jetojmë në republikën e të barabartëve (thuhet edhe për RS të Maqedonisë e RS të Malit të Zi) e pozita e vërtetë e shqiptarëve e komprometon përpjekjen e tillë të shtetarëve dhe të diplomacisë jugosllave.

EDVARD KOCBEK

KUMBONA E ALARMIT

Qetësia zuri të oshëtijë
më ndryshe se deri tash.
Dikur vinte nga jashta,
atëhere e dëgjoja me ëndje,
tash nisi të shfaqet në mua,
të shkapërderdhet tmerrësisht rrotull
nëpër ju a të munduarin,
kështu nis çmenduria.

*Kumbona e alarmit bie pandërprerë
dhe nuk di të pushojë në botën time.
Kështu fillon terri i përjetshëm,
se njëherë si tepër kam luajtur me kumbonat...
Tash më shpie oqeanit të pafund,
nuk ajgëtoj dot askund bregun as qetësinë.
Është i kotë edhe notimi në shpinë.
Dikush është sundimtar i mirë mbi lirinë.*

Përktheu: Shaip Beqiri

HAKI STĚRMILI

KO BI BILA DEČEK

(NADALJEVANJE IZ PREJŠNJE ŠTEVILKE)

dhe ti që s'e beson vdekjen e tija...*

*Po mua më kish marrë malli për nënën,
më kishte marrë për gjyshen e gjorë,
kërkova leje dhe u nisa këmbë:
që nga Tirana - këmbë gjer në Vlorë...
Kur dielli perëndonte tej mbi ujëra,
s'e di se si u gjenda në baxhá,-
atje më prisnin tufat me pëllumba:
më paskësh marrë malli për ata...*

*Sqep më sqep loznin nëpër erë,
duar e grushte mbushur me gugitje:
një vezë e vetme e mbetur në folezë,
përbrënda saj zokthi që çukiste.
Përkulur mbi të me thonj e gishtërinj,
çiflosja, thyeja lëvozhgën e fortë.
Automatikun hedhur kraheqafë,
prej veze nxirrja pëllumbin e bardhë.*

*Dëgjova gjyshen që thirri përposhi:
- Uh, korba unë, paska ardhur Fatosi...*

Portretet fëmijve që po ju paraqes në këtë skicë janë vendosur në kornizat e një kohe të ashpër. Por ky konstatim nuk mjafton. E dimë shumë mirë se jeta është luftë e kontradiktave. Polarizimi luftë (paqë, dashuri) urrejtje i përshkon shekujt. Çdo fatkeqësi, si për mrekuli, mbanë në vetvete farën e diçkahit tjetër. Ku urrejtja është më e madhe çelin lule shpresash. Shtypja më e urryer më në fund lind një shpërthim çlirimtar. Çdo sistem skllavërues do të shkatërrohet herët a vonë. Historia e popullit shqiptar na mëson se sakrificat mbinjerzore nuk janë pa kuptim. Përkundrazi. Pa flijime Shqipëria nuk do të ekzistonte si shtet i pavarur siç është sot. Diçka shumë e vështirë në botën e superfuqive të sotme. Do të mbaroj me poemën »Thirrje« të Ali Podrimjës. Kjo poemë u botua për herë të parë në vitin 1961.

Poema i kushtohet Lilit, »vëllaut tim, që humbi në tufanin e luftës. »Menjëherë më bëri përshtypje jashtzakonisht të madhe si poezi me vlerë të posaçme dhe është fakt i habitshëm se Ali Podrimja e shkroi këtë poemë shumë herët, në atë kohë kur ishte nxënës i gjimnazit të Gjakovës. Kjo poezi është përkthyer në shumë gjuhë të tjera dhe, sipas mendimit tim, dallohet si një nga veprat më të mira të letërsisë botërore mbi temën e humbjes dhe mallit.

Në fillim poeti e përdor figurën e pëllumbit në një mënyrë krejt konkrete - ky pëllumb na duket aq i vërtetë sa pëllumbi i lartpërmendur i Fatos Arapit. Si figurë ka më shumë se një synim: lidhet me botën e fëmijve, fluturon si imagjinata e poetit të ri, vepron si lajmëtar - qenka i njohur si i tillë që nga koha e Dhjatës së vjetër - dhe sipas Fjalorit të shqipes së sotme (Tiranë 1984) është simbol i butësisë, i pastërtisë, i bukurisë dhe paqes. Lili i zhdukur zë vend në mendjen e vëllaut të tij, merr trajtën e dukurive të natyrës. Aliu e kërkon në krahët e zërat e shpendëve, në rrezet e diellit, në barin e livadhit. E tillë është dashuria dhe malli i njeriut tek ata që janë të lindur për mallë e dashuri

dhe poeti na zgjon këtë ndjenjë me çiltërsinë e këngëve popullore, qoftë shqiptare, qoftë nordike...

Vëllau i humbur, Lili, megjithëse na paraqitet i lidhur me ambientin e caktuar, me rrugët e Gjakovës dhe Erenikun nën Urën e Tabakut, me mjeshtrinë e poetit të ri ngrihet në përgjithësim dhe bëhet më shumë se një fat njeriu: Ali Podrimja i këndon fatit të një populli, i cili është bërë viktimë e qëllimeve të shumta grabitqare gjatë shekujve. Unë edhe në vendin tim nordik mund të takohem kudo me Lilin e humbur nëpër rrugët e mërgimit. Dhe poeti pyet:

»A të kujtohet Ereniku
rrëzë Çabratit,
guralecat, vapa?

Dhimbja e mërgimit është e lidhur jo vetëm me njerëzit e dashur por edhe me lumenjtë, malet, tokën dhe ajrin e vendlindjes.

Letërsia artistike ka një veti të çmueshme: na jep të kuptojmë dhe të ndiejmë thellë rrethanat njerzore në një ambient të caktuar etnik, shoqëror dhe kohor. Dhe kjo është me vlerë jo vetëm letrare, por na ndihmon ta pastrojmë ndërgjegjen tonë shoqërore, sa të rritet respekti dhe kujdesi për popujt tjerë, qofshin ata larg nesh apo afër. Luli i vocërr, Fatosi (Fatos Arapi si djalë) dhe Lili janë pjesë të dashurisë sime për popullin shqiptar.

Literatura:

Migjeni: Luli i vocërr. Botuar më parë në Rreze drite, Tiranë 1941.

Citatet janë në përpunje me ortografinë e përdorur në

Migjeni »Vepra«, Tiranë, 1988.

Fatos Arapi: Ritme të hekurta, Tiranë 1968.

Drejt qindra shekujsh shkojmë, Tiranë 1977.

Duke dalë prej ëndrrës, Tiranë 1989

Ali Podrimja: Thirrje, Prishtinë 1961. Biblioteka »Jeta e Re«.

Ortografia sipas botimit Ali Podrimja: Poema. Prishtinë 1979.

QERIM UJKANI MESJETARËT

Në antikë plang as shtëpi
As kujt t'i trokasin në derë
As të japin as të marrin
Cirilika s'u merret vesh

Përpara s'u bëjnë këmbët
Si të shqiten nga mitet
Anatemat fantazmagoritë
Sytë ua merr drita atomike

E kthejnë në mesjetë
E bëjnë pikën e qejfit
Nën kambanat bizantine
Pinë verën e tempullit

»TË DIFERENCUAR« SHQIPTARËT E KOSOVËS

Një gjendje eksplozive sundon në Kosovë, Krahinë e Republikës së Serbisë (Jugosllavi), ku shumicën e popullsisë e përbëjnë shqiptarët. E mbërthyer nga ringjallja e nacionalizmave dhe e kërcënuar të shpërbëhet, Federata Jugosllave nuk paska mjet tjetër për të shpëtuar, veçse duke ndërmarrë sulme ndaj të drejtave të njeriut? Qysh nga shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga autoritetet e Beogradit në shkurtin e kaluar, udhëheqësit lokalë po e forcojnë më tej represionin, i cili quhet »diferencim«.

*Nga Antuan Garapon**

Një atmosferë frike sundon në Kosovë. Mjaft veta kanë refuzuar të takohen me Delegacionin e Federatës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut i ardhur për të bërë hetime në vend¹. Autoritetet e Krahinës e, pikërisht Vejsel Latifi, Sekretari i Jurisprudencës e ka hedhur poshtë kërkesën për të vizituar burgun ku janë të mbyllur Z. Azem Vllasi, ish. Sekretari i Lidhjes së Komunistëve me të tjerë të burgosur politikë, midis të cilëve një vajzë Hatmona, e dënuar me dy vjet e gjysmë burg, sepse ishte »përzier« në një demonstratë me një shoqe. Megjithatë kemi mundur të mbledhim dëshmi të drejtpërdrejta, sidomos në sajë të ndihmës së një prifti katolik: pjesa dërmuese e popullsisë është myslimane por, shpeshherë ateiste dhe bashkëbiseduesit që kemi takuar ishin të mendimit njëzëri se gjendja e nderë nuk ka asnjë karakter fetar.

Në afërsitë e Prishtinës, kryeqendra e Kosovës nja 50 kilometra duke kaluar një rrugë të paasfaltuar, na pritën në një fermë mjaft modeste: »Isha gjykatës në Klinë, na shpjegon Ali Foniqi,

35 vjeç, kur më 6 dhjetor 1985 në mëngjes duke shkuar në punë, policë të veshur në civilë më arrestuan dhe më çuan deri te stacioni i policisë, ku më rrahën në mënyrën brutale. Në orën 11 më ra të fikët dhe një mjek erdhi të më shihte, midis orëve 13 e 20 goditjet u ndërpre. Qysh nga ora 20 deri në orën 5 të mëngjesit dy agjentë kanë vazhduar të më rrahin, duke më kërcënuar se do të më burgosnin gruan dhe vëllezërit e mi; gjatë tërë kësaj kohe, duhej të rrija më këmbë, me duart përballë murit. Tekebramja duhej të »pohoja« se kisha qenë në Shqipëri - çka ishte e pamundur gjatë këtij dimri për shkak të borës dhe kohës së keqe - dhe se isha takuar me njerëz politikë: - duke mos njohur emra - u kam dhënë vetëm emra të këngëtarëve.

»Torturat ishin shumë të rënda: kam urinuar gjak gjatë dhjetë ditësh dhe kam pasur një pleurezi për shkak se më kanë hedhur ujët të ftohtë mbi fytyrë dhe trup që të më bënin të vija në vete. Një mjek erdhi për të më bërë injeksione. Torturat zgjatën dy muaj e gjysmë. Çdo ditë prej orës 6 deri në orën 14 më merrnin në pyetje. Mandej, policët më kanë çuar te një psikolog, i cili më bënte

* Gjykatës, anëtar i zyrës së Federatës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

¹ Misioni i FNDN (FIDH) ka qendruar në Kosovë prej 24 deri në 29 shtator. Ai ishte i përbërë nga Luiza Kristian, avokate në Londër, nga Salih Kabashi, profesor, anëtar i Komitetit slloven për të drejtat e njeriut dhe nga Antuan Garapon.

pyetje pa lidhje, për shembull: çka është më e rëndë: 1 kg pupla apo 1 kg plumb, ose cilat janë vendet kufitare me Jugosllavinë?

»Më dënuan me 7 vjet e gjysmë burg në shkallën e parë dhe dënimi u zvogëluar më 3 vjet pas gjyqit të apelit. Prej 2 vjetësh kam dalë dhe kam qenë i detyruar të shkoj në fshat; kam humbur vendin e punës, gruaja ime që ishte mësuese, edhe ajo e ka humbur punën; pasaportën ma kanë marrë. Jam intelektual, s'di të punoj tokën dhe, qysh se më kanë torturuar nuk më ka mbetur shumë forcë, ndonjëherë kam marramendje dhe »humb lidhjen« me realitetin.

»Sipas mendimit tim, gjithë kjo ndodhi sepse im vëlla vërtet ka qenë në Shqipëri. Ai mendonte se atje do t'i kryente më shpejt studimet e tij. Pastaj e arrestuan dhe e dënuan me 5 vjet e gjysmë burg, tashu gjendet në Kroaci«.

Rrëfimi i Z. Mustafë Krasniqit është përafërsisht i njëjtë: e arrestuan me të atin ditën e martesës gjatë dasmës. Të dy u akuzuan se kishin një libër të botuar në Shqipëri që përfshinte pjesë nga shtypi ndërkombëtar në lidhje me ngjarjet e vitit 1981 të Kosovës. Të dy u torturuan, sidomos i ati gjashtëdhjetë e tetë vjeçar, ish-partizan, i cili gjithmonë kishte qenë anëtar i partisë komuniste. Ankohen para së gjithash për gjilpërat që u kanë ngulur nën thonj. Djali u dënua me dy vjet burgim, ndërsa i ati me dy vjet e gjysmë. Ky i fundit u sëmur nga tuberkulozi dhe vdiq në kohën kur u lirua. S'e kishin njoftuar për vdekjen e gruas gjatë burgimit.

Tani, Z. Mustafa Krasniqi i cili ishte në vitin e tretë të sociologjisë, punon tokën: gjithashtu ia kanë tërhequr pasaportën atij si edhe të gjithë kushërinjve, është ngulur në fshatin e tij ku s'mund të dalë. Është »i diferencuar«.

»Diferencimi« është një proces krejt zyrtar, i cili i jep mundësi Lidhjes së komunistëve të shpallë kundër interesave të popullit një mendim, dhe pra të marginalizohet çdo njeri që e përkrah këtë mendim, duke ia marrë punën (partia lëshon ende në Kosovë vërtetime të qendrimit të drejtë moral e ideologjiko-politik, të demostrosime për të fituar një punë!), është e ndaluar që të botohen vrprat e tij, që t'i jepet një pronë etj. Atëherë, bëhet e rrezikshme që të vizitosh a të takosh një »të diferencuar« dhe për shembull të shkohesh në varrimin e njerëzve të familjes së tij. Është fjala pra, për një farë »vdekjeje civile«.

Rasti na dha mundësi që të takoheshim me Doktorin X., (ai nuk dëshiron që emri i tij të bëhet i njohur publikisht), ditën kur mori një letër në të cilën e njoftonin, për përjashtimin pa arsye nga Lidhja e komunistëve. Në përgjithësi kështu fillon »diferencimi« Mjekut iu bënë presione të forta qysh kur ka nënshkruar apelin, i cili nuk kërkonte asgjë tjetër veçse ruajtjen e Kushtetutës së 1974. Përfaqësuesit e partisë erdhën në zyrën e tij për ta frikësuar dhe i kërkuan që të braktiste vendin e punës. »Jeta këtu s'është më e mundur për mua, thotë ai, duke na përcjellë, jam i vetëdijshëm se një ditë duhet ta lëshoj vendin e punës: duan të më pengojnë të flas, por s'mund të më pengojnë të shoh, të kuptoj gjithçka po bëhet; bistoraimenuk bën dallim midis serbëve dhe shqiptarëve«.

X... është profesor në Universitet dhe mban ligjërata krejt në gjuhën e huaj që mëson. Studentët serbë, të cilët ishin gjithsej 3, kanë refuzuar t'i ndjekin mësimet dhe kanë kërkuar dhe fituar të drejtën për arsimin në të njëjtën gjuhë të huaj, por të dhënë nga një serb!

»Diferencimi« i ka lënë pa punë dhe i ka nxjerr në periferi qindra intelektualë shqiptarë që prej tetë vjetësh, por nuk ka prekur asnjë serb.

Në marsin e vitit 1989 në vigjiljen e ndryshimit të kushtetutës që e zvogëloi autonominë e krahinës, policia ka futur në burg pa gjykim disa qindra kuadro ekonomike, personalitete me ndikim, madje me përpjesëtim më të vogël intelektualë. Ky proces, i pafajshëm nga një pikëpamje thjesht formale, duke qenë se ligji lejon arrestimin e çdo njeriu që rrezikon rendin shoqëror dhe ta futë në një rezidencë të caktuar (por, pa e cekur që bëhet fjalë për burgun) quhet »izolim«.

Z. Rexhep Ibërdemaj tregon se policët erdhën në orën 3 në mëngjes të armatosur deri në dhëmbë, për ta arrestuar dhe për ta çuar deri te stacioni i policisë në Pejë. Pastaj e çuan me autobus bashkë me disa veta të tjere deri te burgu i Leskovacit, ku e keqtrajtuan bile e torturuan. »Në hyrje, afër një tavoline, gjendej një rojtar i burgut dhe, me sa dukej nga mantili i bardhë dhe stetoskopi rreth qafës, një mjek, i cili merrte shënime për shëndetin tonë. Kur i thashë se vuaja nga zemra, më la një petk mbi kraharor dhe më rrahën më pak se të tjerët...Më e vështirë për mua ishte që të dëgjoja britmat e shokëve të mi, të cilët i torturonin. A vdiq dikush? Nuk e di ... një gjë është e sigurt se u desh ndërhyrja mjekësore disa herë. Unë kam përgjuar një shok, të cilit disa herë i ra të fikët natën dhe vllte (duket këtu turpi karakteristik i njerëzve të torturuar, të cilët flasin më shumë për vuajtjet e të tjerëve sesa të vetat). Të nesermën në mëngjes mora aktin që më njoftonte se isha i izoluar:«I lartpërmenduri është i aftë të takojë njerëz të tjerë dhe t'i çojë kud, të dëshiron«. Në të vërtetë, policia s'ma ka falur që kam marrë si nëpunës në kafenenë time një ish-profesor të së drejtës, i cili kishte qenë »i diferencuar« dhe ishte i papunë: këtë e bëra vetëm për humanizëm që të kishte një mbrojtje shoqërore për vete dhe për familjen.

»Qysh kur kam dalë, më kanë tërhequr pasaportën time, nuk mund të kem kontakte me vëllezërit e mi, të cilët punojnë jashtë: njëri prej tyre bile s'ka guxuar të vijë këtu për varrimin e prindërve«.

Rrëfimi i tij u ndërpre kur hynë në kafe dy policë të veshur civilë, që na ndoqën gjithë pjesën tjetër të ditës. Dëshmitari ynë u largua, duke na folur për frikën se mund ta çonin në mbrëmje në polici!

Z. Anton Kolaj nga fshati Zllakuqan dhe Z. Ramadan Murtez Krasniqi nga fshati Zajm kanë qenë të izoluar 86 ditë, sepse kishin kundërshtuar ndryshimin e emrit të shkollës së tyre, e cila mbante një emër shqiptar dhe tash e tutje quhet Josip Broz Tito.

Në të njëjtën kohë që autoritetet »bëjnë diferencimin« dhe vënë në izolim kundërshtarët, çdo gjë duket sikur Kosova është »e diferencuar« nga pjesa tjetër e Federatës jugosllave dhe e izoluar nga bota. Shkeljet e të drejtave të njeriut megjithëse nuk janë të njohura nga opinioni publik ndërkombëtar, arrijnë një gjerësi dhe një shkallë të rëndë të pashoqe në Evropë, përveç Rumanisë. Deri tashti s'është bërë as një bilanc dhe asnjë dokumentim: këtë na shpjegon Z. I Ibrahim Rugova, kryetari i Shoqatës së shkrimtarëve: njerëzit këtu i ka kapur një farë fobie ndaj dokumentit, aq dënime të rënda kanë pësuar sepse kanë ruajtur në shtëpi qoftë një tekst të thjeshtë, qoftë një listë ose një copë gazete etj.«

Nga të dhënat vetë autoriteteve të Krahinës, nga viti 1981 deri 1988, janë thirrur 584.373 kosovarë me prejardhje shqiptare nga policia për arsye të ndryshme (nga marrja e zakonshme në pyetje deri në arrestim), pra një e treta e popullsisë shqiptare në Krahinë dhe kundër 71000 vetash janë ngritur padi penale. Shtypja e turbullirave të marsit 1989 përfundojë zyrtarisht me 29 të

vdekur. Organizatat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në mërgim kanë paraqitur një listë me 58 emra.

Gjithçka që është dhënë nga këto dëshmi, të kujton stalinizmin më të vjetëruar, më të zhveshur dhe kjo bëhet më 1989, në kohën a perestrojkës, 1500 km larg nga Parisi, në një vend si Jugosllavia, për të cilin mendohej se metoda të këtilla i kishte lënë përgjithmonë bile përpara vendeve të tjera socialiste.

Më 09 Nëntor '89 Paris

KONFERENCA`E SHTYPIT E FEDERATËS NDËRKOMBETARE TË TË DREJTAVE NJERËZORE (F.N.D.NJ) PËR KOSOVË

Prezentë:

- P**— Kryetari i F. N. D. Nj
- Mr. Antoin Garapon, jurist;
- Mr. Alexis Struve, nga A.C.A.T.;
- Mme. Ninaj Mame, kryetarja e Drejtave të Njeriut të Senegalit;
- profesorë të profileve të ndryshme;
- shqiptarë me banim në Francë:
- gazetari i TANJUG-ut;
- Mirko Galic, gazetari i »Danas«-it;
- Atasheu i shtypit të Ambasadës të Jugosllavisë në Francë

Konferencën e hapi Kryetari i F. N. D. Nj. cili pos tjerash tha:

»Po të kishim marrë lajme para disa viteve se një përfaqësuesi të F. N. D. Nj. iu kërcënuan me vdekje, atëherë do të mendonim Amerikën Latine apo Afrikën. Pra, një sjellje aq e ultë nga Qeveria Jugosllave në Kosovë bëri që punën mos ta lëmë aty ku është, por une do ta paraqes këtë problem para Qeverisë Jugosllave.

Gjendja në Kosovë është më e rëndë se asnjëherë tjetër deri më sot dhe një gjendje tëtë tillë nuk mund ta lejojmë«.

Mr. Antoin Garapon:

»Gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë është tepër e rëndë; janë bërë shkelje të rënda të drejtave elementare të shqiptarëve në Kosovë«.

Pasi që foli për Gjykimin e Vlasit dhe mospranimin në proces të përfaqësuesve të 6 ambasadave, Amnestisë Internacionale dhe një numri të gazetarive, Mr. Garapon tha:

»Jugosllavia nuk i rrespekton as të drejtat minimale të shqiptarëve në Kosovë. Ajo që pamë në Kosovë - thotë Mr. Garapon - ishte e tmerrshme. Kërcënimi me vdekje ishte gjë e fundit që mund të pritej. Kështu që lajmërova Ambasadën e Francës. E lajmërova edhe policinë në Prishtinë - të cilët ma mbyllën

telefonin pa përgjygje.

Sipas Radio Prishtinës - thot Garapon - ishin 4 të vdekur e në mbrëmje të po asaj dite numri i të vdekurve u zvogëlua në 2!«

Garaponi ka dëshmi se Bedri Sokolin e ka vrarë polici civil Jakup Hoti. Garapon thekson vandalizmin e Jakup Hotit.

Antuan Garapon bënë apel duke thënë se s'ka paqë në Kosovë pa rrespektimin e të drejtave të njeriut.

»Proceset politike - shton Garapon - diferencimet, izolimet ashtu siç i kemi cekur në »Le Monde Diplomatique« (Nëntor '89), janë fatale për shqiptaret e Kosovës«.

Në vazhdim fjalën e mori Marc Gjidara (profesor në Universitetin e Sorbonës) i cili pas një fjalimi të thukët mbi çështjen e Kosovës, ndër të tjera tha: »Të burgosurve politikë shqiptarë u suprimohen të gjitha të drejtat: nuk dihet se kur do të qiten para gjyqit, nuk vendos gjykatësi për dënimin e tyre, s'kanë të drejtë mbrojtjeje, etj. por e gjithë kjo përgatitet nga raportet e policisë, gjegjësisht, nga dosjet e kurdisura të policisë. Pra - tha ai duke iu drejtuar sidomos përfaqësuesit të Ambasadës Jugosllave - në Kosovë për të gjithë shqiptarët që jetojnë atje, nuk ekziston as minimalja e respektimit të të drejtave të tyre. Jam tepër i dëshpëruar me situatën e shqiptarëve të Kosovës« i drejtohet ai Kryetarit të F. N.D. Nj.

Në fund të konferencës Garapon thotë edhe këtë: »Ajo që mund t'ju sigurojdhë çkae vërtetova në udhëtimin e dytë në Kosovë është se shqiptarët nuk kanë kurrfarë garancie të sigurimit të të drejtave të njeriut edhe pse jam i bindur se ligji ofron garanci. Diferencimin ju e dini se ç'është: më e liga që mund t'i ndodhë një populli.«

PATJETËR PARA EMRIT E MBIEMRIT
RR. M. TË THONI »ME NDERË ME THANË«!



KODRA E DIELLIT

NEKAJ UTRINKOV S POTI PO JUŽNI SRBSKI POKRAJINI

Ugotoviti pravo resnico o nekem dogodku na Kosovu, je skoraj nemogoče. O vsakem pripetljaju obstaja vrsta resnic, in med njimi mora vsakdo sam najti tisto, ki se mu zdi najbolj verjetna. Tak informacijski »pluralizem« pa ne povzročajo le razlike med neuradnimi, torej uličnimi in uradnimi, institucionalnimi resnicami, ampak še bolj odsotnost, zakasnelost ter protislovnost uradnih resnic samih. Že samo primer iz rudnika v Starem trgu, ki sem ga opisal v prejšnji številki ZZ, je dovolj zgovoren. Uradne informacije dveh članov vodstva rudnika, ki sta govorila o nenasilni akciji reševalcev, so bile v popolnem nasprotju s poluradnim pisanjem beograjske Politike; primer slovenskih miličnikov, ki niso hoteli v rudnik, kar se je razkrilo šele pozneje, pa je potrdil navedbe časopisa, ki sicer ne slovi po svoji korektnosti. Še bolj je v meglo resnic zavil dogodek na sedaj že skoraj legendarnem Sunčanem bregu, po albansko Kodra e diellit.

Po prihodu iz Titove Mitrovice so naju z Garaponom v hotelu Grand v Prištini že čakali prijatelji z novico, da se na Sunčanem bregu dogaja nekaj velikega. (Kodra e diellit ali Sunčani breg se namreč imenuje del Prištine, kjer je tudi naselje stanovanjskih blokov.) Kot so povedali, tam že nekaj ur poteka streljanje med policisti in štirimi ali petimi Albanci, ki so zabarikadirani v nekem bloku. Več ni vedel nihče. Pridružil se nama je Ali Žerdin in pohiteli smo tja, da bi na kraju samem ugotovili, kaj se v resnici dogaja. Okoli naselja je precej ljudi s strahom in radovednostjo opazovalo v smeri neznanega kraja, ki se je skrival za prvo vrsto blokov. Področje je bilo tudi obkoljeno, in v popolno bojno opremo opravljeni specialci (taki so bolj ali manj povsod po Prištini) so spuščali le stanovalce naselja. Mi smo seveda hoteli dalje, a so nas takoj ustavili. Potrdilo (v francoščini), da imamo mandat Mednarodne federacije za človekove pravice, so oplazili le s pogledom. Po opozorilu, da nas ubijejo, če se bomo preveč približali dogajanju, so nas spustili dalje. Streljanja že nekaj časa ni bilo slišati in le množica nekaj desetih specialcev okoli nekega bloka je nakazovala, kje se dogaja tisto »nekaj«. S strahom, kaj ne bi priznal, smo se približali zgradbi na deset do dvajset metrov, ko se je začel iz kleti valiti gost oblak solzilnega plina. Okoli okna so se v pozah, kot smo jih že nešteto krat videli v vojnih filmih, plazili policisti. Ker seveda nismo bili opremljeni za take primere, smo se morali umakniti pred plinom do bližnje višje stoječe zgradbe, kakšnih 50 metrov dalje. Mislili smo, nevedneži, da bo vsa stvar kmalu končana, saj smo (prav tako iz filmov) navajeni, da po napadu s solzilcem ni več dolgo do zaključnega vdora v zgradbo. A tega nismo dočakali.

Pred vrati zgradbe, kjer smo sklenili počakati na zaključek akcije, je stala mati z dvema predšolskima otrokoma ter stanovalec iz hiše. Povprašali smo ju, kaj se v resnici dogaja. Moški je povedal, da je bilo že pred dobrimi petimi urami slišati streljanje »kot v vojni, sedaj pa je že približno pol ure tišina«. Mati je v strahu za svoja dva otoka, ki sta bila že od začetka akcije zaprta v stanovanju nad obkoljenci, spraševala, kaj naj naredi, saj jo policija ni spustila v stanovanje. Lahko si predstavljamo, kaj sta doživljala otoka, ki sta bila deset ur sama v stanovanju, zavitem v solzilni plin (solzilec so snemalne ekipe, ki so prišle snemat zgradbo, vohale še naslednji dan popoldne), ob tem, da se je okoli zgradbe streljalo. In takih otrok je bilo najbrž še veliko, saj je bila skoraj polovica stanovanj v hiši osvetljena. Zaradi jasnejše podobe o verodostojnosti informi-

ranja na Kosovu moram še dodati, da sem naslednji dan v časopisu prebral (poleg informacije o štirih žrtvah), da je bila zgradba že ob treh popoldne evakuirana...

Kmalu po našem prihodu je k nam pristopil vljudni policist v civilu, ki nam je priporočal, da se umaknemo na varno, ker da je bivanje pred zgradbo smrtno nevarno. Ženska z otrokoma ga je vprašala, kaj naj naredi. Odgovoril ji je, da naj otrokoma v stanovanju telefonira, in sporoči, da zapreta okna in čakata. To je sama storila že prej. Več ji verjetno tudi ni mogel pomagati. Sam sem ga vprašal, ali pričakuje streljanje. »Že ves dan se tu strelja,« mi je odgovoril. Na moje naslednje vprašanja, kaj se tu v resnici dogaja, pa nisem več dobil odgovora. Le zamrmral je, nas ponovno opozoril na nevarnost našega zadrževanja pred blokom in odšel. To opozorilo nam je prišel sporočiti še enkrat ali dvakrat, vendar smo mu odgovorili, da tveganje prevzamemo sami. Domačini so se umaknili v hišo k sosedom. Drugače pa se ni dogajalo dobro uro skoraj nič. »Na zahodu nič novega«, bi lahko z malo sarkazma ponovil slavnega pisatelja. Le nekajkrat smo malo jokali, ko je veter spremenil smer in nas s solzilcem iz kleti spomnil, da vse le ni tako spokojno, kot je videti. In posamezni policisti so se vedno bolj sproščeno sprehajali pred kletnim oknom, kot da bi vedeli, da jim od tam ne grozi nobena nevarnost več... Sami pa smo se spraševali, kaj toliko časa čakajo, saj nobeno bitje ne more preživeti takih količin solzilca ure dolgo. Verjetno so čakali, da se bomo naveličali. Ta čas pa so bili v centru Prištine bitke med demonstranti in policijo.

Končno, ko je bilo že dovolj temno, so se policisti premaknili proti zgradbi. Toda nekaj metrov pred njo so se ustavili. Spomnili so se na nas in spet poslali starega znanca v civilu, da bi nas odgnal. »Čakamo na zaključek akcije,« je bil odgovor na vprašanje, kaj še počnemo tu. »Vi opravljajte svoj posel, mi pa bomo le opazovali, ali poteka vse v skladu z zakoni.« Bili smo pripravljene tudi pričati svetovni javnosti, da so v kleti teroristi, če nam bi omogočili opazovanje in če bi ugotovili, da je to res. »Nič ne boste videli, imamo le trening akcijo,« nam je odgovoril civilist. »Kakšno trening akcijo neki, če pa že ves dan poka kot v vojni,« se nisem pustil odnati. »Kdo ti je to povedal?« se je razburil, ker je verjetno že pozabil, da nas je ob prihodu s tem sam hotel odgnati. Ko sem mu odgovoril, da on sam, mi je pojasnil, da streljajo le s slepimi naboji. »Zakaj pa ste rekli, da smo lahko ubiti, če se ne umaknemo?« sem bil nesramno vztrajen. Jezno je zamrmral nekaj podobnega kot »tudi s slepimi naboji je lahko kdo poškodovan!« in odšel k svoji ekipi. In s tem se je dosedanja prijaznost tudi končala.

Čez nekaj trenutkov se je vrnil s skupino desetih ali več miličnikov, opremljenih po vseh predpisih zastraševanja: avtomati, maske, lisice, čelada, oklep... Med miličniki so bili nekateri, verjetno pomembnejši čini, česar v precejšnji temi, ki so jo redčile le luči blokov, nismo mogli ugotoviti, oboroženi tudi z aroganco, agresijo in pretnjami. Začel se je popolnoma drugačen postopek. »Kaj imaš tu? Orožje?...« Nemogoče se je spomniti vsega, še posebno, ker so ukaze kričali drug čez drugega. Pri tem je bilo v nas naperjetnih kar lepo število avtomatov. Garapon je bil kmalu rešen tega, saj sem mu moral vsak ukaz prevajati, kar pa je vsako pretnjo izničilo. Zato je lahko bolj v miru opazoval postopke z nama z Alijem. Kmalu pa je ves gnev skupine padel na Alija, saj so ga »civilisti« spoznali, da »je vedno tam, kjer je gužva«. Prejšnji dan je bil namreč v bližini prve jesenske žrtve, Sokolija. Vso stvar je zapletel še magnetofon, ki ga je imel pri sebi. Policisti so se bali, da snema njihov prikaz odgajanja prič. Zaplenili so mu ga, pozneje pa vrnil, seveda brez kasete.

Ta primer me je tudi prepričal, da se s specialci, ki hočejo narediti vtis in odgnati priče (kaj bi drugega to lahko bilo), sploh ne da pogovarjati. Za vsak odgovor na njihovo vprašanje ponovijo isto vprašanje, seveda glasneje in bolj preteče, tako da se vprašanje kmalu spremeni v trditev. Če hočeš prekiniti tak neploden pogovor, ti končno ostale le, da zavrneš odgovarjanje. To jih za trenutek zmede, kar traja le nekaj trenutkov. Drugi začne ponovno spraševati/trditi, dokler se postopek ne ponovi. To lahko opišem na primeru vprašanja, ali sem okoli treh popoldne fotografiral akcijo. (Kasneje sem izvedel, da je neki bradač v resnici fotografiral.) Ko sem mu odgovoril, da sem bil v tem času v Titovi Mitrovici pri namestniku predsednika sodišča, kar lahko takoj preveri, je vprašanje, seveda ostreje, ponovil. Jaz svoj odgovor tudi. Tudi on. In tako nekajkrat, pri čemer se je vprašanje počasi spreminjalo v trditev. »Ti si fotografiral!« Na koncu mi seveda ni ostalo nič drugega, kot da sem odgovoril, da mu ne bom več odgovarjal. Tisti trenutek se je vmešal drugi, ki me je jezno vprašal, zakaj človeku, ki me je lepo vprašal, nočem odgovarjati. Seveda sem mu odgovoril, da ne sprašuje, ampak trdi. »Ne trdi, lepo sprašuje!« mi je bilo vrnjeno. In tako dalje, dokler mu končno nisem odvmil, da bom molčal. Če smo naredili kaj narobe, naj nas zaprejo in se bomo pogovarjali s sodnikom. »Kdo pravi, da vas bomo zaprli?«, se je ponovno začela igra s tretjim.

Iz takega prerekanja me je za trenutek »rešil« naslednji, ki je hotel fizično obračunati z Alijem zaradi njegove prisotnosti v vsaki gužvi. Ali pa zaradi njegove rekonstrukcije uboja Sokolija za ljubljansko televizijo. Nadel si je masko in skozi njo nerazumljivo kričal. Prijel ga je za šal in hotel udariti. A si je premislil. Ukazali so edinemu neoboroženemu miličniku, da nas naj popiše in nažene.

A tudi popisovanje ni potekalo mirno. Sam bog ve, kateri šef je pritekel in začel vpiti, kaj bo naredil z mano, če me še enkrat sreča na Sunčanem bregu. Ko sem ga prosil, naj mi ponovi, ker ga nisem dobro slišal, je zakričal, da nikakor ne misli govoriti slovensko, saj govori jugoslovanski jezik. Pojasnil sem mu, da ni vprašanje v jeziku, ampak v nerazumljivem kričanju, kar je povzročilo še hujše kričanje. Končno sem imel kričanja dovolj in sem mu tudi sam ostro rekel, da morava razčistiti dve stvari. Prvič, zanj nisem ti, ampak vi, in drugič, naj normalno sprašuje, če hoče dobiti odgovor. »Ti boš zame vedno ti in kričal bom toliko, kolikor bom hotel,« mi je odgovoril. »Jaz pa molčal,« sem mu odvmil. »Tako je tudi prav,« je besno zaključil pogovor in odšel.

Po popisovanju dokumentov smo bili s »Srečno dečki!« vljudno odpravljeni.

Večer smo preživeli v prijetni družbi pri prijatelju iz Prištine.

Med glavne ovire vzpostavitve miru na Kosovu bi po tamkajšnji uradni politiki in beograjskem časopisju Politika lahko šteli Tita, Partijo, Ustavo in Ustavo 74. Tako namreč piše v sporočilu, ki ga je na 5. strani v okviru objavila Politika 4. novembra. V poročilu o dogajanju na Kosovu piše, da so demonstranti vzklikali med drugim tudi taka sovražna gesla. Da pa je neustavnost in s tem brezzakonje tudi res glavna značilnost sedanjega Kosova, me je prepričal tudi zadnji obisk te južne srbske pokrajine. Tam se po mojem mnenju rojeva, če že ni rojena, državljanska vojna, ki jo dobesedno izsiljujeta sedanja srbska in jugoslovanska politika do Kosova.

Kot jugoslovanski član Mednarodne federacije za človekove pravice (drugi je bil Antoine Garapon, sodnik iz Pariza, ki je v podobnih odposlanstvih obiskal že velik del svet, predvsem dežele Srednje Amerike, kjer divjajo državljanske

vojne) in kot predstavnik ljubljanskega Odbora za zaščito človekovih pravic na Kosovu sem imel priložnost nekaj dni opazovati izvajanje »politike pomiritve stanja na Kosovu«, to je politike, ki to gibanje v resnici še bolj oddaljuje (in z njim seveda vse nas, ki živimo v Jugoslaviji) od Evrope in sveta enaindvajsetega stoletja. Zato je tudi normalno, da se politika boji vsakega nepoklicanega kritičnega očesa, saj v svojem programu nima nobenih pozitivnih ciljev, ampak le iskanje sovražnikov in njihovo neprestano diferenciranje. Če pa delovanje neke politike temelji le na skrivanju lastnih napak, nemoči in nesposobnosti, s prenašanjem vse krivde na druge, je tudi popolnoma razumljivo, da ne more biti uspešna niti kratkoročno, kaj šele dolgoročno. Zato so ji »nedobronamerni« opazovalci, ki ji ne verjamejo kar na lepo besedo, zelo nadležni. Potem je tudi normalno, da so prejšnjo misijo, ki je Kosovo obiskala pred mesecem in pol, ne preveč diskretno spremljali. Da pa si člani sedanje ne bi delali prevelikih utvar o kakšni spremembi njihovega dela ali pa stanja na Kosovu, jo je policija popisala že kar pri vstopu na ozemlje Socialistične republike Srbije. Pri tem pa so bili miličniki na letališču izjemno korektni; še več, trdim lahko, da celo prijazni.

Tako se je začela druga misija Mednarodne federacije za človekove pravice in peta mednarodna letos na Kosovu. Kot se še verjetno spominjamo, prvi dve nista dobili skoraj nikakršnih informacij, če seveda kratenja informacij ne štejemo za dobro informacijo, odposlanci Evropskega parlamenta pa so skoraj užaljeni odšli iz Jugoslavije. Ker so se oblastniki verjetno nekaj naučili ali pa so bili zaradi blatenja ugleda Jugoslavije v svetovnih očeh okarani, so naslednje pustili, da so bolj ali manj svobodno brskale po smetišču, a so jim zaradi reda dali vedeti, da so nadzorovani.

Najina večerna pot od Beograda do Prištine je potekala relativno normalno. Nočna vožnja, kot vse druge. Do Niša lepa avtocesta; pa tudi dalje, z izjemo nekaterih odsekov, se nad potjo ne bi mogla preveč pritoževati. Malo pred Prištino okoli dvajsete ure zavijeva v Podujevo, ki je znano po najhujših demonstracijah. Mesto popolnoma mrtvo. Kot mesto strahov. Po cestah steklo in kamenje, tu in tam kak potepuški pes. Ko sva nekaj časa križarila po mestu, sva le srečala človeka, ki se je vračal iz službe (nekoč je delal v Celju — zanimivo, koliko Albancev, ki so nekoč ali pa še sedaj delajo v Sloveniji, srečaš na Kosovu) in nama je povedal, da so bile pred nekaj urami demonstracije, pretepanje, streljanje. Prava bitka. Ali je bil kdo poškodovan, zaprt, ubit... ne ve, ker je delal. Ker več nisva mogla ugotoviti, sva nadaljevala pot proti Prištini. Tu pa sva že v predmestju prvič naletela na stanje po končani vojni. Povsod z avtomatskimi puškami oboroženi policisti. Naslednji dan sva izvedela, da je tam le nekaj ur pred tem padla prva žrtev demonstracij. Neoboroženega demonstranta je po izjavah prič ubil pred nekaj meseci odstavljeni in sedaj ponovno nastavljeni policijski inšpektor Jakup Hoti. Uradna izjava naslednji dan je bila seveda drugačna. Žrtev pa so na hitro pokopali že naslednji dan ob treh popoldne...

Naslednji dan sva se odpravila v Titovo Mitrovico, da bi poskušala izvedeti, kako je z obtoženimi, kako so stavkajoče rudarje izvlekli iz jam, ali so ljudje, ki so pred mesecem dali izjave za isto komisijo, imeli zato kake neprijetnosti. Zadnje sva izvedela takoj, saj so bili ljudje prestrašeni in niso mogli (želeli?) dajati nobenih neprijetnih izjav. Kaže pa tudi, da so bili nadzorovani. Vsaj najina »zveza« je dobila obisk, ko nisva bili pri njej niti dve minuti. Ker nisva zvedela za nikogar, ki nama bi lahko kaj koristnega povedal, sva se odpravila dalje. Na sodišče.

Na sodišču naju je presenečen sprejel namestnik predsednika Bigović, ki nama seveda ni mogel nič pomagati. Prijazno je poslušal namen najinega prihoda (nisva tu zato, da bi delala probleme Kosovu, Srbiji ali Jugoslaviji, ampak je stalna praksa te federacije, da obiskuje procese, ki bi utegnili biti sporni; tudi po zahodnih državah), želje (obiskati obtožene, izvedeti, zakaj sojenje ni javno in v večji dvorani) in zahteve po informacijah (kako se je končal poslednji starotrški štrajk, ali so koga od stavkajočih zaprli itd.). Ker sam na to ni mogel odgovoriti, predsednik sodišča pa je bil zaseden, naju je prijazno povabil v hišni bife, kjer je naročil, da naj naju gostijo, sam pa se je medtem sestal s predsednikom sodišča, da bi nama prenesel njegove odgovore. (Pri tem moram priznati, da si ne morem pomagati, da imam občutek, kot da je predsedujoči zaprt in sam dobiva navodila o procesu.) Čez pol ure sva bila poklicana k Bigoviću, ki nama je povedal, da obtoženih ne moreva videti, lahko pa zaprosiva preko Beograda, da je želja po prisostvovanju toliko, da bi bila vsaka dvorana premajhna (kar devet veleposlaništev, Amnesty international, tuji novinarji, če lahko omenim le nekatere), da je v pristojnosti višjega sodišča, kdaj se bo proces nadaljeval in ali bo pritožbam ugodeno (da je formalno tako, sva vedela že prej, a žal pri tem procesu ne gre vselej le za formalnosti), da ne ve nič o stavkajočih rudarjih, ker njihov problem še ni bil predan sodišču. Če hočeva kaj izvedeti, naj se obrneva na upravo rudnika. Pri tem lahko dodam le še to, da je bil Bigović izjemno korekten, ustrezljiv in vljuden ter se je skoraj pri vsakem odgovoru skliceval na Garapona, »češ, moj kolega že ve, da stvari potekajo tako...«.

Njegov nasvet o obisku pri upravi sva tudi upoštevala. Čeprav sva pred tem veliko slišala o policijski zapori Starega trga, da policija vsakih nekaj metrov pregleduje legitimacije, tega midva nisva doživela. Brez kakršnihkoli težav sva prišla do uprave, kjer sva komaj prepričala oboroženega vratarja, da je najavil najin prihod direktorju. Tu pa sem doživel prvi neprijeten incident. Ko sva po popisovanju dokumentov, ki je, mimogrede, trajalo dalj časa kot najin obisk pri direktorju, me je v preddverju napadel besni silak. Agresivno je zahteval, da mu najprej jaz pojasnim, kaj govorijo Smole, Kučan in Stanovnik, potem mi bo pa on povedal, kaj je z rudarji. Ko sem mu odgovoril, naj to vpraša Smoleta, Kučana in Stanovnika, ker jaz nisem njihov advokat, sva bila povabljeni v pisarno. Tam sva bliskovito opravila. Rudarje, ki so baje komaj čakali, da nekdo pride ponje, so iz rudnika pripeljali reševalci in ni bilo nobene policijske akcije, nobenega niso zaprli niti vrgli iz službe, so le začasno suspendirani, ker so delali škodo 25.000 ljudem.

V beograjski Politiki pa je bila čez celo stran objavljena reportaža o izjemni akciji specialcev iz Beograda....

(Nadaljevanje v naslednji številki)

MARTIRËT E KOMBIT

SHTJEFËN GJEÇOVI (1874-1929)

Më 14 tetor 1929 regjimi monarkofashit i kral Aleksandër Karagjorgjeviqit, duke vazhduar terrorin e egër mbi popullin shqiptar, bëri edhe një krim të paparë. Dora mizore e këtij regjimi vrau At Shtjefën Gjeçovin - veprimtarin e shquar të lëvizjes atdhetare, mentarin e madh, pishtarin e arsimit e historianin, arkeologun e etnografin, shkrimtarin e gjuhëtarin. Ai ra martir i çështjes kombëtare shqiptare për të cilën punoi e luftoi tërë jetën.

Duke përkujtuar me nderim dhe pietet përvjetorin e rënies së Gjeçovit - kësaj figure të ndritshme të shkencës dhe të kulturës shqiptare, po riprodhojmë dy shkrime nga pena e Faik Konicës dhe e Zekeria Canës.

ZEKERIA CANA

VORRI I GJEÇOVIT

Qëlloi ajo ditë gushti fort me vapë, kur na solli puna në Hasin e thatë. Mbase ushtruam kërkimet shkencore nëpër disa fshatra, vendosëm të ndërprejmë punën për atë ditë, sepse na kishte lodhë etja, rruga e gjatë dhe e vështirë. Por, mua më thoshte mendja të kthejmë edhe në Zyum, jo pse më tërhizte fshati, veçse e ndiejsha fort të nevojshme ta plotësojsha një dëshirë të kahershme - që nga bankat e shkollës normale, të kthej për të parën herë atje ku pushon fort i ndritshmi At Shtjefën Gjeçovi. Kolegët e mij nga Beogradi pëlzyen propozimin tim dhe kështu vazhauam rrugën.

Kur mbërrimë në Zym, atëbotë mësova se nuk e kishim sosë rrugën: Gjeçovi qenka i varrosur, në Karashëngjergj. Zura të jem i padurueshëm si fëmija e nuk më pritej të gjindem pranë atij vorri si fëmija e nuk më pritej të gjindem pranë atij vorri të mentarit të shquar, njeriut me virtyte të rralla, që e sosi jetën ashtu si nuk e kishte ba veten - me plumba në ball.

Me të mbërrimë në Karashëngjergj kthjem në vorrezat e fshatit, që ndodheshin në oborrin e kishës së rrënueme. Këtu na priti befasija e parë: përcjellësi ynë, që ishte njeri i vendit, kërkoi disa vorre por nuk dinte të tregojë cili ishte ai i Gjeçovit. Nuk dijtë as një tjetër të cilin çuem dhe e thirrëm për një fëmijë. Erdhi ma në fund një plakë. Na çoi në kishëzën e rrënueme dhe na tregoi me gisht gërmadhën e gurëve. Mësova se nën ata gurë pushon i shkreti Gjeçov. I hoqëm disa lëndë që kishin ra përmbi, por nuk gjetëm tjetër veçse rrasa gurësh. S'kishte aty asnjë shej vorri.

Kurr nuk do të më shkonte ndërmend se do ta gjejsha vorrin e Gjeçovit në gjendje aq të mjerueshme, sa të të mbërthejë vaji. Më mbante Shpresa se sëpaku do të kem fatin të pushoj pranë një vorri të regulluem si ka hije - si meriton një njeri fare i zakonshëm e jo ma një njeri i pendës, gjurmues dhe mbledhës i pasionuem i të drejtës dokanore dhe vjetërsinave arkeologjike. Më pyetën kolegët e mij cili ishte ai që pushon nën gërmadhat e gurëve. Nuk pata shtek pa u tregue emnin dhe thesarin e rrallë që na ka lanë trashëgim. U tregova edhe në ç'mënyrë mizore e vranë xhandarmët në vjetin 1919, shi atëherë kur ne nuk kishim njeri tjetër të pendës. Por, shpejt u pendova që historianëve të

mirënjoftun të Beogradit u tregova emin e vorrin nën gërmadhat e gurëve. Atyne u zbulova turpin tonë të madh - një faj që nuk paguhet me kurgja. Atëbotë ata më mbajtën një mësim qortimi. E unë e ndjeva veten fort ngusht, e si mos ma keq kur mësova nga goja e tyne se Gjeçovi meritueka t'i ngrehim një monument. Ky qenka borxhi ynë. E mue nuk më ngeli tjetër veçse të ndëgjoj në heshtje porosinë e të tjerëve e të pranoj në vete sa jemi mbrapa.

Ngela bukur do kohë tue shikue me turp gërmadhën e gurëve. E vajtova me lot Gjeçovin e harruem, të shkretuem, të përbuzun - nga ne. Pushova pranë atyne rrasave gurësh i kapërthyem në vaj, e mu kujtue edhe Rela i mjerë që e lëcitëm nga kujtimi aq shpejt. Ndoshta asht vështirë me shkue deri në Zarë. Larg asht edhe Gjeçovi - te dera e shtëpisë. Mu kujtue tue vajtue Gjeçovin, se nuk asht vetëm vorri i Josip Relës në Zarë. Pushon atje edhe një njeri i gjakut tonë. Asht një pishtar arsimit, që tanë jetën ia kushtoi përhapjes së fjalës e gjuhës shqipe. Ndodhet i vorrosun në Zarë Niman Ferizi, mësues i shkollës së parë shqipe në Gjakovë. Ishte ai partizan i njimendët i Revolucionit demokratik në Shqipëri nga vjeti 1924, ithtar i qeverisë së Nolit dhe bashkëluftar i Bajram Currit. Nëse ndonji herë do të na bie ndërmend ta kërkojmë vorrin e tij, nuk do ta gjejmë ma.

Nxjerrë nga *Rilindja*, 3.VIII.1967

FAIK KONICA

CA KUJTIME MBI AT GJEÇOVIN

At Gjeçovin e pata njohur me anë letrash disa vjet përpara luftës Ballkanike. Më 1913 shkova në Shkodrë dhe atje, në Kuvënt të Franciskânëve, një ditë u-njohmë me sy e me fjalë të gjalla. Mendimet e nderimi, që kisha patur për At Gjeçovin për së largu, m'u shtuan ca me tepër që kur u-poqmë. I mesmë nga gjatësia trupit, pakë si i thatë, me një palë sy të zeza ku çkëlqente mendia po dhe zemërmirsia, At Gjeçovi fitonte menjëherë besimin dhe dashurinë. Fjalët i kish të paka po kurdoherë në vënt. Vetëm kur në të kuvënduar e sipër takohej nonjë pikë mi të cilën kish dituri të veçantë - si për shembëll Kanuni i Lek Dukagjinit ose vjetëritë greko-romane - At Gjeçovi çelej ca më gjatë, dhe ahëre ish gëzëm t'a dëgjonte njeriu.

Asi kohe At Gjeçovi ish »famulltar«, domethënë prift i ngarkuar me shërbimin e një fshati ose rrethi, dhe rronte në Gomsiqe, i pari katunt i Mirditës mbi udhë nga Shkodra në Orosh. A i vemi musafirë At Gjeçovit nonjë ditë të kësaj jave? me pyeti një herë At Fishta, me të cilin piquesha çdo ditë në Shkodrë. Mendimi i një vizite At Gjeçovit me pëlqen pa masë. Ashtu, pa humbur kohë, u-nismë. Një gjë për të vënë re, dhe që më mbushi me habi dhe trishtim, është se nga Shkodra gjer në Gomsiqe, një udhëtim shtat' a tet' orësh me kalë, nukë gjetmë as katunt as shtëpi; veç një han të varfër, ku qëndruam për të pirë një kafë, s'pamë gjëkund nonjë shënjë gjallësie: një vënt i zbrazur e i shkretë, si i harruar nga "perëndia dhe nga njerëzit." po mërzia e udhëtimit na u-çpërblye përtëj shpresës posa arrijmë në Gomsiqe, ose, që të flasim me dréjt, në famullitë të Gomsiqes, - se katundi vetë i shpërndarë tutje-tëhû, një Shtëpi këtû, një shtëpi nj' a dy mile me tej, as që dukej.

Famullia - një biná prej guri, e ndritur dhe e paster, gjysm' e zbrazur nga plaçka

po e mbushur dhe e zbukuruar nga zëmëra e madhe dhe nga buzëqeshja e të zotit shtëpisë-qëndronte, mirëpritëse dhe e qetë anës një lumi. Këtû ronte At Gjeçovi. Këtû e shkonte jetën, në mes të lutjes e mësimeve, një nga një në të lartë që ka patur Shqipëria: një lartësi e përulur, në munt t'afroj e të lith dy fjalë aqë të perkûndërta; një lartësi shpirti dhe mendje e panjohur nga njeriu vetë, i cili, bir i vërtetë i të Várfërit t'Assisit në pastëri e në vobësi të zëmrës tij e dinte veten të vogël. Famullia, shkollë dhe vënt këshillash të mira, u jipte fëmijëve themelet e stërvitjes, u përdante fjalët e urta dhe ngushëllimet njëresve në nevojë. Kohën që i tepëronte, At Gjeçovi j'a kushtonte studimit.

Menej ahëre me institutat e vjëtëra të Shqipërisë, nga të cilat një gjë arriu gjer në ditët t'ona "Eshtë Kanuni i Lekë Dukagjinit Askûsh nukë munt t'i afrohej At Gjeçovit në diturin'e këtij Kanuni. Na tregój një dorëshkrim nj' a dy-mij faqesh, studiim i palodhur e i hollë ku kish mbledhur, radhitur dhe ndritur të gjitha sa kanë mbetur nga mendimet juridike të Shqipërisë në Kohën e Mesme, mendime të cilat ngjan t'i kenë rrënjët shumë përtëj Kohës së Mesme.

Në kat të sipërm të famullisë, permi një tryzë të madhe, ishin shtruar një tok vjetërirash greko-romane, të zbuluara e të mblédhura një nga një, me një fatbardhësi të rrallë dhe me një shie të mbaruar, nga dora vetë e At Gjeçovit. Mbaj mënt, veçan, një enë të vogël të qojtur »lacrumatorium« lotore, asis që të vjëtërit, në besim se të vdëkurit qajnë të shkúarit e jetës tyre, i mbulonzn në varr bashkë me të vdëkurin që ky të kish se kû t'i mblithte lottë. Nuk më shkonte ahëre kurrë nër mënt se pas ca vjet sicilidò prej nesh, miq dhe admironjës të tij, do të kishim nevojë që në gjallësi për nga një lotore ku të mblehim lottë t'ona për At Gjeçovin...

Bir i përulët i Shën Franciskut, i ditur me një dituri pa tingëllim, po dhe Shqipëtar i kthiell, At Gjeçovit, që përkiste çdo mirësi, nuk i mungój asnjë hidhërim, asnjë çpifje, më e çuditshima e të cilave ndoshta është të mohuarit se ay ish Shqipëtar. Sepsë ish lindur në një kufi gjúhërash, në një kufi ku sot mbaròn shqipia dhe nis një tjatër, ca mëndje të klasës katërt, të pazonjat të kuptojnë se folësit e shqipes në vijën me të perparuar janë stërnipërit e at'yreve që me qëndrimin e tyre në Kohën e Mesme dhe pastaj, ndaluan të mprapsurit e vijës më tehû, ca mëndje të klasës katërt e përmbysin të vërtetën dhe e kthejnë në të sharë atë që është një lavdi.

Po At Gjeçovi është permi çdo sharje. Emëri i këtij njeriu të rallë do të vejë duke u-ritur- dhe një ditë famullia e Gomsiqes do të jetë një nga gurët e shëntëruar të Shqipëtarisë.

Shkrimi i Faik Konuës botua nëgazetën Dielli , më 18 mars 1930

**PATJETËR PARA EMRIT E MBIEMRIT
RR. M. TË THONI «ME NDERË ME THANË»!**

NACIONALNI MUČENIKI

SHTJEFËN GJEÇOVI

1874-1929

Stirinajstega oktobra leta 1929 je monarhofašistični režim kralja Aleksandra Karađorđevića v nadaljevanju nasilja nad albanskim narodom storil še en zločin. Okrutna roka tega režima je ubila očeta Shtjefëna Gjeçovija — znamenitega tvorca rodoljubnega gibanja, velikega misleca in plemenitega zgodovinarja, arheologa in etnografa, pisatelja in jezikoslovca.

Padel je kot mučeniška žrtev za albansko nacionalno vprašanje, za katero je vse življenje dela in se boril. S spoštovanjem se ga spominjamo in o tem bleščečem velikanu ved in albanske kulture za obletnico njegove smrti objavljamo članka, ki sta ju napisala Zekeria Cana in Faik Konica.

ZEKERIA CANA

GJEÇOVIJEV GROB

Vročega avgustovskega dne smo bili službeno v Suhem Hasu. Po znanstvenih raziskavah, ki smo jih opravili v nekaterih vaseh, smo bili precej utrujeni. Odločili smo se, da za ta dan z delom končamo. Od dolgega potovanja, težke in neprimerne poti smo bili tudi žejni. Zelo sem si tudi želel obiskati vas Zym. Ne zato, ker me je ta vas privlačila, ampak ker sem želel izpolniti davno željo, še iz šolskih klopi učiteljske šole, da bi obiskal grob, kjer počiva presvetli oče Shtjefën Gjeçovi. Tudi kolegi iz Beograda so se strinjali z mojim predlogom, tako da smo nadaljevali pot.

Ko smo prišli v Zym, sem zvedel, da še nismo na koncu poti; Gjeçovi je namreč pokopan v Karashëngjergju. Postal sem nestrpen kot otrok in komaj sem čakal, da bom videti grob velikega misleca, katerega življenje se je končalo s kroglo v čelu — smrtjo, ki si je ni zaslužil.

Ko smo prišli v Karashëngjergj, smo se napotili na vaško pokopališče, na dvorišču podrte cerkve. Tukaj nas je čakalo prvo presenečenje. Naš vodič, človek iz tega kraja, je iskal Gjeçovijev grob, a o njem ni vedel nič. Poslali smo otroka, da pokliče domačina iz te vasi. Tudi on ni ničesar vedel. Končno je prišla starejša ženica, ki nas je napotila do podrte cerkve in pokazala prav na kamnito podrtijo. Zvedeli smo, da pod tistimi kamni počiva Gjeçovi. Odstranili smo nekoliko predmetov in razen kamnite plošče nismo ničesar našli. O kakšnem grobu ni bilo niti znamenja. Nikoli ne bi verjel, da bom našel Gjeçovijev grob v tako žalostnem stanju. Skoraj sem izbruhnil v jok. Upal sem, da bom imel vsaj malo sreče stati ob urejenem grobu, ki si ga je oče Gjeçovi zaslužil, kot si ga zasluži vsak človek.

Moji kolegi so me spraševali, kdo počiva v kamniti podrtiji? Drugega izhoda nisem imel in povedal sem jim resnico. Njegovo ime in njegov zaklad, ki nam ga je pustil v nasledstvo, ter njegova nasilna smrt. Zaradi žandarske krogle je moral predčasno umreti leta 1929. In to takrat ko je bil on naš edini človek peresa. Žal mi je bilo, ker sem znamenitim beograjskim zgodovinarjem povedal ime in pokazal grob — kamnito razvalino. Pred njimi sem odkril grob našega slavnega velikana — napaka, ki se ne oprostí in ne poravna nikdar.

Beograjski zgodovinarji so me opomnili, da Gjeçovi zasluži tudi spomenik. To je naša dolžnost. Ni mi preostalo drugega, kot da poslušam njihova naročila in v sebi priznam, da zaostajamo.

Dolgo sem brez besed gledal kamnito razvalino. Objokoval sem pozabljenega Gjeçovija, zapuščenega, zaničevanega od nas samih. Počival sem na tistih kamnitih ploščah ves objokan ter se spominjal tudi Rela, ki smo ga prehitro izgubili iz spomina. Ali je tako težko priti do Zadra? Ali nam je Gjeçovi pred hišnim pragom tako daleč? V Zadru imamo tudi grob Josipa Rele. Tam počiva še en človek naše krvi, ena plamenica našega izobraževanja, ki je vse svoje življenje posvetil razširjanju albanske besede. V Zadru je pokopan tudi Naim Ferizi, učitelj prve albanske šole v Djakovici. Bil je resničen partizan demokratske revolucije v Albaniji od leta 1924, privrženec vlade Fan Nolija in soborec Bajrama Currija. Če se bomo kdaj odločili iskati njegov grob, ga nikoli ne bomo našli.

(Povzeto iz Rilindje, 3. VIII. 1967)

Prevedel: H. Berisha

FAIK KONICA

NEKAJ SPOMINOV NA OČETA GJEÇOVIJA

Očeta Gjeçovija sem spoznal preko pisem nekaj let pred balkansko vojno. Leta 1913 sem odšel v Skadar in ga tam v frančiškanski zbornici spoznal tudi osebno. Spoštovanje, ki sem ga do njega čutil že prej, se je še povečalo, ko sva se spoznala. Bil je srednje rasti, suh in črnih oči. Njegov obraz je izražal bistrino in blagost, kar je pri človeku takoj zbudilo zaupanje in ljubezen. Bil je redkobe-seden, toda kadar je govoril, je bilo, kot da ima vedno prav. Njegov govor je dajal vtis posebnega človeka. Dobro je poznal kanon Lekë Dukagjinija in grško-rimsko zgodovino. Kadar se je odločil povedati kaj več, ga je bilo pravi užitek poslušati. Bil je župnik, kar je pomenilo duhovnika ene vasi ali enega okoliša. Živel je v vasi Gomsiqe ob poti Skadar—Orosh.

»Ali bi šli ta teden v goste k očetu Gjeçoviju?« me je nekoč vprašal oče Fishta, s katerim sem se vsak dan videval v Skadru. Povabila sem bil zelo vesel. Nisva izgubljala časa in se brž odpravila na pot. Potovanje od Skadra do Gomsiqe je trajalo s konjem okoli sedem ur. Najbolj čudno in hkrati žalostno je bilo, da ob vsej poti nisva videla nobene hiše razen prenočišča, kjer sva se ustavila, da bi popila kavo. Nikjer drugje ni bilo znakov življenja. Pusti in zapuščeni kraji, kot da bi nanje pozabili ljudje in Bog. A najina žalost je bila poplačana, ko sva prispela v župnišče Gomsiqe. V resnici sta bili tu le dve hiši; ena blizu župnišča, druga pa dve milji dalje. Vas je bila raztresena na vse strani.

Kamnito župnišče, svetlo in čisto, napol prazno, ki pa ga je polnilo in lepšalo veliko srce in nasmejan obraz gostitelja. Videti je bilo gostoljubno in zgrajeno ob mirni reki. Tu je ob molitvi in učenju preživel vse življenje oče Gjeçovi — eden največjih mož, ki jih je imela Albanija. Ponižna svetost, ki je bila sposobna povezati dve nasprotni besedi, neznana duševna svetost, kot da bi bil sin Frančiška Asiškega, v preproščini in čistosti svojega srca je imel sebe za majhnega. Župnikoval je, ljudem svetoval, skrbel za verouk otrok in delil to-

lažbo vsem, ki so jo potrebovali. Svoj prosti čas je posvetil študiju starih običajev med Albanci, kot je kanon Lekë Dukagjinja. Nihče ga ni dosegal pri poznavanju Kanona. Pokazal nama je dva do tri tisoč strani rokopisa študije o znanosti v Albaniji v srednjem veku — znanosti, ki ima svoje korenine v starem veku.

V zgornjem delu župnišča je bila na veliki mizi zložena skrbno izbrana, prekrasna zbirka grško-rimskih starin. Posebno mi je ostala v spominu majhna posoda za solze, imenovana lacrumatorium. Včasih, ko so ljudje jokali za umrlim, so imeli to posodo, da bi imeli kam točiti solze. Nikoli do takrat mi ni prišlo na misel, da bomo čez nekaj let tudi sami potrebovali posodo, v katero bomo točili solze za očetom Gječovijem.

Ponižni brat svetega Frančiška je bil tudi odločen Albanec. Nesebično je delil dobroto, se nikoli ni razjezil, ukvarjal s spletkami in obrekovanjem. Najbolj se je čudil, če so mu rekli, da ni Albanec. Rojen je bil ob meji, kjer se končuje albanščina in začneja drug jezik.

Toda oče Gjeçovi je nasprotoval vsakemu sovraštvu. Ime tega slavnega človeka se bo še povzdignilo in nekoč bo župnija Gomsiqe eden od svetih krajev Albancev.

(Članek je bil objavljen v časopisu Dielli 18. 3. 1930)

Prevedel: H. Berisha



PORTRET I SHQIPTARIT
TË NDERSHEM

AGIM QENA

MUSA JUPOLLI

KOSOVË PROZË E GJATË E NJERIUT

Hej Kosovë je aq e fortë e pathyeshme
Për ty shkruan vargjet më të zjarrta
djemtë, nipat Tu që prekën me gjak cepin
e buzëve tua gjithëherë të kuqe
Zemra flakë e pjellës sate
barutin e armiqve ata e thithën që
bukurinë mos ta prek.
Në duart e tyre të njoma
ra i tërë prushi e në trup Ty Kosovë
nuk e lanë që të djeg.
Vashat tua Kosovë, Arbëria gjithëherë
të zgjuara i gjeti. E ato filluan
t'i këndojnë, se thellë menduan
moss po e lëndojnë të bukurën e dheut.
Trimin në shkëmb guri ngriti plisin
që i kishte rënë në ballë
në tepe të kresë dhe filloi këngën
Për Ty jam gati të vdes ATDHE
Hej Kosovë Tungjatjeta
Tungjatjeta sofra e bujarisë
Bukën kripën për Besën tënde
Kosovë kurrë nuk i kurseve
Kosovë nëna jonë sa bukur
të rri shqiponja në ballë
Hej Kosovë, gjithë ajo furtunë që të përfshiu
asnjëherë gjakun s'e prishe.
Trimëria dhe mençuria jote dhanë shembuj
Kosovë shkëmb graniti, fjalë burri urtësi
Fjalë e parë, fjalë e mbramë e poetit
Kosovë prozë e gjatë e njeriut
Kosovë kështjellë e pëflakur
Edhe fëmija në lindje
tytën e pushkës të nxehtë e gjeti.
Në djep e mbi djep krisma e saj
lëshon jehonë, jehonë e thellë
e mbrojtjes së atdheut
Djalë pas djali në krismë pushke
martesë bëri
Djalë pas djali në flakë lindi
Kurrë i kallur konaku i lindjeve
Konaku i rritjeve,
shtohej gëzimi nëpër flakë
kullë e ndezur
e flakur
kurrë e kallur
Lindi një shqiptar nëpër flakë

*sofra u shtrua, sofrë e guri
gjithëherë të bardhë emrin ia
vunë Atdhetar
Syri yt Kosovë liqë ujë loti
Trupi yt Kosovë Rubin moti
Duart Tua Kosovë farë drithi hedhin
Kosovë, Ti që gatuan bukën e jetës
Kosovë moj hyjneshë
Ke mençurinë ke qëndresën
Kosovë prozë e gjatë e njeriut*

ISMAIL KADARE

VALLJA SHQIPTARE

Tri herë opinga rrahu dheun
Sikur kërkoi leje prej tij.
Pastaj shamia palët ndehu
Me qetësi dhe madhështi.

*Kështu midis qiellit edhe botës
Vallja u lind, vallja u shpall.
Këmba sinjale i çon tokës
Dhe dora qiellit i jep lajm.*

*Dhe vallja rrokulliset tutje
Në kohëra hedhur si hobe,
Prilli përsipër i hedh lule,
Dhjetori borën shkund atje.*

*Valle shqiptare, shenja n'erë.
Ylberë tirqesh tej tëhu.
Kush ju kërcëu ju njëherë
Dhe këmbët rob s'i mbenë te ju.*

*Kush ra midis vorbullës suaj
Dhe s'u përzhit, dhe s'u përflak.
Ju bubullima me opinga,
Që nëpër shekuj bridhni varg.*

NAIM MALOKU

T'I KUJTOJMË VIKTIMAT E DHUNËS NË KOSOVË

(Flet Naim Maloku, kryetar i »Migjenit«)

Miq të dashur, shoqe dhe shokë!

Jemi mbledhur sot nga të gjitha viset e Sllovenisë e të Jugosllavisë, që së bashku t'i kujtojmë të gjithë ata që ranë si viktima të dhunës në Kosovë.

Kur u përulemi dhe vendosim lule për ta, me mendje u falemë varreve të gjithë atyre, të njohurve e të panjohurve, pa dallim kombësie, feje, race e gjinie, botëkuptimi e ideologjie, të gjithë atyre që ranë fli të dhunës që me vite shkretëron pa mëshirë nëpër Kosovë.

Ju ftojme të qëndrojmë disa çaste në nderim të vajzave e djemve të popullit shqiptar që vuajnë burgjeve si të dënuar politikë për shkak të mendimit të tyre të shprehur lirisht.

Le të mendojmë për vuajtjet që për tetë-nëntë vjet me radhë i duruan mbi 500.000 shqiptarë.

Të mendojmë poashtu në qindra shqiptarë që presin në burgje hetuese, që presin proceset e montuara politike, siç është procesi kundër Azem Vllasit dhe të bashkakuzuarve, vetëm e vetëm se janë shoqëtarë e duan të mbetën shqiptarë.

Pjesa dërmuese e proceseve gjyqësore, që zhvilluan dhe i zhvillojnë kundër shqiptarëve, kanë qenë dhe janë procese të montuara politike me qëllim që të bindet opinioni jugosllav dhe botëror se shqiptarët nuk janë njerëz dhe nuk meritojnë lirinë.

Të kujtojmë mjerimin e varfërinë, që ka përfshirë me mijëra familje shqiptare si pasojë e politikës së dhunës mbi shqiptarët. Të mendojmë edhe për fatin e mbi 1 milion shqiptarëve në Maqedoni që nuk mund të shkollohen në gjuhën e tyre amtare, të cilëve nuk u lejojnë që fëmijëve të tyre t'u japin emra shqiptarë e të këndojnë këngët e tyre shqipe.

Pra, të kujtojmë gjendjen e këtillë të popullit shqiptar në prag të shekullit XXI, pasojë e dhunës që ushtrohet mbi ta.

Ljublanë, 2 nëntor 1989

TONE REMC

SPOMNIMO SE ŽRTEV NASILJA NA KOSOVU

ragi prijatelji, tovarišice in tovariši!

DDanes smo se zbrali iz vseh krajev Slovenije in Jugoslavije, da bi se skupaj spomnili vseh, ki so padli kot žrtve nasilja na Kosovu.

Ko se jim poklanjamo in polagamo cvetje, se v mislih poklanjamo pred grobovi vseh tistih, znanih in neznanih, ne glede na narodnost in vero, raso in spol, svetovni nazor in ideologijo, vseh tistih, ki so padli kot žrtve nasilja, ki že leta neusmiljeno pustoši po Kosovu.

Pozivam vas, da v molku prebijemo vsaj pol ure v čast hčera in sinov albanskega naroda, ki se mučijo po zaporih kot politični zaporniki zaradi svojega svobodnega mišljenja.

Pomislimo tudi na stotine Albancev, ki sedijo v preiskovalnih zaporih, ki čakajo na montirane politične procese, kakršen je proces proti Azemu Vllasiju in soobtoženim, samo zato, ker so Albanci in hočejo ostati Albanci.


Velika večina sodobnih procesov, ki so jih vodili in ki jih vodijo proti Albancem, so bili in so montirani politični procesi s ciljem, da bi se prepričalo jugoslovansko in svetovno javno mnenje, da Albanci niso vredni biti ljudje, in to svobodni ljudje.

Pomislimo danes tudi na bedo in revščino, ki je zajela na tisoče albanskih družin kot posledica politike nasilja proti Albancem.

Pomislimo tudi na usodo več kot milijona Albancev v Makedoniji, ki se ne morejo šolati v svojem materinem jeziku, ki svojim otrokom ne morejo dajati albanskih imen in ne smejo peti albanskih pesmi.

Spomnimo se torej takšnega stanja albanskega ljudstva na pragu 21. stoletja, kot posledice nasilja, ki se izvaja nad njim.

Ljubljana, 2. novembra 1989



LETËR NGA PRISHTINA

PROBLEMET E KOSOVËS NUK MUND TË ZGJIDHEN KURRË ME DHUNË POLICORE

Në një mbledhje të »kryeparëve« të komunistëve të Kosovës u thanë edhe këto fjalë: »Eshtë koha e fundit që t'u japim mundësi të gjithë intelektualëve, po edhe atyre që nuk mendojnë si ne, që haptas dhe publikisht ta thonë këtë.« (mendimin e vet); »Le ta ngritë zërin publikisht secili, le ta thotë se çka dhe si mendon që sa më shpejt të zgjidhen problemet e Kosovës«. (»Rilindja« nr. 10957, 29.IX. 1989, f.5.)

Çudi! A është e mundur vallë, që paria e tashme të ketë pësuar ndonjë shndërrim kaq të madh kah demokratizimi?! Këta burokratë me përvojë policore, të cilët për njerëzit nga rrethi i vet i drejtpërdrejtë, që mendonin ndryshe, i kanë hapur dyert e burgjeve, të izolimeve e të torturave të tjera, këta të »plotfuqishëm«, që e shtëmgojnë fort shkopin e diferencimit dhe i kanë mënjanuar e i mënjanojnë pa ndërprerë të gjithë ata që mendojnë ndryshe e nuk veprojnë sipas »kanuneve« të tyre, a munden vallë, vërtet, të lejojnë që të zhvillohet dialogu intelektual demokratik që të zgjidhen problemet e Kosovës?! Askush, që ka një fije mend në kokë, nuk mund të besojë se burokracia politike kosovare, që ka dalë nga vorbulla e mitingjeve njënacionale, që e ka pranuar urrejtjen shoveniste si parim të filozofisë së vet politike, që rrin »gatitu« natë e ditë për t'i zbatuar urdhërat nga udhëheqja e Serbisë për t'i realizuar normat e Kushtetutës së miratur me tanke - në gjendje të jashtëzakonshme, mund të ketë arritur deri në atë derë sa të pranojë mendimet, të cilat nuk përputhen me logjikën e saj të »përmirësimit dhe riedukimit të popullit«, i cili në mënyrë plebishitare e ka mohuar këtë udhëheqje të imponuar në manifestimet paqësore të nëntorit të vitit 1988 dhe në grevën e përgjithshme të shkurtit, të vitit 1989. Nuk është e arsyeshme të besohet se ata që i mbajnë ende në burgje me qindra e mijëra njerëz, të cilët nuk kanë bërë asnjë faj, pra, nuk kanë përdorë kurrfarë dhune, por vetëm kanë shfaqur mospajtimin e vet me politikën zyrtare, vërtet dëshirojnë dialog të barabartë, demokratik, me inteligjencien ose me popullin dhe se në mënyrë të urtë demokratike dëshirojnë t'i zgjidhin të gjitha problemet e Kosovës.

Pra, duhet të përsëritet edhe një herë: *krejt kjo është e pabesueshme*. Mirëpo, edhe këtu, në këtë »apel« të burokracisë politike kosovare, të vënë në shërbim të fortë mobil të Republikës së Fortë Unike, ka një të vërtetë. Kjo »parësi« ka mbetur krejt e tfillakuar, e papërfillur dhe e përbuzur, nga masat e gjera popullore, prandaj ka nevojë shumë të madhe për përkrahje, në radhë të parë, nga inteligjencia e mirëfilltë, e cila gëzon autoritet dhe çmohet me të drejtë nga populli. Kjo thirrje për bashkëpunim, nga ana tjetër, nuk është e paplanifikuar mirë, sepse në kushtet e sotme kosovare pjesa më e madhe e inteligjencisë humaniste është kategori shoqërore, që mund të detyrohet, »të bindet«, e të lëshojë pe, madje diskut edhe të nënshtrohet plotësisht. Ajo, ç'është e vërteta, nuk ka zgjidhje të tjera, sepse po të veprojnë ndryshe, po të kundërshtojë (qoftë edhe duke heshtur) e rrezikon ekzistencën e vet minimale, mbetet e

papunë, thjesht gjuhet në rrugë dhe nuk ka me çka të jetojë.

Eshtë e kuptueshme se intelektualët në shërbim të politikës së sotme do t'ia lehtësonin shumë punën burokracisë politike për t'u konsoliduar mirë në pushtet në gjendje të jashtëzakonshme për ta bërë të vazhdueshme këtë gjendje në Kosovë edhe në kohën kur ajo formalisht do të pezullohet. Disa intelektualë karrieristë që nga fillimi janë vënë në shërbim të politikës së »*revolucionit anti-burokratik*«, sepse ata janë të gatshëm që, në çdo kohë dhe në të gjitha kushtet, të vihen në shërbim të çfarëdo politike. Disa të tjerë, me kualitetet e veta morale që i posedojnë, mund të dalin në sipërfaqe vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme. Mirëpo, të gjithë këta janë fort pak, e madje janë edhe të deplasuar plotësisht, dhe kurrëqysh nuk mjaftojnë për të dëshmuar se inlegjencia shqiptare e përkrah politikën e sotme. Prandaj, duhet të thuhet shkoqur se thirrja e »*kryekomandës*« së komunistëve të Kosovës për dialog me intellegjencinë, nuk është gjë tjetër pos grep, karrem, për intelektualët shqiptarë. Ajo ka domethënie: »*Eni me ne, mendoni si ne, punoni për ne, që ne ta forcojmë pushtetin tonë!*«

Eshtë çështje e intelektualëve shqiptarë se si do ta kuptojnë këtë »*apel*« dhe çfarë qëndrimi do të mbajnë ndaj burokracisë politike, sepse askush nuk mund t'ia lejojë vetes të drejtën që të flasë në emër të intellegjencisë shqiptare të Kosovës. Mirëpo, unë si individ, që kam vendosur të flas haptas e pa dorëza, pa asnjë paragjykim se mendimet e mija dot'i pëlqejnë, jo vetëm ata që mendojnë ndryshe, por edhe disa të tjerë që heshtin dhe në këtë mënyrë e presin »*kthjellimin e motit*« e pastaj sipas motit ta kthejnë gëzofin, siç thotë populli, do ta them atë që mendoj, pa marrë parasysh se jam plotësisht i vetëdijshëm se sot, jo vetëm në Kosovë, por as përgjithësisht në Jugosllavi, *nuk janë krijuar as kushtet minimale për dialog konstruktiv demokratik për çështje të Kosovës dhe të shqiptarëve*. Do të kalojë me siguri edhe shumë kohë derisa të krijohen kushtet për një dialog të këtillë. Por, megjithatë, edhe unë, si shumë intelektualë shqiptarë të Kosovës, nuk mund ta humb besimin se do të vijë koha kur do të jetë e domosdoshme që çështja e shqiptarëve dhe e Kosovës të diskutohet në mënyrë demokratike të barabartë, me urti e gjakftohtësi të duhur, duke respektuar arsyen dhe logjikën e argumentimit të të gjitha palëve, për të mirën e përgjithshme. Uroj që kjo ditë të vijë sa më shpejt në mënyrë krejt të natyrshe, pa asnjë të keqe për njerëzit dhe popujt e këtij vendi!

Për zgjidhjen e problemeve të Kosovës, është krejt e kuptueshme, duhet të bëhet një punë e madhe për t'i mbyllur të gjitha hendeqet e thella të ndasive, që janë krijuar deri me tash me fajet e pafalshme të pushtetmmajtësve. Së pari duhet të sqarohet njëherë e përgjithmonë statusi i shqiptarëve në Jugosllavi, të thuhet me gjuhë të qartë e të kuptueshme për të gjithë: *Çka paraqesin ata në këtë shtet federativ?* A janë shqiptarët, vërtet, *pakicë kombëtare*, kur dihet se përbëjnë popullsinë e tretë në Jugosllavi (pas serbëve dhe kroatëve) dhe janë gati sa popullsia e vendit të tyre amë? A janë shqiptarët subjekt i pavarur politik e juridik në këtë shtet dhe a mund ta shprehin lirisht vullnetin e tyre si popujt e tjerë, që e përbëjnë federatën jugosllave? Apo, ndoshta, e drejta e popullit si subjekt juridik e politik, e pranuar edhe me të gjitha normat e së drejtës ndërkombëtare, mund të jetë e ndryshueshme dhe herë mund të pranohet e herë të mohohet?!

Siç dihet, praktika e deritashme ishte e ndryshueshme. Gjatë LNÇ-së Kosova ishte njësi federale e njëjtë dhe e barabartë me të gjitha simotrat e tjera në Jugosllavi. Këtu veproi organi më i lartë i pushtetit popullor, KAÇK i Kosovës

e Rrafshit të Dukagjinit, si shprehje e vullnetit të popullit të kësaj krahine, ku shqiptarët si popull autokton në këto troje, që nga mesjeta e vazdimisht deri sot, përbëjnë shumicën absolute. Pushteti popullor, i organizuar gjatë LNÇ-së, nëpërmjet organit të vet më të lartë, kodifikoi të drejtat e veta si subjekt i pavarur juridik e politik, si shprehje e vullnetit të popullit, që vet të vendosë për fatin e tij dhe këto të drejta nuk i mohoi askush gjatë luftës. Pra, *Konferenca e Bujanit* që tash në mënyrë të paskrupullt antihistorike sulmohet e mohohet, për Kosovën dhe shqiptarët ka rëndësi të barabartë me KAÇKJ-në për Jugosllavinë dhe, në thelb, me asgjë nuk i bie ndeshë vendimeve të organit më të lartë të pushtetit në Jugosllavinë e Re për të drejtën e popujve për vetëvendosje. Tekefundit, askush nuk mund të mohojë të vërtetën, se në bazë të kësaj të drejte për vetëvendosje organi më i lartë i pushtetit të Kosovës vendosi në Prizren më 1945 që kjo krahinë t'i bashkohet Serbisë federale dhe Jugosllavisë së Re. Dihet fare mirë se ky vendim është marrë në rrethana të jashtëzakonshme të pushtetit ushtarak, që u zbatua në Kosovë pas çrregullimeve, të cilat ndodhën për shkak të ndërhyrjes së njërive ushtarake nga Serbia e Mali i Zi për ta »pastruar« terrenin dhe gabimeve të rënda që u bënë gjatë mobilizimit të shqiptarëve për t'i angazhuar në frontet e luftës në thellësi të Jugosllavisë, për të cilat është folur edhe në Kongresin Themelues të PK të Serbisë qysh më 1945. Prandaj, duhet të thuhet haptas se Kosovës qysh atëherë, pra, *në kushtet e administrimit ushtarak, iu imponua me forcë statusi i saj si Rajon Autonom i Serbisë*. Që nga kjo kohë shqiptarëve në Jugosllavi iu shkon prapa si hije e zezë etiketa e *kundërrevolucionit*. Kjo etiketë, që tash u është qepur fort pas shpinës për të katërtën herë, ishte moto e të gjitha veprimeve të burokracisë politiko-police kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë gjithë periudhës së Pasluftës deri në *Plenumin e Brioneve* (1966).

Gabimet e rënda ndaj shqiptarëve në Jugosllavi u korigjuan vetëm pjesërisht pas këtij plenumi, që atëherë është quajtur *Çlirim i dytë i shqiptarëve dhe i Kosovës* dhe pas aprovimit të Kushtetutës së vitit 1974 kjo krahinë u bë përsëri subjekt juridik e politik në federatën jugosllave me shkallë të caktuar të autonomitetit. Në këtë mënyrë u siguruan parakushtet që edhe kombësia shqiptare të marrë rrugën e emancipimit të përgjithshëm shoqëror, kulturor e kombëtar për t'u bërë e barabartë me popujt e tjerë të federatës jugosllave, sado që në Serbi kurrë nuk pushuan përpjekjet për t'i penguar këto procese. (Mjafton të përmendet vetëm »*Libri i kaltër*«).

Dhe ja, pas vdekjes së Titos, në kohën kur kishte filluar të thellohej kriza jugosllave, na doli në shesh përsëri *hija e zezë* (!?). Ky popull, me gjasë, është i gjykuar të jetë gjithnjë bartës i kësaj *kuçedre*, sepse, siç kanë pohuar sa e sa herë shumë shkencëtarë serbo-malazias me tituj të lartë akademikë, *kundërrevolucionin në Kosovë na i paska rrënjët që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit* (1878-81), pra, rrafsh gjashtëdhjetë vjet para fillimit të Revolucionit Popullor!? Pra, doli prapë në shesh *kundërrevolucionin*, i cili pritej duarhapur nga Beogradi, sepse siç ka deklaruar udhëheqësi i atëhershëm i Serbisë, I. Stamboliq, *në Beograd ishin mobilizuar forcat policore para së të fillonin demonstratat e para të studentëve në Prishtinë* me kërkesa thjesht sociale për përmirësimin e ushqimit të mensës, më 11 mars 1981. Siç dihet, më 25 mars demonstratat e studentëve u përsëritën dhe policia intervenoi në mënyrën më brutale duke i rrahur studentët edhe brenda në konvikte. Dhe kështu *zjarri i ndezur*, të cilit i fryhej nga të gjitha anët, shpërtheu si *rrevoltë gjithëpopullore* me demonstratat e prillit 1981, që sollën si pasojë gjendjen e jashtëzakonshme me orë policore e të tjera. Krejt kjo sipas *skenarit të përgatitur më parë* u quajt sa për fillim vetëm »*tentim i*

kundërrevolucionit«, sepse kjo *amblemë kobëzezë* duhej t'i ngjitej Kosovës për ta rikthyer gjendjen në atë kohë, kur policia ishte forcë politike me të cilën mbahej pushteti, pra në kohën e Rankoviqit. Eshtë e kuptueshme se kjo nuk mund të bëhej përmjetherë, sepse duhej mënjanuar barrierat që ishin krijuar gjatë viteve kur *Kosova kishte funksionuar si autonomi*, pra si *subjekt politik e juridik* në Federatën jugosllave - duhej mënjanuar *Kushtetuta e vitit 1974*. Kështu, që nga viti 1981 në mënyrë të sinkronizuar u sulmua çdo gjë që ishte bërë për realizimin e barazisë kombëtarë të shqiptarëve me të tjerët, *ishte bërë për t'i shërbyer kundërrevolucionit?!*

Njeriut i rrënqethet mishi në trup kur ndalet dhe rikujton krejt atë që është shkruar e thënë për shqiptarët gjatë këtyre tetë vjetëve. Nuk ka mbetur asgjë pa u mohuar e përbuzur, që nga gjeneza e këtij populli e deri te gjërat më intime e subtile të njeriut, siç është akti i lindjes së fëmijëve. Për këtë qëllim nuk ka mbetur pa u përdorur *asnjë shprehje e zezë diskualifikuese nga fjalori politik*, por nuk është kursyer asgjë edhe nga ai etik. Kështu, shqiptarët janë shpallur *dhunues seksualë*, edhe pse zyrtarët e Kosovës me kot kanë dëshmuar se statistikat thonë se kjo krahinë është e fundit për kah numri i dhunimeve. Ata janë shpallur *fantazma* që natën i shkatërrojnë varrezat ortodokse, edhe pse në shumicën e rasteve nuk janë zbuluar aktorët e këtyre punëve të liga e, madje, ka pasur edhe raste kur vetë serbët i kanë bërë këto poshtërsi. Shqiptarët *kanë bërë gjenocid*, i kanë shpërngulur serbo-malaziasit me dhunë, edhe pse dihet fare mirë se të shpërngulurit pa kurrfare presioni, pos për hesape të veta, i kanë shitur tokat dhe pronat e tyre për para të majme dhe me gjysmën e atyre parave kanë blerë prona trefish më të mëdha në Serbi, ose »villa« në brigjet e Adriatikut, kurse gjysmën tjetër e kursejnë, duke bërë qejfe nga kamatat që i marrin.

Dhe shqiptarët i kanë duruar të gjitha akuzat e paqena dhe krejt përbuzjen. Zyrtarët e kësaj krahine pas vitit 1981 kanë bërë çmos për t'ua bërë qejfin, për t'ua plotësuar çdo kërkesë serbo-malaziasve: duke ndërtuar fabrika vetëm për ta, duke i pranuar në punë pa konkurs, duke hapur paralele të mësimit vetëm edhe me një e dy nxënës, duke ua lëshuar postet udhëheqëse sipas dëshirës së tyre, duke krijuar komuna në ato territore ku kjo popullsi ka qenë më homogjene, duke ua ruajtur pronat e shtëpitë e, madje, edhe varrezat, që vetë i kanë lënë në mëshirën e kohës. Çdo gjë bëri udhëheqja e Kosovës me në krye të gjorin A. Vllasi, që tash do të dënohet si kundërrevolucionar (?!), për t'iu përshtatur serbo-malaziasve të Kosovës, të cilët kurrë në Jugosllavi nuk kanë qenë të pabarabartë me shqiptarët, por, përkundrazi, gjithnjë të privilegjuar, që t'i mbajë të mos shpërngulen edhe të rikthen, mu në kohën kur me qindra e mijëra shqiptarë, për të cilët nuk kujdeset askush, shpërnguleshin, jo vetëm brenda Jugosllavisë, por në të gjitha anët e botës prej Amerikës e deri në Australi. Mirëpo, krejt kjo ishte e kotë, sepse udhëheqja e Serbisë, në të vërtetë nuk brengosej fort për serbo-malaziasit e Kosovës, të cilëve ua prishte punët me fqinjët e tyre shekullorë, me të cilët e kishin ndarë të mirën e të keqen gjatë historisë. Ajo donte shumë më tepër, *donte që Kosova të bëhej Serbi*, ashtu siç mendohet se ka qenë gjatë mesjetës, pra, *ajo donte që Serbisë t'i kthehej »shpirti«*. E për t'ua bërë kjo, *Kosova duhej të fajësohej e të gjykohej edhe më tutje*, derisa të krijoheshin kushtet që *asaj t'i rrëmbehej autonomia*. Prandaj, krahas *propagandës së paparë për të nxirë çdo gjë shqiptare*, në Kosovë punuan natë e ditë 600 misionarë aktivistë zyrtarë (siç ka shkruar shtypi) dhe ku ta dijmë edhe sa të tjerë në vija të fshehta kishtarë e policore (të policëve të Rankoviqit) dhe formuan *organe paralele me pushtetin zyrtar* për t'i mobil-

izuar serbo-malaziasit për *mitingjet tanimë shumë të njohura*, nën presionin e të cilëve punoi KQ i LKJ-së, që nga mbledhja e nëntë, u përmbys pushteti legalë në Mal të Zi e në Vojvodinë, u vu gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë etj.

Dhe shqiptarët e Kosovës i duruan me gjakftohtësi *mitingjet* plot thirje për armë e vrasje. Ata i duruan *mitingjet*, të cilave u vinte era gjak! Ata folën qetë e me urti për ndërrimet e Kushtetutës dhe, kur u binden se do të rrezikoheshin të drejtat e tyre, kur e panë se udhëheqjet jugosllave, për ta ruajtur qetësinë e vet, i lenin pa përkrahje, u ngriten të gjithë si një dhe në *Manifestimet Nëntorit* i treguan Jugosllavisë dhe botës se ata janë për barazi, për vëllazërim e bashkim, për Jugosllavinë e AVNOJ-it e të Titos, se duan ta ruajnë autonominë e tyre. Në këto manifestime që janë të pashembullta në këto troje, shqiptarët nuk këputën as një filizë a lule, nuk tremben asnjë zog, nuk fyen askend. Mirëpo, prape u quajtën *kundërrevolucionarë?! Ata u quajtën kundërrevolucionarë më 1981 kur kërkuan Republikë. Ata prapë u quajtën kundërrevolucionarë, kur u ngritën që ta mbrojnë autonominë, ta mbrojnë Kushtetutën e vitit 1974 që është ende në fuqi. Pra, ky është kundërrevolucioni në Kosovë!? Populli kësaj i thotë: »Hyp se të vrava, zbrit se të vrava!« Pra, kjo është pozita e shqiptarëve sot, të cilët janë të gjykuar të quhen kundërrevolucionarë gjithnjë, ose të nënshtrohen dhe ta pranojnë pozitën që e kanë pasur dikur në Jugosllavinë e Vjetër, ditën e formimit të së cilës, si duket, së shpejti do ta kemi edhe festë zyrtare!?*

Në vend të dialogut demokratik me shqiptarët, që në manifestimet e nëntorit shprehen botërisht përcaktimin që të jetojnë të barabarte në Jugosllavinë e Titos, për ruajtjen e pozitës që ua garantonte Kushtetuta në fuqi, udhëheqja e Serbisë u përcaktua për dhunë, prandaj në kreun e pushtetit politik (partiak) e inuagurori *kryepolicin* Morina me bashkëmendimtarët e tij. Kësaj dhune të paralajmëruar populli iu përgjegj në mënyrë dinjitoze me *Grevën e përgjithshme* në krye të së cilës ishin minatorët e Trepçës, që janë bërë *simbol i mbrotjes së autonomisë së Kosovës* dhe, siç është konstatuar me të drejtë edhe në Cankarjev Dom, *simbol i mbrotjes së Jugosllavisë se KAÇKJ-së*. Në momentin kur Morina me shokë, megjithatë, u gjuhëzua para kërkesave të masave popullore shqiptare dhe dha dorëheqjen e kërkuar, udhëheqja serbe thjesht e detyroi që ta tërheqë atë, të rikthehet aty ku ishte caktuar. Për këtë u përdor metoda tanimë e sprovuar në Novi Sad, në Titograd dhe e ushtruar në Ushqë, *mitingu kërcnues* me të cilin u gjuhëzua edhe udhëheqja e shtetit, e paaftë dhe e paautoritet, dhe u detyrua ta shpallë *gjendjen e jashtëzakonshme*. Dhe pastaj dihet se çka ndodhi: Kushtetuta u ndërrua me dhunë e me gjak - Kosova më nuk e ka autonominë që e kishte, por dita me ditë po bëhet *rajon i Serbisë - krahinë jugore serbe*; udhëheqja e imponuar kosovare dita me ditë po plotësohet me *»mitingaxhi«* dhe me *»shqiptarë të ndershëm«* dhe përgatitet të rizgjidhet përsëri, pasi që me burgje, izolime dhe me shkopin e diferencimit i ka mënjuar të gjithë ata që mendojnë ndryshe dhe nuk i binden diktatit të saj. Dhe kjo *biçim udhëheqje* tani na dalka me faqe të bardhë dhe e paska parë të udhës që t'i thërrasë intelektualët e, madje, *edhe ata që mendojnë ndryshe, që ta ngrisin zërin e të thonë se si do të zgjidhen sa më shpejt problemet e Kosovës?! Meqë vetë e keni kërkuar, po jua them shkurt e trup: Problemet e Kosovës nuk mund të zgjidhen kurrën e kurrës me dhunë policore, që është mjete kryesor i pushtetit tuaj! Që nga viti 1981 Kosova ka marrë shumë plagë të rënda, të cilat mund të shërohen me kujdes shumë të madh, pas një mjekimi të gjatë intensiv. Parakushtet për mjekimin e suksesshëm të këtyre plagëve janë:*

1. Të hiqet menjëherë *gjendja e jashtëzakonshme* dhe të anulohen të gjitha vendi-

met që janë marrë në këtë gjendje, duke përfshirë edhe ndërrimet e Kushtetutës;

2. Të sqarohet mirë, njëherë e përgjithmonë, çështja e *kundërrevolucionit*, sepse kuptimi i tij, siç ka dëshmuar jo vetëm teoria shkencore, por edhe praktika e vendeve socialiste, është *krejtësisht i tejdukshëm*. *Kundërrevolucioni* tek popujt, të cilët kurrë nuk e kanë pasur pushtetin e vet të pavarur politik e shtetëror, është absurditet specifik i pashembullt në botën tonë, produkt i një politike të verbuar makiaveliste;

3. Brenda reformës së sistemit politik, për të cilën po diskutohet kaq shumë në Jugosllavi, të sigurohen të gjitha kushtet që edhe populli shqiptar ta shprehë lirisht vullnetin e vet, që Kosova pa kurrfarë tutorie *ta hartojë vetë Kushtetutën e vet*, kuptohet në bazë të parimeve të KAÇKJ-se, dhe kështu shqiptarët të bëhen subjekt i barabartë me të gjithë popujt që e përbëjnë federatën jugosllave.

Pra, pa plotësimine këtyre parakushteve *plagët e Kosovës* nuk mund të shërohen, por infeksioni i tyre vetëm mund të përhapet edhe më shumë, e dëmet nga kjo janë të paparashikueshme, prandaj forcat parparimtare demokratike në radhë të parë, ato të popullit serb, e pastaj edhe të mbarë Jugosllavisë, nuk duhet të lejojnë që të hyjmë në *shekullin e ri* pa e shëruar këtë sëmundje.

»S«

SHKËLZEN MALIQI

KRIZA DHE DEMOKRATIZIMI

Nocioni demokratizim, që gjithnjë e më shpesh po përdoret në publicistikën tonë, paraqet një lloj hibridi pragmatik, i cili shërben si parullë e të gjithë atyre që besojnë se ky nocion e fsheh formulën shpëtimtare për dalje nga kriza e sotme e thellë e shoqërisë jugosllave. Me fjalë tjera, demokratizimi i Jugosllavisë konsiderohet si parakusht themelor për përballimin e krizës. S'do mend se caku këtu është i qëlluar mirë: demokratizimi është e vetmja rrugë për krijimin institucional të rendit demokratik në Jugosllavi, dhe me këtë krijohen kushtet për mposhtjen e atyre aspekteve esenciale të krizës, të cilat e kanë shkaktuar blokadën e sotme të sistemit. Por, shtrohet pyetja: a është i mundur qysh tani instrumentalizimi i qëllimit, i cili ende nuk është arritur dhe nuk ka mbështetje insitucionale (demokracia), dhe a mund të shfrytëzohet si mjet i vetarritjes? Ata që po shërbehen me parullën e demokratizimit, në të vërtetë, nisen nga supozimi se në Jugosllavi ka institute e potenciale të konsiderueshme demokratike, të cilat mund të shfrytëzohen si mjete për të ecur kah realizimi i qëllimit përfundimtar — demokracisë së plotë. A kanë te drejtë ata? A është rruga për demokraci në Jugosllavi e trasuar nëpërmjet instrumenteve të demokratizimit që i kemi në disponim? Disa procese në Jugosllavi sikur i japin të drejtë mbrojtësve të kësaj teze. Në disa segmente të jetës shoqërore përnjëmend ekzistojnë elemente të demokratizimit. Populli në këtë apo në atë mënyrë e ka tejkaluar depresionin e tij të mëparshëm politik dhe ka dalë në skenën politike, liria e mendimit dhe e paraqitjes publike gjithnjë e më shumë po bëhet e pakufizuar, liria e bashkimit politik e partiak është në prak nëse jo të legalizimit të plotë atëherë të tolerimit të heshtur, në zhvillim e sipër është edhe procesi i rishqyrtimeve qenësore të sistemit shoqëror dhe të atij ekonomik, i cili ka gjasa

të përfundojë me rikonstruimin demokratik të sistemit.

Duke mos i nënçmuar aspak këto procese të demokratizimit, megjithatë jam i prirur për një vlerësim më skeptik të gjendjes dhe të instrumententeve që i kemi në disponim për të realizuar qëllimin: demokracinë. Skeptik jam për arsye se këto procese më parë i shikoj si rrjedhojë të shkatërrimit gradual dhe të shkoklimit të brendshëm të një sistemi sesa si shprehje të fuqisë së idesë së rendit të ri, i cili ka lëshuar rrënjë në trollin tonë dhe me aplikimin e lirive, tashmë të përfituara demokratike, paralajmëron një rritje organike drejt demokracisë së plotë. Me fjalë të tjera, demokratizimin e tashëm e shoh më parë si shprehje të dobësisë së sistemit, i cili ende nuk e ka përjetuar kulmin e krizës së tij sesa si shprehje e fuqisë të një rendi që po krijohet dhe i cili do të mund të na kursente nga përvoja e falimentimit të plotë të sistemit, me të gjitha ato pasoja të tmerrshme që edhe sot mund të parashihen, por jo edhe krejtësisht të evitohen. Ne jemi në anijen e cila ngadalë po fundoset, ndërsa demokratizimi i tashëm më shumë i ngjanë përgatitjes së barkave të shpëtimit, derisa »pronarët« dhe drejtuesit bëjnë përpjekje të fundit për ta bërë remontin e saj, duke mos nguruar edhe nga përdorimi i mjeteve të mobilizimit të dhunshëm, në mënyrë që edhe pak ta shtyjnë fundin e sundimit të tyre.

Besimi që disa e shprehin, kuptohet nga qëllimet më të mira dhe nga arsyet e kuptueshme pragmatike, ndaj shenjave të demokratizimit të jetës politike, lidhet ngusht me nënçmimin e forces së oligarkisë që e ka pushtetin dhe e cila aspak nuk interesohet për demokraci, që është »kanakarja« e sistemit, që e ka aparatin administrativ, ushtarak e policor në duart e veta dhe ka në dispozicion makinërinë e fuqishme propaganduese, e cila ia siguron trenaferin e legjitimitetit të pushtetit dhe manipulimin me interesat kolektive të masave. Nga ana tjetër, është më se e vërtetë se demokratizimi nuk u arrit përmes ndërmarrjes së organizuar dhe nga aspekti programor dhe strategjik mirë të mbështetur të forcave demokratike, por është stihik dhe, në të vërtetë, »i falur« nga regjimi që po e ndërton strukturën autokratike e kanalet e liberalizimit dhe të demokratizimit të kushtëzuar po i shfrytëzon për qëllimet e veta, si një prej mjeteve të luftës për zënien e fronit të boshatisur autokratik.

Instrumentalizimi i demokratizimit për qëllime jodemokratike më së miri u tregua në Serbi, ku shtypi në vitet e tetëdhjeta se pari u lirua nga shumica e tabuve dhe kufizimeve të mëparshme, por më vonë u shndërrua në një organ direktiv i oligarkisë së re. Në mjediset tjera ndodh pakashumë e njëjta gjë, por diku në format paksa më subtile. Përynjatim bën deri diku Sllovenia, ku forcat demokratike kanë arritur një masë kritike të autonomisë kur mund të shtrohen kushtet për një ujdi shoqërore të re demokratike. Por, me që demokratizimi në Slloveni në përmasat jugosllave ka mbetur oazë, dhe me që Jugosllavia si tërësi nuk mund ta përcjellë këtë shembull dhe, për më tepër, tregon më shumë mosdurim sesa mirëkuptim, forcat demokratike në Slloveni gjithnjë e më shumë po u kthehen ideve separate e »asimetrike« të rregullimit të gjendjes në shtëpi të vet, ndërsa Jugosllavia po u bëhet ankth, kanosje dhe pengesë.

Fati i demokratizimit slloven është simptomatik për tezën të cilën po e mbroj këtu. Ky demokratizim nuk është vetvetiu dhe për nga përmbajtja organike e saj separatiste, po ky »separatizëm« është shprehje e asimetrisë esenciale të shoqërisë jugosllave, të potencialeve të ndryshme demokratike në njësitë e ndryshme federale dhe në regjionet e ndryshme. Shoqëria sllovene sipas strukturës së saj dallon nga regjionet tjera dhe, të them ashtu, është më e pjekur për aprovimin e formës moderne të demokracisë politike të tipit parlamentar, derisa në mjediset tjera ky model me pak ka mundësi të pranohet për shkak të

karakterit tranzitiv të strukturës sociale të tyre, me shtresat dominuese të rikomponuara që preferojnë format autoritare të pushtetit dhe që janë jotolerante ndaj shfaqjeve të interesave të ndryshme dhe autonome.

Kriza jugosllave në esencë është krizë e »jonjëkohësisë« së zhvillimit të njësive federale dhe të regjioneve, e njekohësisht edhe të falimentimit të politikës së nivelimit artificial të këtyre »jonjëkohësive« në një model të obliguar për të gjithë. Partia Komuniste e cila pas revolucionit ka marrë detyrë të rëndë që shoqërinë jugosllave ta transformojë prej një shoqërie të pazhvilluar në atë të zhvilluar, edhe pse synonte monolitizmin ideologjik dhe solidaritetin, dhe institucionet kyçe të sistemit i ka nënshtruar këtij monolitizmi së pari nëpërmjet sigurimit të monopolit ndaj pushteti shtetëror ^ashteti partiak^o, edhe vetë gjatë kësaj kohe u bë viktimë e »jonjëkohësisë« së interesave brenda vendit. E detyruar që, për shkak të mbrojtjes së monopolit të institucionalizojë decentralizimin në vend të demokratizimit, ajo në vitet e shtatëdhjeta faktikisht e ka legalizuar depërtimin e »jonjëkohësisë« në shtetet partiake dhe ka përgatitur rrënimin e brendshëm në vitet e tetëdhjeta, si dhe transformimin e themelit legjitimues të pushtetit të këtyre shteteve partiake në reprezentium të interesave të ndryshme nacionale. Me këtë »jonjëkohësia« ka shpërthyer në skenën politike fuqishëm dhe në mënyrë më të egër, si kacafytje nacionale nën mbrojtjen e sovraniteteve shtetërore. Te kjo edhe vetë proceset e demokratizimit morën parashenjat nacionale e bartësit e tyre nisën të denoncohen mes veti para instancës të interesit më të lartë, apo pushtetit më të lartë, ku secili e shtynte popullin e vet si sovran. Nevoja e inhibuar e shoqërisë jugosllave për demokratizim, sidomos në kushtet kur shteti partiak vendin e solli në krizë ekonomike të pashtegdalje, u shndërrua në surogat të pluralizmit e të gjitha shtresat të cilat dolën në skenën politike, në pionat e oligarkive nacionale.

Në krizën aktuale lëkundjet tektonike e pamundësojnë mobilizimin efektiv të forcave demokratike. Proceset e demokratizimit nuk mund të përcjellin stuhinë e kahjes kryesore të krizës e cila e suspendon çdo inidativë demokratike. Një fuqi ciklonike tregon sidomos kriza ekonomike, e cila nuk mund të zgjidhet me instrumentet e sistemit të tashëm, në kushtet kur krejtësisht mungon edhe vullneti i instancave kompetente që bile për një kohë të ndërpritet lufta për pushtet dhe konfrontimi i pamëshirshëm propagandistik. Përkundrazi, kriza ekonomike po shfrytëzohet si poligon kryesor i luftës për pushtet, me gjithë rrezikun e tmerrshëm që e sjell varfërimi i përgjithshëm i popullatës dhe ndjenja e përgjithshme e humbjes së çdo perspektive dhe shprese. Pasiguria ekzistenciale i shkon për shtati mobilizimit emocional te masava, homogjenizimeve nacionale në baza iracionale, krijimit të psikozës së paralufte, shpërthimit të pasioneve, gufimit të llojeve të reja të utopizmit, kurorëzimeve të prijsëve karizmatik brenda natës etj. Në një atmosferë tashmë të krijuar të tillë për Jugosllavinë do të mund të thoshim se më parë gjendet pranë humnerës së shkatërrimit sesa para daljes graduale nga kriza përmes forcimit të instrumenteve të demokratizimit.

Kuptohet se është vështirë të parashikohet se si dhe kur do të shpërthejnë pasionet dhe çfarë permasa do të marrin konfliktet. Por, megjithatë, një gjë është më se sigurt: gjithnjë e më shumë do të ketë greva të punëtorëve dhe mitingje nacionale me kërkesa ultimative, dhe me këto do të hapet problemi kyç i kohës sipas të cilit nuk do të jetë më me rëndësi se a do të bjerë kjo apo ajo qeveri, dhe ky apo ai program gjysmak për sanimin e gjendjes, por si do të mbrohet pushteti i tashëm si i tillë dhe si e me çfarë mjete do të evitohet lufta qytetare që po kanoset, apo shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në disa

vise ose edhe në tërë Jugosllavinë, krahas asaj që tashmë është shpallur në Kosovë.

Shembulli i Kosovës më së miri e ilustron vonesën dhe impotencën e forcave demokratike para stuhisë ngarendëse të krizës, gjegjësisht të procesit të rrënimit të sistemit të shtetit partiak. A ka qenë e mundur të shpëtohet Kosova? Unë do të thosha se jo. Pse jo? Për arsye se Kosova në të vërtetë paraqitet si rast paradigmatic i krizës globale jugosllave, në të cilin si në pasqyrë shihet kursi i saj. Dhe perfundimi, gjithashtu. Ngjarjet e 1981—shit në Kosovë në një mënyrë të *pervertuar* të përzierjes së kërkesave sociale e nacionale të shqiptarëve, paraqitën dhe shtruan problemim esencial të domosdoshmërisë së demokratizimit të brendshëm të Kosovës, por edhe të demokratizimit të Jugosllavisë në përgjithësi. Pushtetëmbajtësit kosovarë dhe ata jugosllavë nuk kanë dashur, e ndoshta as nuk kanë mundur, të shohin përmbajtjen demokratike të rebelimit të shqiptarëve, përkundër faktit se ajo u paraqit në formën e shtrembëruar dhe me inhibicione, duke u lidhur për kërkesën që të pranohet shteti nacional i shqiptarëve në Jugosllavi. Pushtetëmbajtësit më me qejf këtu panë vetëm — »kunderrevolucion«. As forcat demokratike në vend atëbotë nuk e kuptuan porosinë se vetë elementet konsitutive të sistemit shkaktojnë pervertimin global që i suspendon dhe i qet në harresë kërkesat për demokratizim, e në vend të tyre, si surrogat, ofron — shtetet nacionale. Për këtë shkak më vonë në mënyrë zinxhirore dhe me një përzierje eksplozive të njëjtë të kërkesave sociale e nacionale, por edhe në sajë të manipulimit me »kunderrevolucionin« në 'Kosovë, kanë ndodhur edhe Mbledhja e tetë e Serbisë më 1987, edhe tetori i 1988—shit në Novi Sad, edhe janari i 1989—shit në Malin e Zi, por këtyre herave me parashenja ideologjike të »revolucionit antibyrokratik«, sikurse edhe »pranvera sllovene« si kontrapunkt demokratik i kundërthënies në mes të »kunderrevolucionit« dhe »revolucionit antiburokratik«, ku nga njëra anë doli sheshit prapavija real-socialiste e manipulimeve ideologjike me masat në pjesët juglindore të vendit, ndërsa nga ana tjetër, për shkak të bllokadave që u paraqitën rreth çështjes së sovranitetit slloven, edhe në këtë punkt ku demokratizimi kishte përparuar më së shumti e gjithë çështja prapë u mistifikua dhe mori rrugën e gabuar të nxitjes së konflikteve të sovraniteteve ekskluzive nacionale.

Nga i gjithë ky kompleks i çështjeve që këtu vetëm sa u prekën dhe ndërlikueshmëria e së cilave as që ka mundur të përfshihet në një tekst të këtillë skicues, si përfundim kam dashur të nxjerri këtë poentë: demokracia është kërkesë kryesore e kohës, por Jugosllavia nuk është ende e gatshme ta realizojë këtë kërkesë, sepse ndihet mungese e traditës demokratike (natyrisht, jo të asaj të mitizuar, çfarë është p.sh. ajo e demokracisë serbe nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, por të asaj reale), gjeneratat e sotme janë të detyruara të kompenzojnë këtë mungesë edhe përmes »mësimit« negativ, gjegjësisht duke zbuluar vlerat e dialogut, të tolerancës dhe të racionalizimit të interesave politike pas përjetimeve imediate të pasojave të konflikteve, të jotolerancës dhe të iracionalizimit të interesave. Forcat demokratike, e këtu së pari mendoj në Shoqatën e inicijatives demokratike jugosllave, në strategjinë e tyre do të duhej të parashikonin edhe përgatitjen për të ecurit nëpër mundime. Nëse edhe për ne vlenë mendimi i kahmotshëm i Manhajmit se »tendenca demokrtike është fati ynë i parapërcaktuar«, e unë jam i bindur për këtë, atëherë edhe këtë bredhje tona të sotme me këmbëzat e qelqit të demokratizimit, herdokurdo do të duhej të shndërrohen në një lëvizje të fuqishme e cila jo vetëm se di çka kërkon, por ka edhe mjete për të realizuar atë që kërkon.

Prishtinë, tetor 1989

GENC GORANI

E DREJTA E SHPREHJES SE LIRE TE NACIONALES DHE SHTETET TOTALITARE

E drejta e shprehjes së lirë të nacionales është shpallur e drejtë (liri) elementare në deklaratëm e nënshkruar nga të gjitha anëtarët e OKB, ndër të cilat janë edhe shumica e atyre shteteve të njohura si shtete totalitare (autoritare). Të shprehurit nacional në këto shtete është karakteristik nga aspekti i skenarit të zhvillimit të të shprehurit në fjalë.

Shtetet totalitare janë zhvilluar në ato vende në të cilat për bazë të organizimit të përgjithshëm shoqëror është konstituuar diktatura - qoftë ushtarake-policore, qoftë (e quajtur) e proletariatit.

Në mungesë të demokracisë - si fundament i organizimit ekonomik dhe politik të njerëzve - vjen deri te mosfunksionimi natyror i raporteve ekonomike dhe politike në shoqëri në atë masë sa që flitet për krizën. Kriza implikon zgjidhjen e saj, ndërkaq zgjidhja - ndërrimin e sistemit.

Sistemet shoqërore dallohen mes vedi edhe për nga vet kriza e cila zhvillohet në to. Në të vërtetë, krijimi i çdo sistemi shoqëror përmban në thelbin e vet krizën e tij. Shfaqja e krizës është vetëm çështje e kohës, ndërsa zgjidhja fatlume e saj (stabile, evolutive, e ekuilibruar - jo-«revolucionare»), është pasqyrë e vitalitetit të atij sistemi.

Të gjitha sistemet shoqërore janë krijuar nga nevoja e tejkalimit të krizës së organizimit të shoqërisë. Në themelet e tyre (në mënyrë implicite) gjendet skenari i krizës së ardhshme të cilën e gjeneron vet ai sistem. Krizë e cila, po të jetë sistemi progresiv, nuk paraqet përsëritje të krizës së përjetuar.

Çështja e zgjidhjes së një krize mund të venerohet sikur çështje e represivitetit të metodave të cilat »duhet« të zbatohen. Një raport rregullisht përsëritet: represiviteti i metodave të zgjidhjes së krizës është në përpjestim të zhdrejtë me karakterin demokratik të fundamentit ekonomik-politik-juridik të organizimit të një shoqërie. Shembull tipik bashkëkohor do të mund të merrej RP e Kinës.

Ndërkaq, represiviteti në fjalë tregohet të jetë i zbutur në rast të zhvillimit të raporteve demokratike edhe pse jashtinstitucionale (Rep. e Hungarisë). Por, në mungesë të një zhvillimi të tillë, represiviteti arrin kulmet e veta. Ngjarjet aktuale në RSF të Jugosllavisë (duke i përfshirë edhe ato të cilat iu kanë paraprirë) paraqesin një prej shembujve të tillë.

Riorganizmi demokratik i shoqërisë në funksion të tejkalimit të krizës paraqet domosdoshmëri. Ndërkaq, bartësit e sistemit ekonomiko-politik totalitar vihen para dilemës:

humbuje definitive të pushtetit totalitar ose agoni të përgjithshme shkatërruese. Në rastin e dytë - i cili aktualisht ndodh në Jugosllavi, gjegjësisht, në RS të Sërbisë - ashpërsimi i raporteve ndërnacionale *nxitet* nga vet institucionet shtetërore; *nxitet* të shprehurit bastard-primitiv të nacionales ndërsa, nga ana tjetër, veprohet në mënyrë më represive ndaj të shprehurit nacional të popujve numerikisht më të vegjël. E tërë kjo, duke qenë në funksion të rigjenerimit

dhe stërmadhimit të krizës me qëllim të mbajtjes në status quo të nivelit policor-ushtarak, paraqet edhe një tregues se bartësit e këtyre institucioneve veprojnë nga pozitë totalitare duke patur për qëllim final realizimin e pushtetit absolut në funksion të vet pushtetshmërisë.

Ngjarjet në Kosovë dëshmojnë për vendosmërinë fanatike të një pushteti totalitar për të »ikur« nga Demokracia - sinonim i »vdekjes« së tij.

QERIM UJKANI

E KUJT ËSHTË KOSOVA

Sekush erdhi në ty Kosovë

Kosova ime e dashur

Të quajti tokë të vetë

E mua birin tënd që të ledhaton

Me mall dhe dashuri dorën ta shkon

Më quajti ardhacak i pashtëpi

Njeri pa tokë dhe qiell të vet mbi kokë

Mysafir i përkohshëm dhe farë e ligë

Hije drthëritëse në ajër

As në tokë as në qiell

Por në rrugën e gjakut kafkën la kujtim

Se ti s'je e atij që të shkelë

Lavrën tënde me vdekje mbjellë

S'je tokë e gjithkujt dhe e askujt

As tokë pa popull e një popull pa tokë

Ti je dhe kreshnik i bijve besnikë

Që të duan dhe të mbrojnë

Me dashuri t'i mbjellin ugarët

Me flamuj lirie ndër festa

Ti mbulojnë varret

Lule dhe gjyle në dorën e trimit

Je vatër e ngrohtë

E atyre që kurrë s'të lanë vetëm

Me ty qëndruan si shkëmb në erë

Me ty

në jetë dhe vdekje

Në liri dhe dashuri

Dhe nëqoftëse dikush na thotë prapë

Ikni që këtej se kjo s'është tokë juaj

Ne e dimë se ç'do t'u themi

Shkuar për të shkuar ka kush të shkojë

Ne ishëm ne jemi ne do të jemi këtu!

OPERA BALCANICA

V drugi polovici septembra je bilo v Boru srečanje balkanskih pisateljev, z udeležbo predstavnikov pisateljev iz vseh balkanskih držav ter gosti iz Madžarske. Poleg skoraj vsakodnevnih množičnih političnih manifestacij na tem koncu Balkana z odločnimi vojnohujskaškimi parolami smo imeli tako tudi veliko kulturno manifestacijo, ki pa je konkretne mednarodnostne nestrpnosti in antagonizme skušala preseči s premislekom o celovitejši podobi balkanske književnosti in plodnih medsebojnih kulturnih vplivanjih, katerih skupen izvor je ravno antična Grčija, ki naj ne bi bila več samo zibelka evropske kulture.

Borsko srečanje je vzpostavilo novo delitev evropskega kulturnega prostora, za katerega naj bi Balkan po novem predstavljal tisti radius, iz katerega je šele črpala svoje kulturne zasnove vsa ostala Evropa. Že sama tema simpozija — Moj pogled na balkansko književnost, je implicirala določeno vasezagledanost. Ta se je v našem slovenskem prostoru pokazala tudi v razmišljanju Slobodana Djukića v Književnih listih, 29. septembra 1988, pod naslovom — Besede o čudnem Balkanu in oholih zahodnjakih. Pri tem so »oholi zahodnjaki« nujno tudi vzhodnoevropci, da gre v resnici za nekaj drugega.

Pejorativnima terminoma Balkan in balkanizacija je bilo pač treba najti primerno pa učinkovito protiutež za naelektrizirano čustveno raven udeležencev simpozija. Zato potem »oholi zahodnjaki«, kar vsebuje tudi svoj ideološki odtenek glede na prizanesljivost do eventualnih »oholih vzhodnjakov«, ki sicer niso bili neposredno omenjeni, so pa pri tem vsekakor samoumevni.

Zmernejše razmišljanje je srečanje balkanskih pisateljev postavljalo ob bok podobnim mednarodnim pisateljskim srečanjem, kot npr. srednjeevropski Vilenici. To seveda ne pomeni samo tega, da pisateljem narodnostni in jezikovni okviri, v katerih sicer delujejo, ne morejo zadoščati. Možnost njihovega ustvarjalnega prodora pač niso samo notranje, osebne in zasebne in narodnostnega pomena, ampak so tudi širše, eksteritorialne in svetovno vzajemne.

Ena poglobitnih nevšečnosti pri tem je bila ravno v spopadanju z negativnimi pomeni osnovnih terminov. Razen Balkana in balkanizacije je bil v ospredju tudi termin Balkan kot sod smodnika. Nekaj časa je celo kazalo, da takšen sod smodnika lahko zanetijo tudi sami pisatelji. Da je tako usoda Balkana in Sveta dejansko v njihovih rokah. Opazen nemir in strah je zbudjala sama prisotnost albanskega pisatelja Ismaila Kadareja, ki bi takšen »fitalj« v resnici lahko prvi prižgal. V obeh primerih, kot eventualni negativec in potem kot pozitivec, je bil Kadare glavna osebnost tega srečanja. To vse skupaj pomeni, da je pisatelj (še posebno, če je balkanski) v najboljšem primeru nosilec obojnih idej, dobrega in zlega, sveta in nič, afirmacije in zanikanja.

Navsezadnje je tudi sod zlata, ali natančneje vagoni žlahtnih kovin (pravih količin teh nusproduktov pri separaciji bakra nam niso zaupali), iz borskega RTV (rudarsko topilničarskega bazena), prav tako svojevrsten sod smodnika. Računajoč pri tem, da je Bor nemara najbolj onesnaženo mesto v Jugoslaviji in sam ekološki pekel na Zemlji. Mesto se razvija še naprej v senci visokih bruhaajočih dimnikov in njihovih oblakov žveplovega dioksida. To zadeva tudi lokacijo Doma kulture v središču mesta, kjer je potekalo srečanje balkanskih pisateljev, kot mogoča ironija in posmeh, še najmanj pa odpor.

Snovi dovolj za razmišljanje o tem, ali je kultura sploh lahko kaj več kot obliž in slepilo. Koliko upanja ima lahko pisatelj, pa naj bo iz balkanskega, podonavskega, srednjeevropskega ali mediteranskega bazena? Ali s svojim delom ne vpisuje zgolj nekrologa v evropski kulturi? Ali ne opeva samo neki vmesni prostor in čas ter kontinuitete od zibelke do groba evropske civilizacije?

Dialogi št. 12/1988

FRANJO FRANČIČ VEZ

Rekel mi je, naj ga kličem Musa, a to je bila le okrajšava za njegovo pravo ime. Ni veliko govoril. S krepkimi zamahi je zidal, vztrajno in brez predaha. Daj, ustavi se, sem mu večkrat dejal, da pokadiva enega kot ljudje. Te besede so mu bile všeč. Istra je tkala svojo čarovnijo. Istrski kažun je dobival podobo. A vseeno ni bil Musa nič bolj gostobeseden. In sva pila. Pel sem, da bo starega Vodjo zamenjal novi. Ostro me je pogledal, ko je ujel, da je v bistvu, da se mi jebe za vse Vodje. In prav počasi sva izmenjala več besedi. Povabil sem ga k sebi na kosilo. Pivo za pivom, pa tudi številka Migjenija, ki je dokončno podrla zid. Povedal je, zakaj je moral zbežati na obalo. Poslušal sem ga, a jaz nisem bil tam. Pripovedoval je, da so bratu med demonstracijami polomili obe nogi. Poslušal sem, a nisem si mogel predstavljati. Govoril mi je o domu, očetu, mladosti, o 1981 in kasneje, ko so iz Albancev naredili begavce in jih ponižali z batinami, umori in pregoni. Poslušal sem, a prekleto, nisem se mogel prebiti. Drugi svet, druge misli, drugi ljudje.

In vendar, neka vez.

Srečno Musa.

Nič več in nič manj.

KOHA ËSHTË E MASKARENJVE,
PO ATDHEU ËSHTË I SHQIPTARËVE

A. ASLLANI

FRANCI ZAGORIČNIK

OPERA BALCANICA

Në pjesen e dytë të shtatorit, në Bor, u mbjath takimi i shkrimtarëve ballkanikë, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të shkrimtarëve të të gjitha shteteve ballkanike si dhe të mysafirëve nga Hungaria. Kështu krahas manifestimeve masive politike në këtë pjesë të Ballkanit me parulla këmbëngulëse luftënxitëse, patëm poashtu një manifestim të madh kulturor, që mosdurimet konkrete ndërkombëtare dhe antagonizmat u përpoq t'i tejkalojë duke shestuar rreth fizionimisë më komplete të letërsisë ballkanike dhe të ndikimeve të frytshme reciproke që burim kryesor kanë mu Greqinë antike, që nuk do të duhej t'ishte më djep i kulturës evropiane.

Takimi i Borit vendosi ndarjen e re të hapësirës kulturore evropiane ku Ballkani do të paraqiste atë radius, nga i cili Evropa mori bazat e kulturës të saj. Vetë tema e simpoziumit, *Pikëpamja ime për letërsinë ballkanike*, implikoi në një farë mënyre një shikim kah vetëvetja. Kjo në hapësirën tonë sllovene u tregua në shestimet e Slobodan Dukiqit në Književni listi të 29 shtatorit 1988, me titull *Fjalë mbi Ballkanin e çuditshëm e perëndimorët mendjemëdhën*. Me këtë rast »perëndimorët mendjemëdhën« janë edhe evro—lindorët, kështuqë është fjala për diçka tjetër.

Termineve pezhorativë Ballkan e ballkanizim duhej disi t'u gjendej kundërbarra përkatëse dhe e suksesshme për shkallën e elektrizuar emocionale të pjesëmarrësve të simpoziumit. Për këtë shkak »perëndimorët mendjemëdhën« që përbën edhe nuancën ideologjike karshi »lindorëve mendjemëdhën«, të cillët zatën nuk u përmendën drejtëpërdrejtë, po gjithsesi nënkuptoheshin.

Shestimi ca më i matur, takimin e shkrimtarëve ballkanikë e vuri krahas me takimet tjera ndërkombëtare të shkrimtarëve, siç

është, për shembull, ai i Evropës së mesme në Vilenicë. Kjo, merret vesh, nuk do të thotë se kornizat kombëtare e gjuhësore, brenda të cilave përndryshe veprojnë, nuk janë të mjaftueshme. Mundësitë e depërtimit të tyre krijues, megjithëkëtë nuk janë vetëm të rëndësisë intime, personale, të veçanta dhe nacionale, po janë edhe më të gjera, eksteritoriale dhe të ndërvarura.

Njëra nga pakënaqësitë, me këtë rast, ishte mu në konfliktin me domethëniet negative të termineve themelore. Pos Ballkanit e ballkanizimit ishte në qendër edhe Ballkani si fuçi baroti. Një kohë bile dukej se atë fuçi baroti mund ta ndezin edhe vetë shkrimtarët. Se është fati i Ballkanit e i Botës praktikisht në duart e tyre. Shqetësim të dukshëm e frikë nxiti vetë prania e shkrimtarit shqiptar *Ismail Kadare*, i cili një fitil të tillë mund ta »ndizte« vërtetë i pari. Në të dy rastet, si negativ e më vonë si pozitiv, ishte Kadareja, personaliteti kryesor i këtij takimi. Kjo përgjithësisht don të thotë se shkrimtari (sidomos nëse është ballkanas, është bartës i ideve të dyfishta, së mirës dhe së keqes, botës dhe hiçit, afirmimit dhe mohimit.

Në fund të fundit është edhe fuçi ari, apo më saktë vagonet i metaleve fisnike (sasi të sakta të këtyre nusprodukteve me rast të separacionit të bakrit nuk na i besuan), nga bazeni xehetar—shkrirës RTB) janë edhe fuçi baroti. Duke llogaritur me këtë rast se Bori është qyteti më i ndotur në Jugosllavi si dhe vetë ferri ekologjik i Tokës. Qyteti zhvillohet edhe më tej nën hijet e tymtarëve vjellës dhe reve të dioksid karbonit. Kjo vlen edhe për lokacionin e Shtëpisë

së Kulturës në qendër të qytetit, ku u bënë takimet e shkrimtarëve ballkanikë, si ironi e mundshme e përqeshje, a së paku si rezistim.

Brum i mjaftueshëm shestimi rreth asaj se a është kultura gjë më tepër se fashë e verbim. Sa mund të ketë besim shkrimtari qoftë ai ballkanas, përdanubas, mitelevropian apo i bazenit mesdhetar? A nuk shkruan në veprat e tij nekrolog për kulturën evropiane? A nuk i këngëton vetëm një hapësirë e një kohe të ndërmjetme si dhe një vazhdimësie nga djepi deri tek varri i civilizimit evropian?

(Dialogi, nr. 12/1988)

FRANJO FRANČIČ

FIJE

Thirrmë Musa, më tha, aniqë kjo ishte veç një shkurtesë për emrin e tij të vërtetë. S'fliste shumë. Me përhapje të rrasta muronte, me këmbëngulje e pandërprerje. Po, kadalë he burrë, i thashë sa herë, ta tymosim nga një si njerëz. Këto fjalë i pëlqyen. Istra posedonte mrekullitë e saj dhe po merrte pamjen e saj. Po ç'e do s'ishte Musa hiç më shumë për muhabet. Dhe pimë. Këndova se Udhëheqësin e vjetër do ta ndërrojë i riu. Ashpër më shikoi, kur mori vesh se më ha palla për gjithë Vogjët. Vërtetë ngadalë ndërruam ndonjë fjalë. E ftova të vinte tek unë në drekë. Birrë pas birre dhe me numrin e Alternativës së »Migjenit« që përfundimisht rrënoi murin. Më tha pse iu desh të vinte në Bregdet. E dëgjova se s'kisha qenë atje. Më rrëfei se të vëllait në demonstrata ia thyen të dy këmbët. Dëgjoja dhe s'mund ta mirrja me mend. Më foli për shtëpinë, babanë, rininë, për 1981—shin e për më vonë, kur shqiptarët i shëndërruan në çilimi duke i poshtruar me të rëna, vrasje e ndjekje. Dëgjoja po për djall, si të më koptisej. Tjetër botë, tjera mendime, të tjerë njerëz.

Porse një fije.

Me fat Musa.

As më shumë as më pak.

PATJETËR PARA EMRIT E MBIEMRIT
RR. M. TË THONI »ME NDERË ME THANË«!

LINDITA AHMETI

DIN KALLUSHANI PLAGËN SI DIELLI

Shtirë. I qetë rri Din Kallushani
Në këndin e shpërlarë me gjak trimi
Shtirë. I qetë rri Din Kallushani.
Plaga e tij është diell i pikturuar me gjak trimi,
Shikimi i tij i bashkon detin me qiell,
Syri i tij oqean mes qepallash.
Pushon një dorë. Në damarë ftohet gjaku
Pushon gisht' i pushkës. Në buzë shqiptohet: bijt e mi!
Pushojnë tri jeta. Në ballë shkëlqen fitore!
Shtirë. I qetë rri në një kënd të Atdheut të shpërlarë me gjak.
I qetë rri Din Kallushani trim me fletë.
Me dy djem, me dy sokola vajti në pushtet të vdekjes.
Përmbi fshat e përmbi kokë të Dinit qëndrojnë hordhi;
Pandur pas panduri rreth kanë bërë,
Nga sytë iu shpërndahet terri.
Vdiq Dini. Viqën bijt e tij.
Nga sytë e tyre shëndrit shpresa jonë.
Hordhisë i mbeti vetëm dështimi...



PORTRET I SHQIPTARIT
TË NDERSHËM

AGIM QENA

LINDITA AHMETI

VEGIM

Treni ecën, ecën, ecën;
Trroklojnë rrotat mbi binarë
Trrok-trrok-trrok!
E këput treni natën mes për mes.
Kushet vagoni tërhiqet si pijanec i përgjumur.
Brenda në kupe drita e zbetë u jep jetë fletëve të librit.
Faqe më faqe fluturojnë fletët në duart e mia.
Ty-tyy-tyyy - i krekoset natës sirena.
Udhëtarët gërhasin. Flenë.
Rreshtave të librit vrapon dilizhansa e Gogolit.
Zot, karrocieri s'qenka djalë i ri,
Skeleti i mbajtkja frerët e kalit!
Hedh shikimin jashtë - shtëllunga terri;
Kalorësit e natës kalurojnë pranë xhamit!
Në libër dikush vrapon,
kërcëllojnë hapat në borë.
Pastaj dëgjohet vaji!
Vaj grash, vaj fëmijësh!
Skeleti! ... O zot, sytë e tij të kuq!
Mbyllet libri furishëm.
Brenda kopertinave ngjyrë vjollce ngujohet skeleti.
Po zot, o zot, a s'pashë diç në dritare?
A s'qenë vetë kalorësit e natës?
Një skelet m'u duk i zi!
Pesë skeletë ishin të zezë. Po pesë ishin.
Në ballë të tyre Kukudhi vetë.
Flokët prej kashte i kish, dhëmbët prej gacash ferri.
Diskush në kupe thotë - e mjera unë ja ku janë!
Ç'të bëjmë vëllezër, ç'të bëjmë motra?
Hajt ta zbresim diellin - thotë diskush tjetër.
Dielli gjithmonë e ka tretur ngjyrën e territ.
Matanë maleve tona përgjon drita.

SALIH KABASHI

BALLË PËR BALLË MË PASOJAT E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME NË KOSOVË (II)

(rrëfime intelektualësh)

...diferencime është spastrim radikal rrënjësor vertikal e horizontal në stilin karakteristik të spastrimeve në B. Sovjetik në kohën e Stalinit. Jugosllavia këtë fenomen e njuh që nga vitet e pasluftës, kur e njëjta gjë është aplikuar po kështu në Kosovë. Eliminimi i të gjitha kuadrove shqiptare në ekonomi, arsim, kulturë, jurisprudencë, administratë shtetërore, shëndetsi e kudo tjetër ku kanë patur guximin të thonë JO, është qëllim i diferencimit...

...se sa e si funksionon sistemi juridik, tregon situata aktuale. Dukuri eklatante është keqtrajtimi i të burgosurve dhe i personave që thirren, mbahen e paraburgosen nga policia... Shaban Muja, student i ekonomisë, i lindur më 1964, është arrestuar nga policia më 4 shtator të k.v. bashkë me të vëllanë Shaipin, student të mjekësisë. Pas mundimeve të shumta, ka kërcyer nga kati i dytë i godinës së SPB-së dhe me urgjencë është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës e nga aty në Beograd...

...Xhemal Berisha nga Dushanova, ekonomist i diplomuar, më 6 prill të këtij viti, pasi e izoluan në një zyrë të policisë në Prizren, këceu nga kati i tretë dhe vdiq të njëjtën ditë...

...Lema Bytyqi, amvise 39 vjeçare nga fshati Ngucat, nënë e katër fëmijëve, është arrestuar dhe mbajtur 6 muaj në Burgun e Mitrovicës së Titos, është torturuar, ka pësuar kallje mushkërishe dhe dënuar me dy vjet burg. I shoqi bashkë me fëmijët është në Gjermani ndërsa arsyetja e vetme e arrestimit dhe e dënimit janë librat e revistat e gjetura pas një bastisjeje. Përfaqësuesit e pushtetit në Kosovë, kur këtu ish për vizitë Parlamenti evropian, u thanë këtyre të fundit se ajo tashmë është në liri. Po ajo sot e gjithë ditën vuan dënimin në Burgun e Lipjanit...

...më 22 shtator të k. v. në Gjakatë e Qarkut në Prishtinë, dënoi me nga 6 muaj Fehim Tafën dhe Islam Pacollin (invalid), të akuzuar për pjesëmarrje në demonstratë e marsit në Lipjan. Në aktakuzë thuhet se kanë brohuritur: Rroftë Kushtetuta e vitit 1974! Dëshminë e fajit të Islamit (parapëlqik) e bëri milici...

...më 6 gusht 1987 në qytetin Pozharevac të Serbisë, në orën 23.00 të natës i është nxjerrë syri djalosht Burim Beqirit. Rasti i tij, edhe pse krim monstruoz, u publikua pas më shumë se dy muajsh në gazetën Politika të Beogradit derisa aktori i krimit s'u zbulua as deri me sot sepse fëmija është shqiptar dhe kjo ndodhi në kohën kur mitingjet antishqiptare ishin në hov të plotë nëpër Serbi...

...më 5 prill të k.v. në Dragobil, komuna e Malishevës, u vranë dy fëmijë: vëllezërit Din e Arsim Paçarrizi. Ata i vrau, gjoja, Naim Paçarrizi, që mori pushkën që e kishte lënë përtokë një nga ushtarët që në atë vend bënë manovra!!! Po e vërteta është ndryshe...

...Eshtë i haptë represioni ndaj fëmijëve, prindërit e të cilëve kanë qenë të diferencuar, izoluar a burgosur. Atyre nuk u bëhet i mundshëm rregjistrimi në shkollë të mesme, të lartë a në fakultet, nuk u bëjnë të mundshëm vendosjen në konvikte nxënësish a studentësh, nuk kanë asnjë mundësi që të marrin farë kredie a burse...

...Sivjet organet policore e të judikaturës kanë ngritur procedurë kundërvajtjeje kundër 1180 personave. Deri më tani janë dënuar për kundërvajtje 924 persona me burg prej 30-60 ditësh. Fëmijët u dënuan me nga 15 ditë...

...shkaku i mosfunksionimit të normës juridike është në faktin se proceset gjyqësore nuk zhvillohen në mbështetje të kodit penal po në nën urdhërin e diktatit politik partiak... Kjo ilustron më së miri me numrin e madh të atyre që janë dënuar, ku s'kemi të bëjmë as me procese civile as penale. Kur pala është shqiptare atëherë zbatohet metoda e diskriminimit total. Dy persona të kombësive të ndryshme, bie fjala, për të njëjtën vepër dënohen me dënime të ndryshme: Shqiptari i moshës jomadhore për një përpjekje dhunimi ndaj një serbeje të moshës madhore dënohet me 10 vjet burg ndërsa serbi i moshës madhore për dhunim merr 1 vit burg... Ka plot raste kur dhunimet a përpjekjet e dhunimit inskenohen dhe fenomene të këtilla janë të vjetra e të njohura që nga kohë e Turqisë...

...Kragujevac-Serbi: Serbi në qendër të qytetit, në dyqanin e tyre vret nënë e bir dhe në hetime deklaroi se e ka bërë këtë vetëm pse ata janë shqiptarë...

...Pozita ekonomike, sociale, arsimore, kulturore e nacionale e Popullit Shqiptar në Kosovë e jashtë Kosovës, kurrë nuk ka qenë më e rëndë. Kështu nuk ishte as në kohë të luftërave...

(problemet e punëtorëve të medimeve)

...pozitë shumë e rëndë mbretëron në gazetarinë shqiptare në Jugosllavi. Gazetarët e radios, të të përditshmeve e të periodikeve, ata të televizionit kanë, jo vetëm sot po edhe në të kaluarën, mbi kokë shpatën e mprehtë të diferencimit që e mbajnë në dorë dhe vringëllojnë me të kuadrot e zgjedhura e besnike të pushtetit që personifikohen në redaktorë rubrikash a emisionesh apo drejtorë e kryeredaktorë, që janë të gatshëm në çdo kohë të sakrifikojnë gazetaret nën etiketa të angazhimit të pamjaftueshëm në plan të zbatimit të dokumenteve partiake dhe të luftimit të pamjaftueshëm të platformës së nacionalizmit e separatizmit shqiptar, të angazhimit në mjete të tjera të informimit sidomos në veri-perëndim të shtetit... Kështu ndodh në kohën kur gazetaria jugosllave, megjithatë, ka arritur disa rezultate në thyerjen e shumë temave tabu nga jeta shoqërore e publike. Gazetarët shqiptarë nuk kanë mundur lirisht të raportojnë nga tubimet e njohura serbo-malaziase. Edhe për ngjarjet që zhvilloheshin në vetë Kosovën merrnin raportin e TANJUG-ut. Ndërsa kur filloi greva e njohur e shkurtit-marsit e minatorëve të Stari Tërgut dhe manifestimet e klasës punëtore e të rinisë së Kosovës, çka solli edhe masat e jashtëzakonshme për shqiptarët, gazetarët shqiptarë bashkë me mbi njëqind gazetarë të vendit e të huaj, raportin nga mjediset ku zhvilloheshin drama të vërteta të stoicizmit e të përkushtimit internacional të minatorëve shqiptarë që të fyer vite me radhë kërkonin të nderohej dinjiteti i tyre klasor e kombëtar dhe ku u paraqitën kërkesa të caktuara politike: ruajtja e autonomisë së Kosovës, dorëheqja disave nga udhëheqësit që ua imponoi politika serbe, mosaprovimi i disa ligjeve që Popullin Shqiptar e vinin në pozitë të qytetarëve të rendit të dytë... Nga më shumë se 100 gazetarë që u gjendën në Stari Tërg, vetëm Zenun Çelaj, me përvojë 28

vjeçare në gazetari u paraburgos dhe u mbajt 11 ditë në Burgun e Prishtinës ku humbi 10 kilogram nga pesha që kishte pasur para se ta arrestonin. Arsyeja e paraburgimit: gjoja dezinformimi nga greva e minatorëve. Gjatë marrjeve në pyetja inspektorët e SPB-së interesohen jo për gjëra esenciale ku do të shihej arsyeshmëria apo absurdi i paraburgosjes, po pyesin kush ishte gjyshi, cilët ishin shokët tu të fëmijërisë, kur je parë me atë apo çka të ka thënë ai dhe banalitete tjera. Edhe pse nuk është vërtetuar fajësia, megjithatë nuk i lejohet të punojë dhe praktikisht është eliminuar nga jeta publike dhe ndëshkohet në aspektin material. Diferencimi në mjetet e informimit është gogol prore i pranishëm që thyen vullnetin për punë, varfëron punën e nivelin profesional të gazetës, në një rën anë, dhe diskriminon një kategori të caktuar kombëtare në mediumet e Kosovës...

...brenda 15 vjetëve të fundit nga shkaqe ekonomike e politike kanë emigruar në Evropë dhe në vende tejoqeanike 250.000 shqiptarë. Presioni ekonomik e politik tregon qartë qëllimin e tij: largimi i shqiptarëve dhe rikolonizimi i Kosovës me serbë. Mu për këtë arsye është shpikur shifra prej 500.000 emigrantësh nga Shqipëria, edhe pse dihet se aktualisht në Jugosllavi nuk ka më shumë se 700 veta të tillë. Në kohën kur Kosova përpëlitet me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë, këtu flitet për ndërtimin e 2000 banesave gjoja për ekspertë nga vise të tjera që do të »ndihmojnë« Kosovën, kur profile nga më të ndryshmet të ekspertëve ka plotë nëpër entet e këtushme të inkuadrimin në punë. Për »ekspertët deficitarë« janë paraparë rroga 150% më të mëdha se sa për vendësit. Të gjitha viset me shqiptarë në Jugosllavi janë më të pazhvilluarat në shtetin. Fondi i Federatës për shëndërrohet në instrument të politikës rikolonizuese në Kosovë. Ndihma për Kosovën nga Serbia: gjyqtarë për të dënuar e policë për të munduar.

...Doktori i shkencave historike Muhamet Tëmava për shkak të një viti burg nuk mund të punojë vetë, nuk mund të gjejë punë e shoqja e tij e as bija e tij me fakultet të kryer... Daut Bogujevci, arsimtar u pushua nga puna dy vjet para pensionimit, sepse kishte shfaqur mendimin e tij rreth ndryshimeve kushtetutare...

...Këtu u përmendën raste intelektualësh. Po më së shumti e pësojnë fshatarë e punëtorë...

(krijues të mohuar)

...Izolimin e sivjetëm dhe të vitit 1981 e përjetuan shkrimtarët:

Kadrush Radogoshi,
Murteza Nura,
Bardh Frangu e
Jakup Ceraja.

...ndodh që në konkurset letrare të zgjidhen punime që pas deshifrimit as të mos botohen. Fat i këtillë përcjell:

Zeqir Gërvallën e
Arif Demollin.

...për shkak të një tregimi të botuar në FJALA u dënua nga shkalla e parë me tri vjet burg Sabit Rrustemi. Edhe pse dëshmoi pafajësinë, pas katër muajsh atij iu tërhoq nga shtypi libri dhe as sot nuk ka punë për të as mundësi të paraqitet publikisht me shkrimet e veta.

...as Sabedin Halitit nuk i lejohet të botojë. Ish-redaktori i Fjalës që dënuar 4 vjet burg.

...Nga Shoqata e Filozofëve dhe e Socilogëve të Kosovës janë diferencuar, izoluar apo burgosur:


Anton Kolaj,
Ramadan (Murtez) Krasniqi,
Rrahim Azemi,
Fazli Ahmetaj,
Bajram Metaj,
Eqrem Zenelaj e
Sejdi Zogaj.

Nuk kanë asnjë punë profesorët universitarë:

Ukshin Hoti dhe Shemsi Reçica.

Mbi 1000 studentë nuk kanë mundur të vazhdojnë studimet sepse dikush nga familja e tyre ka qenë i dënuar, izoluar apo në sy të keq. Për sivjet nuk janë publikuar të dhënat, ndërsa shifra e mëparme përfshin periudhën nga 1982-1988. Milan Kërmeviq, shef i arsimit të Kosovës, ka pohuar se mbi 250 arsimtarë janë larguar nga procesi i mësimi. Edhe këtu nuk kemi të dhëna për sivjet.

(vijon në numrin e ardhshëm ku do të japim dëshmi të izoluarish shqiptarë në mars të këtij viti).



PORTRET I SHQIPTARIT
TË NDERSHEM

AGIM QENA

KATË XUKARO

TË MARRIM HËNËZËN

Rëmbemëni mua.
Hëna është larg në qiell
e udha e vështirë.
Tre lumenj duhet të ndjekim
deri te deti,

e të ecim tri dete e tri fusha
e tri kodra e tri male të larta.

E te i treti mal
tri kuçedra të ndeshim
me tre krerë e tre sy
e me tri zjarre në grykë.

E veç treve ndër ne
u gjinden tri shpata që t'i vrasin
— të tjerëve ua morën valët e detit
o i grisën në fusha për korrje

o i çanë në vreshta për të vjela
o i humbën në pyjet e begata.
Dikush kthehet prapë nga frika
e dikush vdes nga guximi.

Po edhe vetëm një,
edhe vetëm njëri ndër ne
me krerët e kuçedrës në duar
arrin ta marrë hënëzën
a të na sjellë.
E vallen e zëmë të madhe si dikur.

SKIRO DI MAXHO

KANË PREHJE FJALËT

Drapëri hënës
ia mban fitilin natës
që të mos humben hijet
n'errësirë.

Kanë prehje fjalët
kanë pushim ligjëratat
e gjuhët s'kanë më shqiptime.

Prehje Arbëreshëve
prehje fjalëve të tyre
prehje fjalëve të marra hua
nga fjalorët e lëtinjve
prehje fjalëve të zhdukura
te kjo ditë dhe përditë
nga fjalorët arbëreshë
edhe prehje kësaj Hore

*që pesëqindvjeçare plakë
është lodhur se po bluan
e po bluan*

*nga mëngjesi gjer në darkë
duke marrë hua fjalë
e po fjalë për t'u shprehur
nga një mijë gjuhë të ndryshme.*

*Prehje fjalëve të thëna
po me heshtjen që rri
pezull.*

FREDERIK RESHPJA

TESTAMENTI I SKËNDERBEUT

Merreni shpatën time! Vëreni
mbi drurir më madhështor të bregdetit!

Le të vërtitet ajo nga duart e stuhisë.
E kam fjalën këtu: duhet
të armatosim çdo gjë.

Edhe erërat.

Ja edhe stapi im prej ulliri. Mbilleni!
Mbi degët e tij mund të varni armët.
Duke vështruar kurmat plot plagë të ullinjve,
gjithmonë kam menduar që ata janë drurët e luftës.

Ç'kisha jua dhashë.

Tani trupin tim ta zbrisni thellë nën tokë,
që kur të vijë vjeshta e fundit,
nga sytë e mi të mbijë gruri...

XHEVAHIR SPAHIU

GJUHA SHQIPE

Mblidhmani gjakun!«

Një plagë plumbi,
një vragë shpate
dhe fshehtas helmi,
Ca fjalë u shkoqën,
ca rrokje ranë,

po thelbi mbeti.

Fjalët e shqipes si zaje lumi
rrugës e bjerrën gjithçka të tepërt,
gjithçka të qullët,
ngjizur e lidhur si eshtra trupi.
Dhe gjaku çurkë.

Kullojnë fjalët. Ajri përflakët!

»Mblidhmani gjakun!«

ALTERNATIVA

Fletushkë e Seksionit Letrar të Shoqatës Kulturore Shqiptare MIGJENI - Lubjanë
Glasilo literare sekcije Kulturnega društva Albancev v Ljubljani MIGJENI

Kryeredaktor
Glavni urednik
SALIH KABASHI

Redaktor përgjegjës
Odgovorni urednik
MATJAŽ HANŽEK

Redaksia
Uredništvo
JAŠA ZLOBEC
BISLIM ELSHANI
ZDRAVKO DUŠA
FADIL DEMIRI
PETER BOŽIČ
SHKËLZEN MALIQI
MATJAŽ HANŽEK
HALIL BERISHA
ENVER NEZIRI DHE
SALIH KABASHI

Botoi UK ZMS, për të
zanjo
GORAZD DREVENŠEK

Shtypi
Natisnil
ČGP DELO Ljubljana

Përgatitja
Oblikovanje
PETER ŽEBRE

Računalniško oblikovanje teksta
Ada Graf, računalništvo, oblikovanje, založništvo, d.o.o.
Ljubljana
JANEŽ ŽIBERT

Adresa e përkohshme e Shoqatës dhe e revistës
Začasni naslov društva in glasila
ZVEZA KULTURNIH ORGANIZACIJ (ALTERNATIVA)
MESTNI ODBOR
Krekov trg 2, 61000 Ljubljana, YU

Kontributet vullnetare dhe parapagimin mund ta bëni në xhiro-llogarinë
Prostovoljne prispevke lahko pošljete na žiro račun
LB 50101-678-47303

në adresën
na naslov
UK ZSMS—LJUBLJANA—ALTERNATIVA SM 20700
ose në xhirollogarinë devizore
KD MIGJENI - Ljubljana, Krekov trg 2,
LB 010-727001-100138/01

Cmini në dinarë: kundërvlera e 3 DEM

Lexonie,
shpërndanie e
ndihmonie ALTERNATIVEN!

1

1

ALTERNATIVA

